ISSN 1857-6443

## Zgjerimi

Njëra për PDSH-në tjetra për dy BESAT

Fq.3



## ZAEVI PËR EMRIN

Identiteti nuk kontestohet



Fq.4

## Mbappe "dhurata" e Sitit për trajnerin Guardiola

Fq.13




# Koha

www.koha.mk




## Diktatori kanibal

Fq.18

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3342 · e hënë 16 prill, 2018 · 12°c | 19°c · 15 DEN

EKONOMI

## Mbretëria e të papunëve



Të rinjtë nuk besojnë se mund të gjejnë një vend pune pa qenë pjesë e një partie apo pa e korruptuar dikë. Kjo nuk është deklaratë as e ndonjë hulumtuesi të politikave sociale e as e ndonjë qytetari të dëshpëruar, por e vetë kryetarit të Qeverisë së Kosovës. Ramush Haradinaj, ndërsa promovonte Strategjinë dhe planin e veprimit për...

Fq.9

RAJON

## Garë për dominim

Fq.16

DOSSIER

## SEKRETI i Izraelit dhe bomba atomike në Luftën e Gjashtë

Fq.19

GLOBI

## Si erdhi në pushtet Assadi?

Fq.17



### GJITHNJË E MË PAK FILLORISTË DHE MATURANTË

# ZBRAZEN SHKOLLAT E TETOVËS



**Në Komunën e Tetovës, nëse në vitin 2016 në shkollat e mesme ka patur 10.086 nxënës, në vitin 2017 ky numër ka rënë në 9999 nxënës, kurse në vitin 2018 janë gjithsej 9.811 nxënës. Kjo do të thotë se vetëm brenda tre vitesh - në shkollat e mesme të Tetovës ka 275 nxënës më pak. Ndërkohë, vetëm në Komunën e Tearcës, numri total i nxënësve për tre vite ka shënuar rënie për mbi 500 nxënës. Sipas shifrave zyrtare, në shkollat fillore në këtë komunë në vitin 2013/14 ka patur gjithsej 1969 nxënës, kurse në vitin 2016/17, ky numër ka qenë 1428 nxënës**

Fq.5

# Qytetarët vazhdojnë të vuajnë për ujë

*Shkup, 15 prill* - Një pjesë bukur e mirë e komunave në Maqedoni nuk i përmbushin nevojat qytetarëve kur jemi te shërbimet efikase komunale. Kualiteti i dobët i shërbimeve komunale në vend, ngjashëm si vitet e mëhershme, edhe gjatë 2017 ka zënë vend në procedimin e lëndëve pranë zyrës së Avokatit të Popullit. Raporti i Ombudsmanit për vitin e kaluar, kur flasim për të drejtat e konsumatorëve, në këtë rast të qytetarëve, thekson se banorë të shumë komunave dhe më tutje vazhdojnë të mbesin të pakënaqur nga funksionimi i njësive të bashkëqeverisjes lokale dhe mënyrën se si ata i vendosin projektit prioritare. Përderisa ankesat dhe vërejtjet e shumta për shërbimet e dobëta komunale te Ombudsmani janë shtuar, kryesuesit e komunave këto parashtresa i kanë arsyetuar se nuk mundet t'i realizojnë...

Fq.7



EDITORIAL

# PËR NJË EDUKIM MEDIATIK NË SHKOLLAT TONA



Emin AZEMI

Në kuadër të diskutimeve për Ligjin e arsimit fillor dhe të mesëm, do të duhej të inkorporohet edhe nevoja e përfshirjes së Edukimit mediatik, si lëndë e obligueshme në kuadër të planprogrameve të reja mësimore. Janë të shumta arsyet, si edhe nevojat, që nxënësit e sotëm, të cilët nesër do të jenë qytetarë të denjë me obligime e përgjegjësi shoqërore, të arrijnë të identifikojnë manipulimin mediatik dhe në mënyrë autonome të ndërtojnë qëndrime e pikëpamje pa qenë të ndikuar domosdoshmërisht nga mediat.

Koncepti për shkollën si "magazinë e dijës" sot gjithkund në botë po braktiset dhe në vend të kësaj po promovohen forma të reja të mësimnxënies, duke e bërë më funksionale lidhjen në mes të dijeve skolastike dhe praktikës. Sfidat që po vijnë si rezultat i përparimit teknologjik, nuk kanë lënë pa prekur edhe arsimin, kurse më të goditurit ndaj këtyre sfidave janë nxënësit. Interneti sot është bërë vegla e kudondodhur dhe tundimi që prodhon ai është i papërballueshëm, nëse nuk krijohen paraprakisht mekanizma që do ta zbutnin shkallën e ndikimit pa kriter të nusuprodukteve që nxjerr interneti (rrjetet sociale, reklamat, blogjet etj.)

Sikundër dihet, Edukimi mediatik nxit dhe zhvillon disa shkathtësi : teknike (aftëson qasjen ndaj mediave), kritike ( të kuptuarit e përmbajtjeve mediatike, të aftësuarit e interpretimit të tyre dhe vlerësimin kritik) dhe praktike (aftësia e të kuptuarit të porosive mediatike).

Ndërkaq, objekt shqyrtimi i edukimit mediatik do të ishin: përmbajtjet e dëmshme mediatike (dhuna, reklamat, pornografia), ndikimi i mediave dhe përmbajtjet e dëmshme, rregullimi dhe vetërregullimi (konventat, kornizat ligjore dhe kodet etike gazetareske dhe reklamuesit), pastaj teknologjitë e reja dhe roli i tyre shoqëror, industrializimi i informacionit, kultura dhe argëtimi, komunkimi interaktiv, zhanret e reja mediatike, siç është blogu etj.

Edukimi mediatik ishte definuar si nocion dhe si përmbajtje qysh në Konferencën ndërkombëtare (National Leadreship Conference on Media Literacy, 1992) që nënkuptonte "aftësinë e qasjes, analizës, vlerësimit dhe transmetimit të porosive përmes mediave).

Nëse i bëjmë një interpretim të lirë fushëveprimit që do të kapte Edukimi mediatik, të pashmangshme do të ishin temat që kanë të bëjnë me përvetësimin e shkathtësive kreative dhe kritike, gjegjësisht dijeve që ndihmojnë lidhshmërinë e ideve komplekse, si dhe identifikimi i dilemave që janë në themelet e lirive njerëzore e intelektuale. Ky përkufizim mbi edukimin mediatik nuk lë mangut edhe komponentën mjaft të rëndësishme që kanë mediat si burim informacioni e argëtimi, për të cilat duhet patur njohuri e shkathtësi.

Një Ligj që do të rregullonte sferën e përdorimit të mediave, do të ishte më se i nevojshëm edhe për faktin se shoqëritë e zhvilluara nuk ua lënë individëve që në mënyrë pavarur dhe josistematike të merren me përvetësimin dhe avancimin e shkathtësive për të analizuar efektet që kanë mediat në jetën tonë të përditshme. Ky, mbi të gjitha është obligim institucional e kompetent që rregullon në mënyrë të drejt e profesionale të kontestit shoqëror, teknologjik, argëtues, informues të mediave në jetën e njeriut, sidomos të moshave më të reja.

UNESCO, madje, qysh në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar kishte inicuar idenë e edukimit mediatik. Duke e bazuar idenë në rëndësinë që kanë mediat në jetën e individit dhe të familjes, ishte kërkuar që në nivele ndërkombëtare të mblidhen studiues për të shqyrtuar mundësinë e përfshirjes së edukimit mediatik në sistemin arsimor në të gjitha shtetet e zhvilluara dhe më pak të zhvilluara. Për rrjedhojë ishte nënshkruar edhe Deklarata mbi edukimin mediatik (Declaration of Media Education) në vitin 1982, ndonëse që nga nënshkrimi i kësaj Deklarate e deri më sot koncepti mbi edukimin mediatik deri-diku ka ndryshuar, varësisht prej sfidave dhe konteksteve nëpër të cilat kalojnë shoqëritë. Maqedonia, gjithsesi, nuk është imune ndaj këtyre sfidave, kurse Ligji për edukimin mediatik do të ishte mjet parandalues i devijimeve që prodhon xhungla e pakrasitur e internetit dhe mediave të reja.

## SHOQËRI E HUMBUR MBAS MERCEDES BENZ-AVE



"E dashur Rudina Xhunga. Artikulli juaj më preku dhe më jep shpresën që në atdheun tonë ka ende njerëz që dinë kuptojnë drejtë fjalën e vërtetë të dikujt. Të dish të kuptosh me inteligjencë dhe mirësi është një faktor shumë i rëndësishëm jo vetëm për edukimin e vetvetes por dhe përparimin e një shoqërie të tërë - sidomos për një shoqëri ku ndodhet sot populli ynë - shoqëri e humbur mbas Mercedes Benz-ave dhe getove të pasanikëve që ruhen me policë.
Ju falënderoj nga zemra jo vetëm për veten time, por për të gjithë bashkatdhetarët lexues të këtij artikulli kaq inteligjent dhe me vlerë, artikull që i hap porta të tjera horizontesh mbi artin dhe letërsinë", ka shkruar në profilin e saj në Facebook, shkrimtarja dhe piktorja Ornela Vorpsi, në përgjigje të komenteve pas disa deklaratave të saj që u dhanë këtyre ditëve në Tiranë.

## NJË POPULL I ZHYTUR NË SHERRE



"Civilizimi edukon shpirtin, qytetërimi zbut karakterin, dija të pasuron me modesti dhe informacioni të bën largpamës. Një shoqëri e cila komunikon me dashamirësi dhe përdor dialogun, është një shoqëri e civilizuar dhe e ditur. Një popull i zhytur në sherre, zymtësi dhe censurë, është popull që e deklaron haptazi injorancën, prapambetjen dhe distancën e thellë me dijen, informacionin dhe ABC-në e kulturës", shkruan në profilin e tij në FB, teologu Hasan Baftijari.

## SHQIPTARËT DHE ALTRUIZMI



"Mendjet më brilante shqiptare me zemër të plasur i numëruan gjithë defektet tona që na pamundësojnë të kemi një jetë kombëtare për të qenë. Sa kohë ka kaluar dhe duhet prapë t'i përsërisim. Shqiptarët akoma se kanë derdhur qenien e tyre në sheshin e altruizmit dhe vazhdojnë të mos kenë kuptim mbi jetën e përbashkët. U mungon durimi për punë të mira dhe të qëndrueshme. Ndizen shpejt, por edhe shpejt shuhen...", shkruan në profilin e tij në Facebook, shkrimtari nga Tetova, Bardhyl Zaimi.

## MERRI SHUMICËS DHE JEPI PAKICËS!



"Kjo qeveri ka vetëm një parim: Merri shumicës dhe jepi pakicës! TVSH për biznesin e vogël sjell shkatërrim të biznesit, rritje të kostos, rritje të çmimeve, shkatërrim të ekonomisë dhe vendeve të punës. Të gjithë humbasin, madje edhe arka e shtetit do të humbasë. Pro janë vetëm Edi Rama që do ta japë me koncesion edhe mbledhjen e TVSh-së, dhe oligarkët që përfitojnë nga rrënimi i biznesit të vogël. Por në Kavajë tregtarët e vegjël janë të vendosur të mos e pranojnë përfshirjen e tyre në TVSH, sepse kjo është një skemë falimentuese për ta dhe për familjet e tyre. PD është në krahun e tyre dhe familjeve shqiptare", shkruan në profilin e tij në FB, kryetari i Partisë Demokratik të Shqipërisë, Lulzim Basha

MEDIACitate

## Shqiptari përdhunoi minorenen, analiza e ADN-së vërteton atësinë e foshnjës

Analizat e ADN-së kanë vërtetuar autorësinë e përdhunimit dhe lënien shtatzënë të një 15 vjeçareje nga fqinji i saj 55 vjeç. Ngjarja e rëndë u regjistrua në tetor të vitit të shkuar në Pogradec. Pas ngjarjes, Ligor Biba u arrestua nga policia, por në atë kohë mohoi akuzat dhe kërkoi analizat e ADN-së. Pas disa muajsh, analiza zbuloi se autori është babai i foshnjës. Vajza minorene jetonte në kushte të vështira ekonomike ndërsa prindërit bënë apel për dënimin e autorit. Nga ana tjetër, familjarët e autorit asaj kohe hodhën poshtë të gjitha akuzat. Ata mohuan se Biba të kishte kryer atë veprim. Procesi gjyqësor ndaj Bibës po zhvillohet në Gjykatën e Korçës, pasi Gjykata e Pogradecit nuk ka seksion për të mitur.

*(OraNews, 15 prill)*

## Assadi është në disponim të mirë

Presidenti sirian, Bashar al-Assad ka thënë para një grupi të ligjvënësve rusë të dielën, se sulmet Perëndimore në shtetin e tij kanë qenë akt i agresionit, kanë raportuar agjencitë e lajmeve ruse. Reuters ka raportuar se ligjvënësit rusë janë takuar me Assadin pasi Shtetet e Bashkuara, Franca dhe Britania kanë nisur sulme me raketa si hakmarrje ndaj sulmit me armë kimike që ka ndodhur javën e kaluar në qytetin Duma. Agjencitë ruse të lajmeve kanë cituar ligjvënësit të kenë thënë se Assad ka qenë në "disponim të mirë" dhe ka lavdëruar sistemin sovjetik të mbrojtjes ajrore të përdorur nga Siria për t'iu kundërvënë sulmeve Perëndimore. Ai është ftuar për të vizituar rajonin siberian, Khanty-Mansi. Në ndërkohë, po agjencitë ruse kanë cituar një zyrtar rus të ketë thënë se Shtetet e Bashkuara do të kërkojnë dialog me Rusinë për stabilitet strategjik në Siri. "Ka shumë arsye që na bëjnë të besojmë se pas sulmeve në Siri, amerikanët do të kenë dëshirë të kalojnë në dialog strategjik", është cituar të ketë thënë Vladimir Ermakov.

*(Koha Ditore, 15 prill)*

NËSE NUK E KENI DITUR...

## ÇFARË DIHET PËR ALEKSANDRIN E MAQEDONISË?

Aleksandri i Maqedonisë (Aleksandri III, 356-323 p.e.s.) ishte mbret i Maqedonisë në vitet 336-323 p.e.s., i mbiquajtur Aleksandri i Madh (Leka i Madh). Ishte biri i Filipit II dhe i princeshës epirote Olimpia. E mori arsimin nga Aristoteli dhe u përgatit si ushtarak në një varg luftërash. Pas vrasjes së Filipit më 336 p.e.s. mori pushtetin në Maqedoni dhe u zgjodh komandant i përgjithshëm i forcave greke kundër Persisë. Ndërmori një fushatë në veri të Maqedonisë më 335, kur rrethoi edhe qytetin ilir Pelion. Më 334 p.e.s. Aleksandri i Maqedonisë nisi fushatën kundër perandorisë persiane, të cilën e theu dhe krijoi një perandori të gjerë që shtrihej nga tokat e mbretërisë maqedone në Evropë e deri në brigjet e lumit Ind në Azi e të Nilit në Afrikë.

Sipas informatave jozyrtare, kompromisi ka ardhur në drejtim të asaj që BDI të lëshojë një ministri të saj për PDSH-në, ndërsa a do të jetë ajo pa resor që mbulon investimet e huaja apo Ministria e Ekonomisë, do të zgjidhet mes këtyre dy partive. Nga ana tjetër, sipas asaj që ka pranuar BDI, LSDM mundet ti ofrojë post ministri cilës të dojë nga dy Lëvizjet BESA

PAS RAPORTIT TË KE, HAP I PARË ZGJERIMI QEVERISË

# NJËRA PËR PDSH-në TJETRA PËR DY BESAT



Koha Fatos RUSHITI

*Shkup, 15 prill* - Mospajtimet në prapaskenë mes LSDM-së dhe BDI-së për zgjerimin e Qeverisë duket që kanë marrë fund në favor të qëndrimit të kreut të LSDM-së dhe kryeministrit Zaev që, përveç përfshirjes së PDSH-së në Qeveri, qëndrim që e ka mbajtur BDI deri më tani, të përfshihen edhe dy Lëvizjet BESA. Sipas informatave jozyrtare, kompromisi ka ardhur në drejtim të asaj që BDI të lëshoj një ministri të saj për PDSH-në, ndërsa a do të jetë ajo pa resor që mbulon investimet e huaja apo ministria e Ekonomisë, kjo do të zgjidhet në fund mes këtyre dy partive.

Nga ana tjetër, sipas asaj që ka pranuar BDI-LSDM, mundet ti ofrojë post ministri cilës të dojë nga dy Lëvizjet BESA. Sa i përket eshalonit të dytë dhe të tretë, ato që ka pasur Aleanca për Shqiptarët apo edhe më shumë poste drejtuese, të ndahen mes tre partive shqiptare: PDSH dhe dy BESAVE. Po sipas këtyre informatave, Zaev ka arritur të bind liderin e BDI-së, Ali Ahmeti se vetëm dy votat e PDSH-së nuk premtojnë stabilitet afatgjatë sa i përket përkrahjes së agjendës reformuese të Qeverisë, zgjidhje të çështjes së emrit dhe përgatitjet për Samitin e NATO-s në korrik të këtij viti që do të mbahet në Strasburg të Francës e ku gjasat janë reale që Maqedonia të bëhet anëtarja më e re e NATO-s nëse ka marrëveshje paraprake për emrin me Greqinë.

Sa i përket negociatave me partitë shqiptare, nga Lëvizja BESA më kryetar Bilall Kasamin thonë se nga e hëna deri të mërkurën kanë paralajmërime se mund të ketë takim liderësh mes Kasamit dhe Zaevit për hyrje eventuale të kësaj partie në Qeveri. "Kemi paralajmërime që nga e hëna deri të mërkurën mund të takohen liderët Zoran Zev dhe Bilall Kasami për zgjerimin e Qeverisë. Më herët, funksionarë nga të dyja palët kanë pasur vetëm biseda joformale për mundësinë e përfshirje së partisë sonë ne Qeveri, por jo edhe ndonjë ofertë konkrete nga ana e zyrtarëve të LSDM-së", thonë zyrtarë të lartë partiak të Lëvizjes BESA. Në pyetjen e gazetës KOHA se cili do të jetë qëndrimi ndaj ofertës eventuale të Zoran Zaevit për post zëvendëskryeministri për reforma dhe zëvendësministra nga ato që ka pasur ASH, zyrtarë të Lëvizjes BESA thonë se nuk do të jenë përjashtues, por se oferta do të shqyrtohet me seriozitet në organet partiake. "Nëse do të kemi një ofertë të tillë, sigurisht se do ta shqyrtohet dhe analizohet mirë në organet më të larta partiake dhe në fund do të jenë ato që do të vendosin. Tani për tani nuk mund të themi më shumë. Me rëndësi ekziston vullneti i të dy palëve për të kontribuar në Qeverinë reformatore", thotë njëri nga zyrtarë të lartë partiak. Ndryshe, kjo parti në pushtet lokal vetëm se kanë një bashkëpunim me BDI-në dhe LSDM si në Komunën e Çarit dhe komunat tjera. Nga Lëvizja BESA me kryetar Afrim Gashi presin që pas publikimit të Raportit të Komisionit Evropian për Maqedoninë, të negociojnë me LSDM-në për ndarjen e kulaçit qeveritar.

"Ende nuk janë përmbyllur këto gjëra. Java që vjen është e lidhur me raportin e Komisionit Evropian, vijnë emisarët e BE-së dhe vlerësohet Plani 3-6-9. Prandaj, këto detaje do të merren vesh fill pas kësaj. Megjithatë, pjesa e dikastereve për neve mbetet temë dytësore në raport me parimet e bashkëqeverisjes dhe programin qeveritar", thonë nga departamenti për informim i kësaj partie. Ndryshe, sipas asaj që flitet kuluareve politik, kjo parti me siguri do të ketë post ministri, ndërkaq përgjigja se më shumë janë për parti se sa për poste qeveritare, me gjasë më shumë bëhet për të mos "hidhëruar" BESËN tjetër, të cilës ka zëra se zëra se LSDM nuk do ti ofrojë post ministri.

Ndryshe, Zaevi në brifungun e fundit me gazetarë tha se ai gëzon mbështetjen edhe nga partneri i tij i koalicionit, Ali Ahmeti, por edhe partnerët e tjerë të koalicionit, për të çuar edhe më tej procesin e zgjerimit të shumicës qeverisëse. Zaevi zgjerimin e shumicës parlamentare e vlerësoi si të nevojshme, për shkak të vendimeve serioze që do ta presin Maqedoninë dhe për arsye të efikasitetit të Parlamentit.

Sa i përket dikastereve që do të lëvizin me më shumë siguri në ambientet qeveritare, përfliten dikasteri i kulturës, punës dhe politikë sociale, drejtësia, arsimi dhe infrastruktura. Pas përfundimit me ligjet reformuese në fushën arsimit, LSDM ka gjasa që këtë dikaster ta ndërrojë me drejtësinë. Lëvizja BESA, sipas burimeve të afërta me deputetë të saj në Parlament, do të ishte e kënaqur me njërën nga këto tre dikastere, arsimin, drejtësinë, apo dhe politikën sociale. Kur jemi tek PDSH, nga kjo partia janë të mbyllur deri më tani për opinionin, por që ditë më parë kanë paralajmëruar se gjithçka rreth hyrjes në Qeveri do të jetë kryetari i saj Menduh Thaçi ai që do të sqarojë përmes një konference për shtyp. Ndryse, në opinion ka pasur zëra se vizita e presidentit të Shqipërisë, Ilir Meta, një javë më parë në Tetovë e që njihet për miqësi të hershme me kreun e PDSH-së, ishte në funksion të asaj që të ndihmojë në përafrimin e qëndrimeve me BDI-në për marrje posti ministror edhe atë Ekonominë që partia e Thaçit e ka rezervuar për nënkryetarin e saj Bardhyl Dauti.

PENDAROVSKI PËR RADIO EVROPA E LIRË

## NATO nuk është alternativa e vetme, por është më e mira për Maqedoninë

*Shkup, 15 prill* - Pas gjitha analizave krahasuese që mund t'i nxjerrim në atë temë, nuk mund të shohë se ekziston organizatë tjetër, në ndonjë rajon tjetër të botës, e cila ofron parakushte më të mira për zhvillim të kësaj shoqërie specifike në Republikën e Maqedonisë, thotë koordinatori kombëtar për NATO-n, Stevo Pendarovski, në intervistën javore të Radio Evropa e Lirë.

Ai thekson se Maqedonia tani është më afër hyrjes në Aleancën se sa para 10 viteve para samitit në Bukuresht në vitin 2008. "Unë jam një nga ata pjesëmarrës të njohur të atij samiti të vitit 2008 dhe përafrisht e di atmosferën e cila mbretëronte brenda delegacionit të Maqedonisë dhe nga aspekti i një njeriu i cili atëherë ishte i punësuar në Kabinetin e Presidentit të Maqedonisë dhe ishte afër kontestit kryesor i cili edhe atëherë por edhe tash na shpien ose na largojnë nga Aleanca.

Mendoj se edhe brenda atmosfera është më ndryshe, faktorët kyç kanë pritje më të mëdha nga ajo se mund të lind diçka pozitive nga procesi i bisedimeve", thotë Pendarovski në intervistën.

Në pyetjen se çka nëse nuk përfundon problemi për emrin dhe cila do të ishte në atë rast alternativa, Pendarovski thotë se do të vazhdojë të bisedohet sepse, siçthekson, Maqedonia nuk ka alternativë më të mirë se integrimi në BE dhe në NATO.

Në përgjithësi, thotë ai, edhe kur nuk kam qenë në pushtet, kur kam qenë në opozitë, edhe si profesor edhe si qytetar i këtij vendi, me të vërtetë nuk mund të shoh, pas të gjitha analizave komparative që mund t'i nxjerrim nga ajo temë, nuk mund të shoh se ekziston organizatë tjetër, në ndonjë rajon tjetër të botës, që ofron parakushte më të mira për zhvillim të kësaj shoqërie specifike në Republikën e Maqedonisë dhe posaçërisht rajoni specifik, edhe nga aspekti i sigurisë nëse dëshironi, me një ambient mjaft jostabil me vite prapa.

Ai flet edhe për reagimin e Rusisë lidhur me anëtarësimin e mundshëm të Maqedonisë në NATO dhe me atë rast thekson se formulimet me të cilat del kohë pas kohe MPJ-ja ruse përmbajnë



retorikë e cila nuk ndihmon që të përmirësohen marrëdhëniet bilaterale mes dy shteteve.

ZAEVI PËR EMRIN

# IDENTITETI NUK KONTESTOHET

Zaev konsideron se duhet të gjenden formulime se nuk kemi pretendime territoriale, se nuk kemi për qëllim ta shkelim kufirin që na kufizon dhe se nuk kemi për qëllim të përzihemi në trashëgiminë e Greqisë, njëkohësisht edhe ata në trashëgiminë tonë



*Shkup, 15 prill* - Kryeministri i Maqedonisë, Zoran zaev në brifingun e djeshëm me mediumet theksoi se është arritur përparim për pjesën më të madhe të çështjeve në kontestin me emrin dhe se mbeten shtrirja e përdorimit dhe emri për përdorim ndërkombëtar. Është e saktë se pjesa më e madhe e puneve janë zgjidhur dhe kjo, theksoi, i jep të drejtë të besojë se është bërë hap përpara, por, theksoi se edhe ajo që është zgjidhur, mund të konsiderohet se është arritur vetëm nëse ka marrëveshje përfundimtare. Lidhur me vërejtje greke për irredentizëm, Zaev konsideron se duhet të gjenden formulime se nuk kemi pretendime territoriale, se nuk kemi për qëllim ta shkelim kufirin që na kufizon dhe se nuk kemi për qëllim të përzihemi në trashëgiminë e Greqisë, njëkohësisht edhe ata në trashëgiminë tonë. Zaev konfirmoi se referendum për emrin do të ketë, ndërsa pyetja është nëse do të jetë menjëherë pas marrëveshjes eventuale apo para hyrjes së Maqedonisë në BE dhe në NATO. Për shtrirjen e përdorimit dhe kërkesën greke për erga omnes, Maqedonia është në qëndrimin se emri i kontraktuar duhet të jetë vetëm për përdorim ndërkombëtar pa ndryshim të Kushtetutës, sepse përdorimi vendor i emrit nuk ka kurrfarë ndikimi ndaj Greqisë. Për çështjen e identitetit, Zaev tha se Greqia ka mirëkuptim sepse bëhet fjalë për ndjenjë dhe përcaktim personal dhe nuk aludon në ndryshim. "Ajo është çështje e ndjenjës dhe pala greke ka mirëkuptim për këtë punë dhe është e rendit që atë ta përsëris për shkak se ajo është një nga momentet e para pozitive që u paraqitën. Kryeministri Cipras dhe ministri Koxias kanë mirëkuptim për identitetin. Identiteti është ndjenjë dhe nuk aludojnë në ndryshim të çështjeve të identitetit", tha Zaev. Për shtetësinë, thotë se do të jetë në pajtim me emrin e ri që do të jetë për përdorim ndërkombëtar. "Sipas të gjitha gjasave do të ishte qytetar i Veriore/Së Epërme/E Vardarit apo ngjashëm, atë për cilën do të vendosim, përmes fjalë[s Maqedoni. Unë pres të konfirmohen çështjet që tashmë janë përshkruar në grafat e KB-së siç është e gjitha maqedonase, me atë që absolutisht jemi të gatshëm t'i mënjanojmë të gjitha rezervat e tyre për ndonjë aludim të trashëgimisë apo ngjashëm, për arsye se nuk kemi për qëllim që me konfirmim të gjuhës sonë kushtetuese, gjuhës maqedonase të hyjmë në trashëgiminë e Greqisë", theksoi kryeministri i Maqedonisë. Sipas tij, secila zgjidhje që do të arrihet duhet të kalojë tek institucionet dhe qytetarët e të dy vendeve.

## ATHINA PO BËN PAZAR ME BERLININ PËR ZGJIDHJE TË EMRIT

Nëse zgjidhet çështja për emrin, atëherë masa antikrizë - shkurtimi i pensioneve, do të shtyhet për gjashtë muaj më vonë, ky sipas gazetës greke "Ta nea" është premtimi nga Berlini drejtuar Athinës, në bisedimet mes Gjermanisë dhe Greqisë për mbyllje të kontestit shumëvjeçar, por edhe çka pala greke do të fitonte nga kjo. Siç lajmëroi korrespondentja e MIA-s nga Athina, gazeta duke iu referuar burimeve evropiane shkruan se masa tashmë e votuar për shkurtim të pensioneve që duhet të hyjë në fuqi prej 1 janarit të vitit 2019, do të shtyhej për gjashtë muaj më vonë, si "dhuratë" gjermane për Greqinë, nëse arrihet marrëveshja për emrin. Diçka që do t'i shkonte për shtati Ciprasit dhe planeve të tija zgjedhore. "Burime të besueshme evropiane, duke i transmetuar për "Ta nea" bisedat që po zhvillohen në prapaskenë mes Athinës dhe Berlinit, i prezantojnë gjermanët se i kanë premtuar Aleksis Cipras këmbim me dobi të fuqishme politike për të dhe për SYRIZA-n, në rast se arrihet marrëveshje për emrin e Shkupit me kolegun e tij Zoran zaev. Bëhet fjalë për transferim për gjashtë muaj më vonë të masës për shkurtim të pensioneve, shkruan gazeta dhe shton se me atë qeveria do të mund të marrë frymë thellë dhe do t'ia hapë rrugën Ciprasit drejt shpalljes së zgjedhjeve në maj të vitit 2019. Teksti në "Ta nea" hasi në reagime të bujshme në Greqi, si nga opozita, e cila e akuzoi qeverinë për negociata të fshehta, ashtu edhe nga qeveria e cila kërkoi seriozitet nga Demokracia e Re.

AMBASADORJA E OSBE-SË NË LARGIM, NINA SOUMALAINEN

# Dygjuhësia, merreni shembullin e Finlandës

Soumalainen thotë se shteti duhet të punojë me të gjithë qytetarët, pa dallim të prejardhjes së tyre dhe shtoi se gjuha është çështje e rëndësishme në shtetet multietnike. Në Finlandë, vendin nga i cili vjen, ka dy gjuhë kombëtare, finlandisht dhe suedisht. Pakica suedeze në Finlandë, shton ajo, paraqet më pak se gjashtë për qind të popullatës së përgjithshme

*Shkup, 15 prill* - Liria e mediumeve në Maqedoni ngadalë por jetësohet, por megjithatë ekzistojnë akoma shumë çështje kritike, thotë në intervistën për MIA-n ambasadorja e OSBE-së në largim, Nina Soumalainen. Ai përparim, shton ajo, tashmë është vërejtur në raportin e misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR-së për zgjedhjet lokale vitin e kaluar, në të cilin, mes tjerash, ishte përmendur se mediat kanë raportuar në mënyrë të balancuar për pjesëmarrësit në procesin zgjedhor. Si kritike i ceki sfidat me të cilat përballet RTVM, mes të cilave edhe zgjidhjet kadrovike dhe pandëshkueshmërinë e veprave kriminale të kryera ndaj gazetarëve. "Plotësisht të vetëdijshëm për nevojën e përmirësimit të sigurisë së gazetarëve, Misioni ynë ka bashkuar forcat me Shoqatën e Gazetarëve dhe Ministrinë e punëve të brendshme me të cilët do të punojmë së bashku për të përmirësuar sigurinë e gazetarëve dhe për t'i dhënë fund mosndëshkimit të krimeve kundër gazetarëve", thotë Soumalainen. Në intervistën për MIA-n, ajo flet për disa tema, reformat në sistemin juridik, krizën e emigrantëve, ligjin për gjuhët, terrorizmin, kontrollin e armëve. policinë, barazinë gjinore, ndërkaq flet edhe për hapat e saj të mëtutjeshëm në karrierë. Soumalainen thekson se OSBE mbështet proceset e zhvillimit të gjyqësisë së pavarur dhe të paanshme me një staf profesional që është i lirë nga ndikimi i panevojshëm, e posaçërisht e përshëndeti punën e PSP-së, për të cilën tha se, prej se është formuar, ka ngritur 20 aktakuza, të cilat u konfirmuan të gjitha, dhe gjykimet tani janë në vazhdim. Si arritje të posaçme të misionit derisa e kryesonte ajo, e përmendi përgjigjen ndaj krizës së emigrantëve dhe mbështetjen e shpejtë efektive për policinë kufitare. "Ne vendosëm ekipet mobile në kufij dhe ndërmorëm hapa për të ndihmuar autoritetet të forcojnë menaxhimin e kufijve. Në gjithashtu promovuam bashkëpunimin rajonal për të zbuluar grupet e krimit të organizuar të trafikimit të qenieve njerëzore nga mesi i emigrantëve", theksoi Soumalainen në intervistë për MIA-n. Duke pasur parasysh se qëllim primar i Misionit të OSBE-së është implementimi i Marrëveshjes së Ohrit, e cila do të rrumbullakësohet me Ligjin për gjuhët, ajo thotë se shteti duhet të punojë me të gjithë qytetarët, pa dallim të prejardhjes së tyre dhe



shtoi se gjuha është çështje e rëndësishme në shtetet multietnike. Thotë se në Finlandë, vendin nga i cili vjen, ka dy gjuhë kombëtare, finlandisht dhe suedisht. Pakica suedeze në Finlandë, shton ajo, paraqet më pak se gjashtë për qind të popullatës së përgjithshme. "Ne kemi qenë pjesë e Suedisë deri në vitin 1809, por për arsye historike dhe për parimet e bashkëpunimit nordik, ne kemi kërkuar të ruajmë suedishten si gjuhë zyrtare. Varet nga çdo shtet dhe qytetarët e vet të përcaktojnë rrugën përpara, përfshi edhe çështjen e gjuhës. Nuk ka një model të vetëm që zbatohet nga e drejta ndërkombëtare, por unë mund t'ju siguroj se Misioni ynë do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet që kanë për qëllim të ndërtojnë një shoqëri të vërtetë kohezive dhe multi-etnike", tha Soumalainen në intervistë për MIA-n. Për atë se kush do të jetë pasardhësi i saj në Maqedoni, thotë se procedura për zgjedhje ende është në rrjedhë dhe se janë nominuar disa kandidatë, ndërsa deri në emërimin e ambasadorit të ri, Misionin do ta kryesojë Xhef Golldstain.

GJITHNJË E MË PAK FILLORISTË NË TETOVË

# ZBRAZEN SHKOLLAT E TETOVËS



**Në Komunën e Tetovës, nëse në vitin 2016 në shkollat e mesme ka patur 10.086 nxënës, në vitin 2017 ky numër ka rënë në 9999 nxënës, kurse në vitin 2018 janë gjithsej 9.811 nxënës. Kjo do të thotë se vetëm brenda tre vitesh - në shkollat e mesme të Tetovës ka 275 nxënës më pak. Ndërkohë, vetëm në Komunën e Tearcës, numri total i nxënësve për tre vite ka shënuar rënie për mbi 500 nxënës. Sipas shifrave zyrtare, në shkollat fillore në këtë komunë në vitin 2013/14 ka patur gjithsej 1969 nxënës, kurse në vitin 2016/17, ky numër ka qenë 1428 nxënës**

Koha Urim HASIPI

*Tetovë, 15 prill* - Numri i nxënësve nëpër shkollat fillore të Tetovës dhe rrethinës shënon rënie nga viti në vit. Më shumë kjo vërehet në komunat rurale se sa në Komunën e Tetovës, sidomos në tre vitet e fundit gjatë regjistrimeve në shkollat e mesme. Sipas shifrave me të cilët disponon Sektori për Arsim në Komunën e Tetovës, trendi i uljes së nxënësve vërehet në shkollat e mesme, ngase sipas këtij Sektori, çdo ditë e më pak nxënës po regjistrohen.

Shifrat tregojnë se, nëse në vitin 2016 në shkollat e mesme ka patur 10.086 nxënës, në vitin 2017 ky numër ka rënë në 9999 nxënës, kurse në vitin 2018 janë gjithsej 9.811 nxënës. Kjo do të thotë se vetëm brenda tre vitesh - në shkollat e mesme të Tetovës ka 275 nxënës më pak.

Në ndërkohë, në shkollat fillore të Komunës së Tetovës, gjatë katër viteve të kaluara - prej klasës së parë në klasën e dytë gjithsej 61 nxënës nuk e kanë vijuar mësimin për arsye të ndryshme, që në total i vjen dy paralele. Saktësisht, në vitin shkollor 2013/14, në klasën e parë ka patur 1160 nxënës, ndërsa në klasën e dytë ka patur 1120 nxënës. Në vitin 2014/15, në klasën e parë ka patur 1074 nxënës, ndërsa në klasën e dytë 1056 nxënës. Një vit më pas, respektivisht në vitin 2015/16, gjithsej në klasë të parë ka patur 1119 nxënës, që është shifër e njëjtë edhe në klasën e dytë. Këtë vit shkollor (2017/18), në klasë të parë janë regjistruar 1122 nxënës dhe nëse kjo shifër krahasohet me vitin 2013, atëherë del se janë më pak diku rreth 38 nxënës. Rënie e numrit të nxënësve vërehet edhe nga klasa e pestë e deri në klasën e nëntë. Në bazë të dhënave zyrtare, në shkolla fillore në Komunën e Tetovës, nga viti 2015 e deri në vitin 2017 në klasën e gjashtë ka 22 nxënës me pak, gjegjësisht nëse në vitin 2015 ka patur 1117 nxënës, në vitin 2017 në klasën e gjashtë ka 1095 nxënës.

Sipas drejtuesit të Sektorit për veprimtari publike, Ahmed Qazimi, ulja e numrit të nxënësve në shkollat fillore është hasur më shumë në komunat rurale, pasi në këtë drejtim - shifrat tregojnë ulje të numrit të nxënësve në shkollat e mesme. Ai thekson se në këtë drejtim, si shkak kryesor që ka ndikuar në uljen e numrit është migrimi jashtë vendit, si dhe shpërngulja brenda në rrethinën e Tetovës. "Në këtë drejtim, krahas shumë faktorëve, poashtu një ndikim ka edhe shpërngulja nga fshati në qytet. Kjo më së shumti haset në komunat rurale, prandaj edhe në shkollat fillore të Tetovës kemi një rënie të vogël të numrit të nxënësve, sepse kur një familje shpërngulet në qytet, normalisht se fëmijët mësimin e ndjekin në shkollat e Tetovës. Prandaj, në Komunën e Tetovës për sa i përket shkollimit fillor, ky fenomen është më pak i përhapur, kurse në shkollat e mesme gjithnjë na vijnë më pak nxënës nga komunat rurale", deklaroi Qazimi.

Njohës të këtyre rrethanave thonë se shteti shumë pak po bën që popullata të mos shpërngulet, por dhe të mos braktis vendin.

"Jemi dëshmitarë të një procesi të dhimbshëm, i cila për çdo ditë ndodh në rajonin tonë - largimi i të rinjve, ndërsa e keqja është edhe më e madhe pasi gati askush nga institucionet nuk ndërmerr masa për parandalimin e këtij procesi. Mendoj se kjo ndodh në radhë të parë si rezultat i gjendjes ekonomike-politike të shtetit në nivel nacional dhe e dyta - mungesa e perspektivës së të rinjve, ku mundësi e vetme e tyre për punësim është angazhimi i tyre në struktura të ndryshme partiake. Për gati 10 vite, numri i fëmijëve zvogëlohet diku rreth 50 për qind, ndërsa ajo që është më tragjike - masat e ndryshme që mundohet shteti t'i promovojë janë pa efekt", thotë Metin Muharemi, kryetar i Qendrës për Edukim dhe zhvillim (CED).

METIN MUHAREMI

**Mendoj se kjo ndodh në radhë të parë si rezultat i gjendjes ekonomike-politike të shtetit në nivel nacional dhe e dyta - mungesa e perspektivës së të rinjve, ku mundësi e vetme e tyre për punësim është angazhimi i tyre në struktura të ndryshme partiake. Për gati 10 vite, numri i fëmijëve zvogëlohet diku rreth 50 për qind, ndërsa ajo që është më tragjike - masat e ndryshme që mundohet shteti t'i promovojë janë pa efekt**

Për të parandaluar këtë fenomen, njohësit thonë se është e vështirë, prandaj apelojnë që të merren masa për zbutjen e gjendjes. "Mendoj se ky proces nuk mund të ndalet, por sadopak mund të zbutet në drejtim të asaj që disa kuadro që kthehen dhe të angazhohen në sektorin privat ose të zhvillojnë biznese të tyre, pasi në shumicën e rasteve, ata posedojnë kapacitete dhe vlera të mirëfillta. Bëj apel për përfshirje të mirëfilltë të të rinjve në të gjitha strukturat e ndryshme shoqërore, ndryshe për më pak se pesë vite, do të renditemi në listën e shteteve me popullsi më të plakur, ndërsa pasojat do t'i ndjejnë gjeneratat e ardhshme, të cilat pas çdo viti po zhduken. Do jemi shembull për një sistem jofunksional dhe shtet pa perspektivë, jo vetëm për të rinjtë, por edhe për ata që edhe kanë vendosur të jetojnë këtu", theksoi Muharemi.

Në Komunën e Tearcës, sipas shifrave zyrtare, brenda tre vitesh, në të gjitha shkollat fillore në këtë komunë, në klasë të parë janë regjistruar rreth 30 nxënës më pak. "Në vitin 2013, në klasë të parë ka patur 198 nxënës, një vit më pas 179 janë regjistruar në klasë të parë, ndërsa në vitin 2015, ky numër ka arritur në 164. Një rritje të vogël vërehet vitin e kaluar kur në klasë të parë janë regjistruar 173 nxënës", bëjnë të ditur nga Komuna e Tearcës. Në këtë komunë, numri total i nxënësve për tre vite ka shënuar rënie mbi 500 nxënës. Sipas shifrave, në vitin 2013/14 ka patur gjithsej 1969 nxënës në Komunën e Tearcës, kurse në vitin 2016/17 - ky numër ka qenë 1428 nxënës.

## KRONIKË

### Rryma vret 21-vjeçarin nga Morana

Një i punësuar njëzet e një vjeçar në një firmë ndërtimore Xh.V. nga fshati i Shkupit Moranë mbrëmë ka ndërruar jetë nga goditja e rrymës derisa në rr."Gernika" janë kryer punë ndërtimore - shkarkim i tullave nga kamioni me vinç. MPB kumtoi se rasti ishte paraqitur mbrëmë në ora 13. Fatkeqësia ka ndodhur pasi në pjesë e vinçit u ngatërrua në tela me tension elektrik, me çka Xh.V., i cili qëndronte në afërsi të vinçit, ka ndërruar jetë si pasojë e goditjes së rrymës. Vdekjen e konstatoi mjeku i Ndihmës Emergjente Mjekësore. Në pajtim të Prokurorit Publik trupi i të ndjerit i është dorëzuar familjes.

### Nuk i mjafton rruga, përplaset me veturat e parkuara

Të shtunën pas ditë, në lagjen Shuto Orizare të Shkupit, ka ndodhur një aksident i pazakontë komunikacioni. Në kohën kur shumica e këtyre aksidenteve ndodhin si pasojë e mos kujdesit të më shumë shoferëve, kësaj radhe në Shutkë, aksidenti ka ndodhur mes një vozitësi dhe disa veturave të parkuara. Raporti ditor i Ministrisë për Punë të Brendshme thotë se rreth orës 19:00, të datës 14 prill, një veturës e tipit "Mercedes" me targa të Tetovës, e drejtuar nga pesoni O.K (40), i ka goditur disa vetura që kanë qenë të parkuar përreth rrugës. "Shoferi në fjalë, me veturën e tij është përplasur në mjetin transportues 'Man' dhe me veturën e punës 'Lipker-914'. Kështu, dy bashkudhëtarët e shoferit të mercedesit, personat E.K dhe N.SH, kanë marrë lëndime të rënda trupore si pasojë e së cilës janë transferuar në Qendrën Klinike në Shkup", thuhet në raportin e policisë së Shkupit. Për të vërtetuar arsyet e ndodhjes së këtij aksidenti, ekipe të Sektorit për Punë të Brendshme Shkup, kanë kryer ekspertizë në vendin e ngjarjes.

### MIA përsëri cak i hajnave

Në hapësirat e Agjencisë Informative të Maqedonisë (MIA), të shtunën mbrëma përsëri kishte tentim për vjedhje. Një kryes ose disa kryes të panjohur rreth orës 2:30 me dhunë kanë hyrë në një nga zyrat e Agjencisë, duke thyer një pjesë të dritares. Për fat të mirë, me kohë është aktivizuar sistemi i alarmit dhe me intervenim të shpejtë të Agjencisë për sigurim është ndaluar vjedhje e re e rëndë. Është shkaktuar dëm i vogël material. Policia është informuar për këtë tentim për vjedhje të rëndë, që pason vetëm tre muaj pas sulmit të dhunshëm në Agjencinë, më 6 janar, kur janë vjedhur pajisje teknike. *(O.Xh)*

GJERMANIA ME KËRKESA TË MËDHA



# E VARUR NGA PUNËTORËT E HUAJ

Statistika zyrtare tregon se prej muajit korrik të vitit 2012 deri në muajin qershor të vitit 2017, në Gjermani janë punësuar 1.3 milion të huaj në raport me 1.6 milion gjermanë. Njëherësh, Gjermania duhet të angazhojë sa vjen e më shumë punëtorë të huaj për të ruajtur zhvillimin ekonomik dhe prosperitetin

Koha Fisnik PASHOLLI

*Shkup, 15 prill* - Gjermania në të ardhmen do të tregojë varshmëri të madhe prej fuqisë punëtore nga shtetet e treta që aktualisht nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian. Njohësit e tregut gjerman të punës presin që gradualisht të ndryshohet kërkesa për punëtorë prej asaj nga shtetet anëtare të BE-së që edhe më lehtë të punësohen brenda unionit. Në këtë drejtim, janë ndërmarrë edhe më shumë veprime që punëtorëve të huaj t'u lehtësohet marrja e lejes së punës dhe leja e qëndrimit në bazë të kualifikimeve të tyre profesionale si për mjeshtër, ashtu edhe për profesionet me arsim të lartë.

Në ndërkohë, edhe analizat e fundit tregojnë rritjen e pjesëmarrjes së punëtorëve të huaj karshi punëtorëve gjermanë. Statistika zyrtare tregon se prej muajit korrik të vitit 2012 deri në muajin qershor të vitit 2017, në Gjermani janë punësuar 1.3 milion të huaj në raport me 1.6 milion gjermanë. Njëherësh, Gjermania duhet të angazhojë se vjen e më shumë punëtorë të huaj për të ruajtur zhvillimin ekonomik dhe prosperitetin. Gjithashtu, lëvizja e madhe pozitive në tregun gjerman të punës, si duket do të ishte e pamundur pa emigrimin. Kjo, ndër të tjerash theksohet në hulumtimin e fundit të Institutit Gjerman Ekonomik - IV me seli në Keln. Pjesa dërmuese e mërgimtarëve që punojnë në Gjermani vijnë nga shtetet e ndryshme të Bashkimit Evropian , ndërsa vetëm 386 mijë prej tyre vijnë prej shteteve të treta, theksohet më tej në analizë. Nga Instituti Ekonomik IV alarmojnë se në vitet e ardhshme, mund të pritet rritje e papunësisë ndër gjermanët dhe ulje pjesëmarrjes së popullatës vendase në fuqinë punëtore të Gjermanisë. "Gjermania pritet në të ardhmen, sipas të gjitha gjasave, të varet nga shtetasit e shteteve të treta, për shkak se mërgimtarët nga shtetet e BE-së do të nevojiten në vendet amë, tregjet e punës të të cilave gjithashtu vuajnë nga pasojat e plakjes së popullatës", theksojnë më tej analistët e Institutit IV. Eksperti Vido Geis thekson se Gjermania në të ardhmen do të ketë nevojë më të madhe për punëtorë nga jashtë të rrjedhojë e uljes së numrit të punëtorëve gjermanë, sidomos në dekadën e ardhshme kur do të pensionohen punëtorët të lindur midis vitit 1955 dhe 1969 kur Gjermania kishte natalitet mjaft të lartë.

"Kërkesa më e madhe në tregun gjerman të punës do të jetë për njerëzit me diploma të mjekësisë, informatikës dhe shkencat natyrore , si dhe teknikët e ndryshëm. Gjithashtu, në erën e digjitalizimit do të zvogëlohet kërkesa për punëtorët që nuk kanë kualifikime të larta e të cilët në të ardhmen do të mund të kryhen nga ana e punëtorëve në vend apo punëtorëve që për shkaqe humanitare, kanë ardhur në Gjermani", shton më tej Geis. Në ndërkohë, lidhur me digjitalizimin, më parë vlerësohej se deri në vitin 2035 ky proces do të ndikojë në shuarjen e 1.5 milion të vendeve të punës. Megjithatë, analizat e Institutit për hulumtimin e punës dhe Institutit për arsim në ekonomi në Gjermani, tregojnë se për shkak të digjitalizimit - do të krijohen një numër po aq i madh i vendeve të reja të punës. Ekspertët e Institutit IV vlerësojnë se digjitalizimi deri tani ka ndikuar në shuarjen e 60 mijë vendeve të punës në Gjermani, por që si shifër nuk ka ndikuar në numrin e përgjithshëm të të punësuarve në ekonominë më të fuqishme evropiane. Ekspertët e teknologjisë informatike thonë se përveç faktit se industria moderne e kompjuterëve është një nga punëdhënësit më të mëdhenj në botë, në mesatare ajo për çdo vend të ri pune, krijon pesë vende të reja të punës në sistemin bankar, tregti, industrinë automobilistike, arsim, shëndetësi, transport etj.

Nga ana tjetër, rritet edhe numri i mërgimtarëve me qëndrim të rregullt në këtë shtet. Statistika zyrtare tregon se në fund të vitit 2017 janë numëruar 10.6 milionë persona me shtetësi të huaj në Gjermani. Kjo tregon një rritje për 585 mijë të huaj në raport me vitin 2016. Bile, rritja është edhe më e madhe se mesatarja e dhjetë viteve të kaluara kur kishte migrim në mesatare prej afër 390 mijë persona në vit. Gjithashtu, prej vitit 2009 e këndej rritet në vazhdimësi numri i mërgimtarëve në Gjermani. Shkak kryesor për këtë është ardhja e banorëve të anëtareve të reja të BE-së si Polonia, Rumania dhe Bullgaria. Nga këto shtete, vetëm në vitin 2017 në Gjermani janë shpërngulur 439 mijë njerëz.

"Ndërmjet viteve 2007 dhe 2017, numri i qytetarëve me shtetësi të njërës nga anëtaret e reja të BE-së, është rritur nga 919 mijë në 2.6 milionë", bëjnë të ditur nga Institut gjerman i statistikave.

Në rritje e sipër është edhe numri i qytetarëve të Maqedonisë që shpërngulen për punë dhe jetesë në Gjermani. Sipas të dhënave të statistikës zyrtare, në fund të vitit 2017 në Gjermani kanë jetuar 99.435 shtetas të Maqedonisë. Kjo paraqet një rritje prej gati 4000 persona në raport me vitin 2016, kur 95.570 shtetas të Maqedonisë jetonin në Gjermani. Vlen në fund të theksohet se në dhjetë vitet e fundit, në kërkim për një vend më të mirë të paguar të punës, ikjes prej rajonit ku standardi jetësor nuk arrin as një të tretën e shteteve të Bashkimit Evropian, mungesës së stabilitetit politik që pamundëson përmirësimin e cilësisë së jetesës, numri i shtetasve të Maqedonisë që jetojnë në Gjermani është rritur prej 65.998 persona në vitin 2010 në 99.435 persona në vitin 2017. Në ndërkohë, në Gjermani jetojnë edhe 367.900 shtetas kroat. Pas hapjes së tregut gjerman të punës për anëtaret e reja të BE-së, është rritur numri prej 224.971 shtetas kroat në vitin 2012 në afër 370 mijë.

## 99.435 SHTETAS TË MAQEDONISË NË GJERMANI

Në rritje e sipër është edhe numri i qytetarëve të Maqedonisë që shpërngulen për punë dhe jetesë në Gjermani. Sipas të dhënave të statistikës zyrtare, në fund të vitit 2017 në Gjermani kanë jetuar 99.435 shtetas të Maqedonisë. Kjo paraqet një rritje prej gati 4000 persona në raport me vitin 2016, kur 95.570 shtetas të Maqedonisë jetonin në Gjermani. Vlen në fund të theksohet se në dhjetë vitet e fundit, në kërkim për një vend më të mirë të paguar të punës, ikjes prej rajonit ku standardi jetësor nuk arrin as një të tretën e shteteve të Bashkimit Evropian, mungesës së stabilitetit politik që pamundëson përmirësimin e cilësisë së jetesës, numri i shtetasve të Maqedonisë që jetojnë në Gjermani është rritur prej 65.998 persona në vitin 2010 në 99.435 persona në vitin 2017. Në ndërkohë, në Gjermani jetojnë edhe 367.900 shtetas kroat. Pas hapjes së tregut gjerman të punës për anëtaret e reja të BE-së, është rritur numri prej 224.971 shtetas kroat në vitin 2012 në afër 370 mijë.

## Shtetasja serbe vidhte në Gostivar, i shiste në Beograd

Zyra për kriminalitet të jashtëm në Gostivar ka parashtruar padi penale kundër K.Z.B shtetase e Serbisë, për shkak të dyshimeve se ka kryer tre vepra penale "vjedhje". Më 9 prill të këtij muaji, rreth orës 14.00 në Gostivar, në shtëpinë e personit me iniciale M.D ku ka qëndruar dhe ka qenë e paraqitur si mysafire, ka vjedhur sasi të arit. Rasti është denoncuar dhe e njëjta është arrestuar. Po ashtu, vitin e kaluar në muajin dhjetor, tek e njëjta shtëpi ka marrë sasi të arit dhe u ka shitur në Beograd. Në nëntor, në Novo Sellë të Gostivarit, në shtëpinë e personit me iniciale V.D, përderisa ka qenë si mysafire, ka marrë stoli ari dhe i ka shitur në Beograd. Gjithsej ajo ka arritur të përfitojë 570 kijë denarë nga shitja e arit.

## Kapet hajni i veturave në Tetovë

Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë ka ngritur padi penale ndaj personit XH.R, 33-vjeçar për shkak të dyshimeve se ka kryer vepër penale vjedhje të veturave. Në periudhën prej nëntorit të 2017 deri në muajin janar të këtij viti ka vjedhur një veturë të tipit Mercedes dhe një tre vetura BMË. Ai ka shfrytëzuar pakujdesinë e pronarëve të veturave dhe i ka marrë. Ai ka shkaktuar një dëm prej 1 milion e 700 mijë denarë.

## Prej sot reshje të kohëpaskohshme

Moti në Maqedoni do të jetë kryesisht me vranësira dhe relativisht i ngrohtë me erë të matur deri të përforcuar nga drejtimi juglindor, ndërsa nga fundi i ditës në pjesët perëndimore do të ketë reshje të kohëpaskohshme të shiut. Temperatura e mëngjesit do të lëvizë prej pesë deri 11 gradë, ndërsa e ditës prej 20 deri 25 gradë. Prej të hënës do të mbisundojë mot i ndryshueshëm dhe pak më i freskët me reshje të kohëpaskohshme të shiut, ndërsa prej të martës edhe me dukuri lokale të bubullimave.

FONDACIONI TURK NIS AKTIVITETET NË MAQEDONI

# "MAARIF" I TURQISË BLEU SHKOLLËN WOODROW WILSON SCHOOL

Fondacioni Maarif i Turqisë ka blerë shkollën private Woodrow Wilson School në qytetin e Tetovës



*Tetovë, 15 prill* - Fondacioni Maarif i Turqisë (TMV) ka nisur aktivitetet në Maqedoni duke blerë shkollën private Woodrow Wilson School në qytetin e Tetovës. Anëtari i bordit drejtues të TMV-së, Mustafa Çaltëlë, tha para gazetarëve se fondacioni ka fituar statusin e personit juridik në gjashtë vende të Ballkanit. Çaltëlë u shpreh se në vitin shkollor 2018-2019 do të nisin procesin arsimor në pesë shtete të Ballkanit, ndërsa ai veçmë ka filluar në qytetin e Prishtinës dhe Prizrenit në vitin shkollor 2017-2018.

Ai tha se licenca për zhvillimin e procesit arsimor është fituar me shpallje në gazetën zyrtare të Maqedonisë pas lejes së aprovuar nga këshilli i ministrave. "Procesin arsimor do ta fillojmë së pari në qytetin e Tetovës në Maqedoni. Fondacioni po përjeton edhe një nga ditët e lumtura. Me lejen e Zotit, do të nisim një proces edukativo-arsimor në një shkollë shumë të bukur në Tetovë", u shpreh Çaltëlë. Ai tha se me shkollën Woodrow Wilson School do të ofrohen shërbime për nxënësit në një hapësirë të mbyllur me sipërfaqe prej rreth 12.500 metra katrorë. Duke folur për kapacitetin e shkollës, Çaltëlë tha se bëhet fjalë për një shkollë shumë të mirë me 44 klasa, kabinete të biologjisë, fizikës, shkencave, kimisë, informatikës dhe bibliotekën. "Shkolla posedon edhe një bujtinë për 140 persona. Po ashtu, në shkollë gjendet edhe teatri dhe salla e konferencave. Kemi një sallë sportive të mbyllur shumë të mrekullueshme. Aktualisht kemi mbi 200 nxënës. Ne kemi filluar aktivitetet për arritjen e kapacitetit të plotë të shkollës, e cila ka kapacitet për një mijë nxënës. Në maj do të realizojmë provimin për bursa. Me një fushatë të mirë në Tetovë, do të nisim arsimin me çmime të përshtatshme".

Në shkollë do të zhvillohet procesi arsimor që nga niveli parashkollor e deri në atë të mesëm, tha Çaltëlë, i cili u shpreh se mësimi deri në klasë të gjashtë do të zhvillohet në gjuhën shqipe, nga klasa e gjashtë deri në të 12-tën në gjuhën angleze, kurse krahas kësaj do të ofrohet arsim edhe në gjuhën turke. Çaltëlë theksoi se qëllimi i fondacionit është edukimi i njerëzve cilësorë si në vendet mike dhe vëllazërore të Ballkanit, ashtu edhe në botë. "Ne duam të nxjerrim nxënës të cilët i shërbejnë vendit të tyre dhe punojnë për të", tha Çaltëlë. Ai rikujtoi se brenda një kohe të shkurtër prej 18 muajsh kanë nisur aktivitetet në 21 shtete me 105 shkolla, ndërsa Maqedonia do të jetë vendi i 22-të ku fondacioni do të ushtrojë veprimtari edukativo-arsimore. Çaltëlë shtoi se shkolla do të vazhdojë procesin arsimor si International Maarif Schools dhe se planifikojnë që krahas Tetovës, të hapin me shpejtësi shkolla edhe në qytete të tjera të Maqedonisë. Ndërkohë, koordinatori i TMV-së për Ballkanin, Salih Sagër, rikujtoi se fondacioni ka nisur aktivitetet në Ballkan në vitin 2017, duke përmendur hapjen e dy shkollave në Kosovë vitin e kaluar. Sagër tha se nga shtatori i vitit 2018 do të realizojnë një arsim cilësor që kërkohet mes dy vendeve, duke shtuar se me shkollën në Maqedoni kanë treguar se kanë fituar një vrull në aktivitetet e tyre. "Shpresoj që këtë hap që e nisëm në Tetovë ta vazhdojmë në Shkup, Gostivar dhe qytetet e tjera. Ky vend është tregues i investimit tonë për arsimin dhe njerëzit", vlerësoi Sagër.

Me cilësi të njëjtë, fondacioni do të vazhdojë aktivitetet edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, Shqipëri dhe Rumani, deklaroi Sagër, duke theksuar se çdo investim në arsim do të kthehet si një burim cilësor njerëzor për shtetet në të ardhmen. Ai tha se fondacioni do të vazhdojnë veprimtarinë pa prishur strategjitë edhe në të ardhmen, duke theksuar rëndësinë në faktin se aktivitetet e tyre janë pranuar në nivel të autoriteteve zyrtare.

*(Anadolu Agency)*

STAGNOJNË SHËRBIMET KOMUNALE NË MAQEDONI

## Qytetarët vazhdojnë të vuajnë për ujë

Numri më i madh i ankesave për shërbimet e dobëta komunale, siç thuhet në Raportin e Ombudsmanit, janë regjistruar në rajonin Kërçovës, Tetovës, Demir Hisarit dhe Manastirit



Koha — Omer XHAFERI

*Shkup, 15 prill* - Një pjesë bukur e mirë e komunave në Maqedoni nuk i përmbushin nevojat qytetarëve kur jemi te shërbimet efikase komunale. Kualiteti i dobët i shërbimeve komunale në vend, ngjashëm si vitet e mëhershme, edhe gjatë 2017 ka zënë vend në procedimin e lëndëve pranë zyrës së Avokatit të Popullit. Raporti i Ombudsmanit për vitin e kaluar, kur flasim për të drejtat e konsumatorëve, në këtë rast të qytetarëve, thekson se banorë të shumë komunave dhe më tutje vazhdojnë të mbesin të pakënaqur nga funksionimi i njësive të bashkëqeverisjes lokale dhe mënyrën se si ata i vendosin projektit prioritare. Përderisa ankesat dhe vërejtjet e shumta për shërbimet e dobëta komunale te Ombudsmani janë shtuar, kryesuesit e komunave këto parashtresa i kanë arsyetuar se nuk mundet t'i realizojnë për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

"Meqë funksionimi i rregullt dhe në kohë i shërbimeve komunale paraqet një parakusht për realizimin e jetës kualitative, kemi konstatuar se mungesa apo shërbimet komunale jo të mjaftueshme, administratat lokale nuk duhet t'i arsyetojnë me mos ekzistimin e mjeteve financiare apo varësinë e tyre prej pushtetit qendror. Ankesat e dorëzuara në zyrat rajonale tonat lidhur me shërbimet komunale dhe ato publike, kryesisht kanë të bëjnë me mungesën e furnizimit me ujë apo shkyçjen nga rrjeti i ujësjellësit, mungesën e ndriçimit publik, tendenca të shumta për larjen e borxheve të vjetra, mungesë e infrastrukturës komunale e kështu me radhë", thuhet në Raportin e Avokatit të Popullit.

Numri më i madh i ankesave për shërbimet e dobëta komunale, siç thuhet në Raportin e Ombudsmanit, janë regjistruar në rajonin Kërçovës, Tetovës, Demir Hisarit dhe Manastirit. Problemet ekzistenciale të cilat i tangojnë shumë komuna në Maqedoni, sipas ekspertëve të fushës së vetëqeverisjes lokalë, në radhë të parë lidhen me numrin enorm të madh të këtyre njësive, që në vendin tonë janë të regjistruar 80 të tilla, plus Qyteti i Shkupit si njësi e posaçme e vetëqeverisjes lokale. Plotësimi apo ndryshimi i Ligjit për ndarje të re territoriale, i miratuar në vitin 2004, mendohet të jetë pikënisja prej ku duhet të fillohet dhe të zgjidhen problemet në më shumë komuna, kryesisht në ato rurale.

Veprimi në kohë i Këshillave ndërkomunal për mbrojtjen e konsumatorëve, sipas Avokatit të Popullit, paraqet njërën prej mënyrë më efikase përmes të cilave mund të përmirësohet kjo gjendje.

"Duke i pasur parasysh kompetencat e këtyre Këshillave për monitorimin e dhënies së shërbimeve publike, për shprehjen e kujdesit që këto probleme qytetarët t'i zgjidhin, për përmirësimin (avancimin) e dhënies së shërbimeve nga nëpunësit komunale drejt qytetarëve, si dhe për organizimin e tribunave publike ku do të shqyrtohen këto çështje, ne vlerësojmë se ky funksionim i Këshillave komunale duhet të bëhet realitet dhe jo vetëm, i njëjti të ekzistojë në letër", thuhet në Raportin e Avokatit të Popullit.

Në përgjithësi, Ombudsmani në raportin e vitit 2017 ka vlerësuar se kryerja e veprimtarisë komunale nga ana komunave në Maqedoni nuk është në nivelin e duhur të zhvillimit, me çka dallimet nga komuna në komunë janë tepër të mëdha. Njëkohësisht, siç thuhet në Raport, disa komuna edhe më tutje ballafaqohen me mungesë të akteve të përgjithshme, të cilat këto njësi duhej t'i kenë e të cilat do të ishin në funksion të definimit të procedurave për dhënien e shërbimeve kualitative administrative.

Agjencia e Punësimit
e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave aktive të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës gjatë vitit 2018, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për programin e angazhimit në punë – punëve publike, të financuar nga buxheti i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë, më datën **16.04.2018**bën

**SHPALLJE PUBLIKE**
**për**
**NJËSITË E VETADMINISTRIMIT LOKAL DHE QYTETIT TË SHKUPIT**

U bëhet thirrje njësive të vetadministrimit lokal dhe Qytetit të Shkupit, të cilat janë të interesuara për organizimin e punëve publike nëpërmjet angazhimit të personave që janë të ividentuar si të papunë me kualifikime të ulëta në projektet me karakter infrastrukturor dhe të mbrojtjes së mjedisit jetësor, që të paraqiten në klubin e punës së Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë – qendrën e punësimit ku është selia e NJVL-së.
Për realizimin e këtij programi është paraparë mbështetje financiare në një shumë prej 400 denarë për secilin person të angazhuar gjatë ditës, duke përfshirë këtu edhe tatimin personal për të ardhurat dhe sigurimin në rast fatkeqësie gjatë punës dhe sëmundjes profesionale.
Mjetet do të transferohen pas kalimit të angazhimit të punës në njësitë e vetadministrimit lokal dhe Qytetit të Shkupit.
Numri maksimal i personave të mbështetur për secilën komunëështë 50 persona dhe këta do të angazhohen me punë nga ana e komunave dhe qytetit të Shkupit për periudhën më së shumti deri 22 ditë.
Kushtet, të drejtat dhe detyrimet do të rregullohen me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet njësive të vetadministrimit lokal dhe Qytetit të Shkupit dhe Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë.
Shfrytëzuesit e të drejtës së ndihmës sociale gjatë kohëzgjatjes së angazhimit do të kenë aktive të drejtën e tyre për shfrytëzimin e kësaj ndihme.
Njësitë e vetadministrimit lokal dhe Qyteti i Shkupit paraqitjen e bëjnë me dorëzimin e fletëparaqitjes së formularit të unifikuar në formë të shkruar më së voni deri më **27.04.2018** në klubin e punës së Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë – qendrën e punësimit ku ndodhet selia e NJVL-së.
NJVL e interesuar dhe Qyteti i Shkupit mund t'i dorëzojnë fletëparaqitjet në qendrat e punësimit çdo ditë pune prej orës 09:00 – 14:00. Informata më të hollësishme mund të merren në klubet e qendrave të punësimit, në telefonin kontaktues 02/3111-850 si dhe në ueb faqen e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë (www.avrm.gov.mk) dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (www.mtsp.gov.mk).

AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

---

Agjencia e Punësimit
e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave aktive të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës gjatë vitit 2018, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për masën 2.2 të punësimit dhe rritjes së subjekteve juridike, të financuar nga buxheti i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë, më datën **16.04.2018** bën

**SHPALLJE PUBLIKE**
**për**
**punëdhënësit e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe organizatave qytetare**

U bëhet thirrje punëdhënësve të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, ndërmarrjeve sociale dhe organizatave qytetare, të cilët dëshirojnë që ta zgjerojnë dhe zhvillojnë biznesin e tyre me hapje të reja të vendeve të punës, që të paraqiten në klubet e qendrave të punësimit të APRM-së.
Masa e mbështetjes ka të bëjë me ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe ndërmarrjeve sociale (ndërmarrjet dhe organizatat qytetare të cilat në mënyrë parësore janë të orientuara nga qëllimet sociale dhe përfitimi i të cilave është të riinvestohet për sigurimin e këtyre qëllimeve nëpërmjet punës afariste ose investimit brenda shoqërisë) dhe organizatave qytetare të cilat i plotësojnë kushtet siç vijojnë:

- Numri i përgjithshëm i punëtorëve për kohë të pacaktuar në ditën e aplikimit nuk duhet ë jetë më i ulët se numri mesatar i personave të punësuar në kohë të pacaktuar gjatë vitit kalendarik paraprak;
- Në ditën e aplikimit t'i ketë shlyer të gjitha detyrimet në bazë tatimore dhe të kontributeve të sigurimit të detyrueshëm social;
- Të mos ketë humbje financiare gjatë vitit paraprak;
- Punëdhënësi duhet patjetër të ketë së paku një person të punësuar në vazhdimësi më së paku gjashtë muaj para aplikimit, me përjashtim të organizatave qytetare të cilat në momentin e aplikimit mund të mos kenë person të punësuar;
- Numri i personave të sapopunësuar me këtë masë nuk mund të jetë më i madh se 50 për qind nga numri mesatar i personave të punësuar në kohë të pacaktuar gjatë vitit kalendarik paraprak.
  Punëdhënësi i cili e ka të punësuar një person dhe te organizatat qytetare të cilat nuk kanë të punësuar asnjë person, numri maksimal i punësimeve të mbështetura është vetëm një person.
- Programi nuk do të mbështesë subjekte juridike të regjistruara pas datës 01.07.2017. Po ashtu shfrytëzuesit (subjektet juridike) e këtij programi nuk do të mund të shfrytëzojnë masë tjetër në bazë të njëjtë të përcaktuar me ligj të posaçëm ose në bazë të programeve të tjera të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe organeve të tjera kompetente.

(Agjencia e Punësimit në mënyrë zyrtare do t'i sigurojë të dhënat e lartpërmendura për subjektet juridike të cilat do të aplikojnë në shpalljen zyrtare).
Mbështetja financiare për hapjen e një vendi të ri të punës (më së shumti hapja e pesë vendeve të reja të punës për secilën firmë) përfshin pagesën e mjeteve të pakthyeshme për furnizime me pajisje ose materiale të reja në një shumë prej 153.750 denarë (për hapjen e secilit vend të ri të punës), me detyrimin që punëdhënësi të sapopunësuarit t'i mbajë në marrëdhënie pune me orar të plotë pune më së paku 12 muaj (për personat deri 29 vjet) ose 92.000 denarë (për hapjen e secilit vend të ri të punës), me detyrimin që punëdhënësi të sapopunësuarit t'i mbajë në marrëdhënie pune me orar të plotë pune më së paku nëntë muaj (për peprsonat deri 29 vjet) nga dita e punësimit, pa e zvogëluar numrin e përgjithshëm të të punësuarve në kohë të pacaktuar).
Kushtet, të drejtat dhe detyrimet do të rregullohen më konkretisht me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet punëdhënësve dhe APRM-së
Punëdhënësit e interesuar mund të aplikojnë deri në plotësimin e projektit të paraparë për shfrytëzuesit.
Punëdhënësit e interesuar mund t'i dorëzojnë fletëparaqitjet në qendrat e punësimit çdo ditë pune prej orës 09:00 – 14:00. Informata më të hollësishme mund të merren në klubet e qendrave të punësimit, në telefonin kontaktues 02/3111-850 si dhe në ueb faqen e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë (www.avrm.gov.mk) dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (www.mtsp.gov.mk).

AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

---

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pikat 5 dhe 6 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 5 nga 29.01. 2002), në bazë të Vendimit për realizimin e buxhetit të komunës së Tetovës për vitin 2018, **nr. 09-11954/1** nga **29.12.2017** dhe në bazë të Programit të aktiviteteve të komunës së Tetovës në fushën e Arsimit, Kulturës, Sportit, dhe mbrojtjes sociale të fëmijëve gjatë vitit **nr. 08-3633/1** nga **28.03.2018** të miratuara nga Këshilli i komunës së Tetovës, kryetari i komunës së Tetovës shpall:

**K O N K U R S**

Për përkrahje financiare të programeve dhe projekteve nga lëmi i kulturës, arsimit, sportit dhe mbrotjes sociale në interes të qytetit të Tetovës për vitin 2018:

**I.KULTURË**
- **I-1**. Përkrahje të manifestimeve dhe krijimtarive kulturore.
- **I-2**. Përkrahje e shoqërive kulturore artistike.
- **I-3**. Aktivitete të përcaktuara plotësuese kulturore, manifestime dhe shënime të ndryshme.

**II.ARSIM**
- **II-1**. Përkrahje e aktiviteteve dhe manifestimeve
- **II-2**. Përkrahje të debateve, prezantimeve dhe trajnimeve

**II.SPORT**
- **III-1**. Përkrahje e klubeve sportive dhe lidhjeve sportive
- **III-2**. Aktivitete të përcaktuara plotësuese sportive, manifestime, projekte dhe shfaqje
- **III-3**. Turnetë e ndryshme sportive

**III. MBROJTJA SOCIALE**
- **IV-1**. Organizimi i edukimeve për tejkalimin e problemeve sociale në lidhje me sjelljet devijante
- **IV-2**. Promovimi i barazisë gjinore dhe rritja e potencialit për punësim të grave
- **IV-3**. Shënimi i 15 Tetorit – Ditës ndërkombëtare të shkopit të bardhë për personat e verbër
- **IV-4**. Avancimi dhe përmirësimi i kushteve socio-ekonomike për personat me hendikep

I

Komuna e Tetovës nga buxheti vetanak për vitin 2018 do të realizojë shpërndarjen e mjeteve financiare për shoqatat kulturore, arsimore, sportive dhe organizatat joqeveritare që veprojnë në territorin e komunës dhe që japin kontribut të veçantë në zhvillimin dhe afirmimin e komunës së Tetovës.

II

Mjetet nga pika I të këtij Konkursi do t'u ndahen subjekteve nga pika 1 për punët dhe aktivitetet e tyre në bazë të projekteve të dorëzuara.

III

Aplikimi për ndarjen e mjeteve financiare patjetër të dokumentohen dhe të arsyetohen detajisht nga rezultatet e arritura të deritanishme si dhe aktiviteteve që janë planifikuar për periudhën e ardhshme.

IV

Subjektet e interesuara, së bashku me kërkesën duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:
- fletëregjistrim të subjektit;
- dokumentacion përkatës për aktivitetet dhe sukseset e deritanishme;
- plan-projekt për aktivitetet;

V

Konkursi zgjat 10 ditë, nga dita e shpalljes.
Aplikimet me dokumentacionin e nevojshëm, dorëzohen në arkivin e komunës së Tetovës rr."Dervish Carra" nr. 68 me shenjë "Konkurs për përkrahje financiare të programeve dhe projekteve nga lëmi i kulturës, arsimit, sportit dhe mbrojtjes sociale në interes të qytetit të Tetovës për vitin 2018", duke zgjedhur lëminë dhe pikën për cilën konkurron.

Aplikimet me të dhëna jo të plota, si dhe ata të cilat nuk do të dorëzohen në afatin e paraparë, nuk do të shqyrtohen.

VI

Për informata plotësuese, mund t'i drejtoheni Sektorit për Veprimtari Publike pranë komunës së Tetovës.

**KOMUNA E TETOVËS**
**Sektori për veprimtari publike**

---

REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 27/2018
për punësimin e 1 nëpunës publik nga grupi I, nëngrupi II në „Qendrën Shkollore Shtetërore të Baletit Ilija Nikolovski Luj Shkup "për vendet e punës në vijim:

1. OBN0102G02002 Referent i lartë për punë afariste - sekretar teknik II, Njësia për punë normative - juridike, burimet njerëzore dhe punë të përgjithshme, Shërbimi administrativë — 1 realizues(ë)

**Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VA ose niveli i kualifikimeve IV, sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose së paku arsim të lartë ose të mesëm, shkollën e mesme juridike, gjimnaz ose shkollën e mesme të muzikës
- së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion

**Kompetencat e përgjithshme:**
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

**Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:00 - 15:00

Rroga neto: 15.494,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

KOSOVA ME RRITJE EKONOMIKE TË PAQËNDRUESHME

## Të jetosh me 1.30 euro në ditë

Pavarësisht se Kosova në raportin e fundit të Bankës Botërore ka një parashikim pozitiv të rritjes ekonomike, ekspertët e çështjeve ekonomike dhe përfaqësues të bizneseve thonë se kjo rritje është e pamjaftueshme dhe e paqëndrueshme. Banka Botërore në raportin e saj të fundit për ekonominë në Ballkanin Perëndimor, të publikuar një ditë më parë, ka vënë në pah se Kosova ka shënuar rritje ekonomike prej 4.4 për qind në vitin 2017, kurse ndërmjet viteve 2018-2020 rritja ekonomike parashihet të arrijë në 4.8 për qind. Por, që kjo rritje ekonomike, sipas drejtorit ekzekutiv të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë Arian Zeka, nuk ofron qëndrueshmëri në aspektin e zhvillimit afatgjatë të Kosovës.
"Kjo rritje ekonomike nuk është e mjaftueshme për të përmirësuar mirëqenien sociale dhe për të ofruar një qëndrueshmëri në aspektin e zhvillimit afatgjatë të Kosovës. Ne si Odë Ekonomike Amerikane e Kosovës, por edhe nga ekspert tjerë nga mekanizmat ndërkombëtarë financiarë është thënë se realisht Kosovës i duhet një rritje ekonomike që kalon normën e 7 - 8 për qind të rritjes ekonomike", thotë Zeka për Radion Evropa e Lirë.
Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkalla e papunësisë është 30.6 për qind, kurse papunësia më e theksuar është te grup moshat 15-24 vjeç në 55.9 për qind. Derisa, rreth 17.6 për qind të popullatës në Kosovë jeton në varfëri të plotë me vetëm 1.82 euro në ditë për një person të rritur, ndërsa 5.2 për qind e popullatës jeton në varfëri ekstreme me 1.30 euro në ditë. Rritja ekonomike në Kosovë e cila kryesisht sipas Zekës, është e varur nga konsumi, nga investimet publike, nga shpenzimet qeveritare, nuk mund të jetë e qëndrueshme.
Për të realizuar rritje ekonomike të qëndrueshme, thotë Zeka, boshti i rritjes ekonomike duhet të jetë në sektorin privat. Edhe pse investimet e huaja vazhdimisht vlerësohen si mjete të domosdoshme për zhvillimin ekonomik, këto investime kanë shënuar rënie përgjatë viteve në Kosovë. Derisa në vitin 2008, investimet e huaja ishin 355 milionë euro, në vitin 2017 investimet e huaja nuk ishin më shumë se 280 milionë euro. Arian Zeka thotë se pa pasur rritje të investimeve direkte ndërkombëtare nuk mund të flitet për një rritje të përqindjes ekonomike në Kosovë.



# MBRETËRIA E TË PAPUNËVE

Të rinjtë nuk besojnë se mund të gjejnë një vend pune pa qenë pjesë e një partie apo pa e korruptuar dikë. Kjo nuk është deklaratë as e ndonjë hulumtuesi të politikave sociale e as e ndonjë qytetari të dëshpëruar, por e vetë kryetarit të Qeverisë së Kosovës. Ramush Haradinaj, ndërsa promovonte Strategjinë dhe planin e veprimit për punësimin e të rinjve, në mesjavë apeloi tek institucionet që të marrin në punë njerëz me cilësi profesionale e jo militantë të partive, shkruan Koha Ditore. E është po Haradinaj që duke shfrytëzuar kontrollin mbi pushtetin, ka legjitimuar jo vetëm drejtues të organeve qeveritare, por edhe borde të institucioneve të pavarura dhe ndërmarrje ("Trepça", Telekomi...) që në përbërjen e tyre kanë përfaqësues të partive politike. Kjo qeveri dhe të tjerat para saj kanë dëshmuar se të tërë fokusin e kanë se si t'i rehatojnë mbështetësit e tyre politikë dhe familjarët. Pasi kanë bërë këtë, janë përkujdesur që përveçse të jenë të punësuar, atyre t'u përmirësohet edhe mirëqenia. Gati asgjë nuk kanë bërë për gjysmën e popullsisë së aftë për punë e që nuk dallon nga të punësuarit, përveçse nuk kanë pasur fatin që të afërmit e tyre të vishen me pushtet. Statistikat tregojnë se shteti ka dështuar në krijimin e politikave për zvogëlimin e papunësisë që për këta 10 vjetët e fundit qëndron e pandryshuar dhe në nivele alarmante, mbi 30 për qind sipas të dhënave zyrtare e mbi 50 për qind sipas ekspertëve.

> Kjo qeveri dhe të tjerat para saj kanë dëshmuar se të tërë fokusin e kanë se si t'i rehatojnë mbështetësit e tyre politikë dhe familjarët. Pasi kanë bërë këtë, janë përkujdesur që përveçse të jenë të punësuar, atyre t'u përmirësohet edhe mirëqenia

### MBIJETESA TE FQINJËT

Autobusi i linjës së rregullt Prishtinë-Ulqin niset në orën 9 të mbrëmjes. Për të qenë i sigurt, Ramiz Gashi kishte dalë në 8:30 në Stacionin e Autobusëve në Prishtinë. Biletën e kishte prerë më herët, e për t'i mbytur minutat deri në nisje, teksa qëndronte para autobusit, ndezi një cigare. Rrugën drejt Ulqinit ai e bën çdo muaj, shkruan "Koha Ditore". Mungesa e një pune të rregullt në vendin e tij e ka shtyrë të mendojë alternativa të tjera. Dy vjet më parë, një i afërt i tij që kishte një kompani ndërtimi në qytetin malazias i kishte propozuar punë. Fasadimi i një shtëpie ishte detyra që duhej të bënte. E paga prej 400 eurosh për Ramizin ishte goxha e leverdishme. Gjatë asaj kohe ai punonte në një kompani ndërtimi në Kosovë, porse thotë se për më shumë se 2 muaj nuk ia kishte ndarë rrogën. Pranimin e ofertës së re s'e kishte menduar dy herë. "Fitimi del diku 100 euro më shumë se këtu në Kosovë. Mund të dalin deri në 1 mijë euro, por unë s'i marr aq. E këtu, në Kosovë, s'ke punë rregullisht,nga 2-3 muaj s'ta jep rrogën e 'ta merr shpirtin'. Duhet me mbijetu diqysh", rrëfen ai derisa nxjerr nga goja shtëllungën e tymit të fundit të cigares.

### KOSOVA, PA MARRËVESHJE PUNËSIMI SEZONAL ME VENDET E BE-SË

Autoritetet e Kosovës nuk kanë arritur të nënshkruajnë asnjë marrëveshje të re me ndonjë nga shtetet e Bashkimit Evropian për punësim sezonal të qytetarëve të Kosovës. Mimoza Kqiku, këshilltare për informim e Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, thotë për Radion Evropa e Lirë se janë në përpjekje të arritjes së një marrëveshjeje me ndonjë nga vendet e BE-së për punësim sezonal, mirëpo deri më tani nuk ka asgjë konkrete. "Aktualisht, ne nuk kemi ndonjë marrëveshje me ndonjë nga shtetet e Bashkimit Evropian për punësim sezonal të qytetarëve tanë në këto shtete përkatëse, por jemi duke bërë përpjekje maksimale, jemi duke u takuar me ambasadorët e këtyre shteteve që të paktën të kemi në marrëveshje të tillë deri në fund të këtij viti", thotë Kqiku. Papunësia është një nga problemet më të mëdha që ka përcjellë shoqërinë kosovare viteve të fundit. Shkalla e papunësisë në Kosovë, sipas të dhënave zyrtare është mbi 30 për qind. Nisur nga ky nivel i lartë i papunësisë, punësimi sezonal në vendet e Bashkimit Evropian konsiderohet si një mundësi e mirë për të rinjtë. Në të kaluarën Kosova ka pasur marrëveshje për punësim sezonal me shtetin e Gjermanisë. Përfaqësues të bizneseve kërkojnë më shumë angazhim institucional për arritjen e marrëveshjeve për punësim sezonal.

Kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit, Agim Shahini, thotë për Radion Evropa e Lirë se derisa mundësitë për rritjen e numrit të të punësuarve në Kosovë janë shumë të vogla, alternativa më e mirë është punësimi sezonal. "Punësimi sezonal në të kaluarën ka ndodhur edhe në tregun e punës në Kosovë dhe jashtë vendit, por jashtë vendit ka qenë një numër i vogël karshi kërkesave që ka pasur. Është neglizhencë e institucioneve të vendit që nuk kanë qenë angazhuar në arritjen e marrëveshjeve me vendet e BE-së për këtë punësim. Punësimin sezonal e ka vështirësuar edhe mosliberalizimi i vizave", thotë Shahini.

Të rinj të anketuar nga Radio Evropa e Lirë, thonë se do të punonin punë sezonale kudo dhe në cilindo shtet ku do t'u ishte ofruar mundësia. Arlinda, një e re nga qyteti i Podujevës thotë se do t'i ndihmonte një punë sezonale në ndonjë nga vendet e BE-së dhe në Kosovë, por ofertat për një gjë të tillë, janë të pakta. "Unë kam përfunduar shkollën e mesme tani jam duke bërë një praktikë si laborante e biologjisë. Sikur të kisha ndonjë ofertë për punë sezonale do ta pranoja me shumë dëshirë, porse nuk ka oferta të tilla në tregun e Kosovës", thotë ajo.

Alban Reka thotë se interesimi i të rinjve për punë sezonale nuk mungon, por institucionet, sipas tij, nuk kanë bërë asgjë për të krijuar mundësi të tilla për të rinjtë. "Patjetër që do të punoja punë sezonale. Është një punë që do të ndihmonte mirë ekonomikisht", shprehet Albani. Ndryshe, në tregun e punës në Kosovë, sipas të dhënave të zyrtare, çdo vit hyjnë 25 deri në 30 mijë të rinj, të cilët konsiderohen të aftë për punë.

# Takoni njerëzit e post-Fejsbuktopias

*Nga*
Ingrid OSTBY





Një shkelje me të dhënat e përdoruesve në vitin 2018 AD, shkaktoi një eksod masiv nga Fejsbuku. Menjëherë pas kësaj, u krijua një shoqëri e re, e përbërë nga ata që i fshinë fare llogaritë e tyre. Ata u nisën të bëjnë një jetë idilike, në një vend që e quajtën post-Fejsbuktopia, ku gjithësecili mund të jetonte në paqe, të çliruar prej barrës së përditësimeve dhe ndërveprimeve sekondë pas sekonde. Ose të paktën kështu shpresonin... Ja disa histori të vërteta të "banorëve" të post-Fejsbuktopisë:

Një shitës librash, që nuk dinte më si të promovonte biznesin e tij, pa e patur atë që dikur e quante "community page", u kërkon kalimtarëve të shkruajnë vlerësime mbi dyqanin e tij mbi një copë letër, të cilat i lexon më pas, në shtëpi, për t'u siguruar që po ecën mirë. Në fakt, nga pikëpamja monetare, biznesi i tij po ecën mirë. Dhe ka shumë vizitorë. Por pa komente, pyet veten ai, si mund ta dijë që njerëzve u ka pëlqyer vërtetë? Një nënë në të tridhjetat lind fëmijën e dytë. I bën shumë fotografi të sapolindurit, por nuk di ku t'i hedhë. "Fotografia e parë e Parkas që postuam mori më shumë se njëqind like-s", i thotë të shoqit. "Pa Fejsbukun, si do ta njohin njerëzit Takein?" E mbërthen paniku, dhe nis të qajë. "Nëse fotografia e saj nuk postohet, si do e dinë që ekziston? As nuk do e dinë që ka lindur!"

I shoqi ndërhyn dhe vendos ta shpjerë fëmijën tek nëna e tij. "Do të jetë e sigurt atje", pëshpërit. Ndërkohë që shkon me makinë tek e ëma, mendon për një mik të shkollës së mesme, me të cilin ishte rilidhur në Fejsbuk. "Kushedi ku do jetë tani", thotë me mendje, duke kujtuar Fejsbukun e mikut, që ishte i mbushur me filmime, mbi mënyrën se si funksionojnë gjërat. "Sa djalë interesant". Bebja buzëqesh vesh më vesh në sediljen e pasme, e mahnitur prej bukurisë së natyrës. Një burrë, i cili sipas profilit të tij në Fejsbuk, më parë bënte "shpërndarësin e meme-ve", rri ulur në kompjuter, me një pamje të mjerë. Kërkon në Google "qenë qesharakë", por asnjë prej fotografive nuk shoqërohet me tekst, që të shpjegojë përse qentë janë qesharakë. Si mund ta di unë si të ndjehem nga kjo fotografi, mendon me vete, nëse ajo nuk ka as fjalë? Në gjumë, e dashura e dëgjon shpesh që të thotë me zë të lartë "T.F.W.", apo "emoji që qajnë dhe qeshin, hahaha".

Një grua, që prej vitesh është konsideruar aktiviste Fejsbuku, ndodhet në shtëpi duke lexuar artikuj mbi padrejtësitë. Më pas i dërgon mesazh të gjithë personave që ka në listën e kontakteve. Mesazhi përmban listën e link-eve të artikujve, me shënime si: "NDërkohë që ju po shijonit privilegjin tuaj, këtyre njerëzve po u mohoheshin të drejtat themelore". Një mike i përgjigjet: "Sa e trishtë". Një tjetër: "Becca, pse nuk ishe në marshim të shtunën?" Becca e mendon këtë pyetje. "Marshimi...", thotë me vete. "Duhet ta bëj këtë, një prej këtyre ditëve". Vazhdon të lexojë, e zemëruar me çdo person kontakti që nuk u është përgjigjur mesazheve të saj. Një djalë, i cili kish qenë analist i respektuar i mediave sociale në kohën kur mbretëronte Zuckerbergu, ndjehet i humbur. Çdo javë zhytet gjithmonë e më shumë në mani, duke pëshpëritur marrëzi si "koha e ditës ka rëndësi", "pikëpamjet janë të rëndësishme, klikimet jo", "ndarjet e postimeve kanë rëndësi, shikimet jo", "drejtoje trafikun në faqen e internetit" e kështu me radhë. As ai nuk e kupton më veten. Teksa ndodhen në radhë në dyqanin pranë shtëpisë, një ish koleg e njeh dhe i thotë duke qeshur: "Sapo e sajove këtë, apo jo?" Ish analisti, pasi ka hequr dorë nga gjithë mbrojtjet e të shkuarës, ngre supet dhe përgjigjet: "Sapo kam marrë diplomë në rusisht".

**Më anormalja e qytetit, një grua që nuk kish qenë kurrë në Fejsbuk, rri ulur e lumtur bashkë me familjen, në oborrin e pasëm të shtëpisë. "Ajo nuk e di se si ka qenë dikur", thonë ata me helm të fshehur, duke i hedhur vështrime vjedhurazi gruas dhe fëmijëve të saj që qeshin me gjithë zemër. Dhe e përsërisin, këtë herë me keqardhje: "Ajo nuk e di se si ishte më parë"**

Më anormalja e qytetit, një grua që nuk kish qenë kurrë në Fejsbuk, rri ulur e lumtur bashkë me familjen, në oborrin e pasëm të shtëpisë. "Ajo nuk e di se si ka qenë dikur", thonë ata me helm të fshehur, duke i hedhur vështrime vjedhurazi gruas dhe fëmijëve të saj që qeshin me gjithë zemër. Dhe e përsërisin, këtë herë me keqardhje: "Ajo nuk e di se si ishte më parë". (The New Yorker)

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS




Koha
E përditshme informative
www.koha.mk
Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi
Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 15 prill | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
**E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222** | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup
**NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772**

# Problemi i Hungarisë dhe vendeve të tjera euroskeptike



*Nga*
**Bernard GUETTA**




> Mbretëria e Bashkuar vuan kaq shumë nga Brexit, saqë idetë për të dalë nga Bashkimi ose euro nuk janë më shumë të preferuara në Evropë. Pas sanksionimit të humbjes së Le Pen, këto pozicione u braktisën shumë shpejt nga të gjithë armiqtë e Unionit, të cilët përndryshe nuk do të kishin arritur sukseset e kohëve të fundit

Nuk do të jetë e lehtë. Më 17 prill, kur Emmanuel Macron do të shkojë në Parlamentin Evropian për të mbrojtur vizionin e tij për BE-në, dhe për të hapur praktikisht fushatën elektorale për zgjedhjet evropiane të vitit 2019, të gjithë do të mendojnë se ai vërtet beson dhe është i sinqertë.

Megjithatë, rizgjedhja triumfante e Viktor Orbanit në Hungari, qëndrimi ekstrem i shprehur kolektivisht nga Hollanda dhe shtatë shtete të tjera veriore, përballë idesë franceze të krijimit të një buxheti të përbashkët të eurozonës, përparimi i euroskeptikëve në Itali dhe sidomos maturia e detyruar e Angela Merkelit, e cila duhet të marrë parasysh krahun e djathtë të partisë së saj, frenojnë propozimet e Macronit. Për këtë arsye, edhe mbështetësit e lindjes progresive të një bashkimi politik brenda Evropës mund të mendojnë se presidenti francez, i cili në mbrëmjen e zgjedhjes së tij këndoi himnin evropian, nuk i ka mjetet për të realizuar ambicien e tij. Por a janë vërtet kështu gjërat?

Le të analizojmë pikat një për një. Triumfi i Orbán më 8 prill do të thotë se Polonia, Sllovakia dhe Republika Çeke do të mbështeten më shumë se kurrë tek Hungaria, për të afirmuar sovranitetin e Evropës qendrore. Me një shumicë liberiste, Evropa Veriore do të vazhdojë të kërkojë një ekuilibër në llogaritë publike, përpara se të pranojë qoftë edhe një investim minimal të përbashkët. Italia do të mbetet pa qeveri për një kohë të gjatë, ose më keq, mund të afrohet me sovranistët e Evropës qendrore. Dhe në fund, kancelarja gjermane nuk do të ketë shumë hapësirë për manovrim. Situata, shkurt, nuk duket veçanërisht inkurajuese, por në të njëjtën kohë nuk duhet të harrojmë se rritja ekonomike në Bashkim po fiton vrull, ndërsa papunësia po bie, madje edhe në Francë. Evropianët e kuptojnë këtë, dhe prova më e mirë është kthimi spektakolar i kërkesave sociale në Gjermani dhe Francë. Mbretëria e Bashkuar vuan kaq shumë nga Brexit, saqë idetë për të dalë nga Bashkimi ose euro nuk janë më shumë të preferuara në Evropë. Pas sanksionimit të humbjes së Le Pen, këto pozicione u braktisën shumë shpejt nga të gjithë armiqtë e Unionit, të cilët përndryshe nuk do të kishin arritur sukseset e kohëve të fundit. Sa i përket Hungarisë dhe fqinjëve të saj, ata janë të kujdesshëm që të mos shkëputen nga BE, sepse e dinë se sa i dobishëm është solidariteti evropian për ta.

Me pak fjalë, në Evropë nuk ka shumicë vendimtare për të shkatërruar unitetin, sidomos sepse është e qartë që, në një kohë të shënuar nga kaosi në Lindjen e Mesme dhe deklaratat e Trumpit dhe Putinit, ne evropianët kemi një interes jetik për shtrëngimin e radhëve, dhe të mbrojmë së bashku nivelin tonë të lirisë dhe të mbrojtjes sociale, e cila nuk ka të ngjashëm në pjesën tjetër të botës. Nuk do të jetë e lehtë, por e gjithë kjo mund të përmblidhet në një fjali: nëse nuk ju pëlqen Bashkimi Evropian, provoni të shihni se si është shpërbërja. *(France Inter)*

# Trumpi imoral, si një bos i mafies

> Udhëheqësi një ditë premton që të dëbojë të gjithë nga Departamenti i Drejtësisë; një ditë tjetër shfaqet i disponueshëm për të bashkëpunuar me prokurorin e tij. Në të njëjtën kohë përpiqet të ndreqë marrëdhënien me Melanian: gjatë pushimeve të Pashkëve në vendpushimin e Mar-a-Lagos ka darkuar dy herë vetëm me të shoqen

Janë ditë kaosi në Uashingtonin e Donald Trumpit. Presidenti poston në Tuiter, paralajmëron, tërhiqet, kërcënon, fyen. Dhe fut në rreth vicioz Kongresin, mediat, qeveritë aleate. Të mërkurën më 11 prill, për shembull: kongresmenët republikanë fillimisht kishin lëvduar 'burrin e shtetit" që kishte vendosur të ndëshkonte Bashar al Assadin. Por menjëherë u futën në alarm, sepse po ky "burrë shteti" do të donte të shkarkonte super prokurorin Robert Mueller, duke hapur një krizë kushtetuese të paprecedentë.



Por jeta publike e "The Donald" është tashmë një zgjatim i jetës private. Siç premton ta konfirmojë libri që pritet të dalë i James Comeyt, drejtori i FB që Trumpi e dëboi në maj të 2017-ës. Shtypi amerikan dje ka botuar disa pjesë. Për superpolicin amerikan, udhëheqësi i vendit është një "figurë imorale, si një bos mafioz, një personazh tërësisht i shkëputur nga e vërteta, që dominohet prej egos". Libri përmban një sërë episodesh. Për shembull rrëfen se si presidenti i kërkoi Comeyt që të hetojë jo ndërhyrjet e Moskës, por zërat mbi marrëdhëniet e tij me prostituta ruse. Donte t'i tregonte bashkëshortes, Melania, se këto ishin akuza të gënjeshtërta.

Donald Trump fabrikon vazhdimisht konfuzion, të cilit i shtohet edhe ai që vjen nga e shkuara. Hetimi i Mueller mbi Russiagate është një fshesë me korrent gjithnjë e më e fryrë. Së fundmi ka thithur letrat e sekuestruara Michael Cohenit, avokat dhe ruajtës i sekreteve të Trumpit: marrëdhëniet me pornostare dhe modele, transaksionet e biznesit dhe ndoshta, edhe llogaritë e vërteta financiare të grupit, taksat dhe borxhet. Udhëheqësi një ditë premton që të dëbojë të gjithë nga Departamenti i Drejtësisë; një ditë tjetër shfaqet i disponueshëm për të bashkëpunuar me prokurorin e tij. Në të njëjtën kohë përpiqet të ndreqë marrëdhënien me Melanian: gjatë pushimeve të Pashkëve në vendpushimin e Mar-a-Lagos ka darkuar dy herë vetëm me të shoqen. Një rekord, thonë. Vitin e kaluar, pikërisht në këtë kohë, "Uashington Post" botoi një karikaturë që ka mbetur e pakalueshme. Trumpi sapo është kthyer nga udhëtimi në Arabinë Saudite: bankete dhe vallja e shpatave. Tani është ulur në Zyrën Ovale, ndërkohë që vërvit kordhën e kujtimeve duke shkatërruar gjithçka.

E vështirë të thuash nëse ndjek me vetëdije "strategjinë e kaosit", apo që thjesht nuk di të bëjë gjë tjetër. Rezultati, sido që të jetë, nuk ndryshon. Disa javë më parë, një funksionar rrëfente për Corriere della Sera: "E gjithë administrata e nis ditën me postimet e tij në Tuiter. Por praktikisht askush nuk i konsideron urdhëra ekzekutivë. Më shumë i shohim si pikënisje".

Është skema që po adopton shefi i kabinetit, gjenerali John Kelly. Nis me një të shtënë, një hiperbolë trumpiane, dhe avash-avash mbërrihet në një zgjidhje më të pajtueshme me standartet e qeverisjes. Problemi është se filtrat bllokohen shpejt. Trumpi nuk e duron dot mbikëqyrjen. "Ai do që të menaxhojë, jo që të menaxhohet", ka thënë për CNN Roger Stone, lobist konservator, mentor të paktën prej tridhjetë vitesh i ndërtuesit njujorkez. Tani është momenti i "kabinetit të luftës", me ish ambasadorin në OKB John Bolton, këshilltar për sigurinë kombëtare dhe Mike Pompeo drejt postit të Sekretarit të Shtetit, i cili dje u paraqit në Senat për dëgjesën e konfirmimit, me këto fjalë: "Lufta është burimi i fundit". Bolton që tani ka hyrë në rrugën e përplasjes me Sekretarin e Mbrojtjes, James Mattis. Por do të shohim, është vetëm fillimi i revolucionit të radhës. Edhe fëmijët e presidentit janë të shastisur. Në kulmin e krizës siriane, Trumpi dërgoi të bijën Ivanka, teorikisht këshilltare e parë, dhe bashkëshortin e saj Jared Kushner, për të zgjidhur konfliktet në Lindjen e Mesme në ... Peru. Do i bëjë shoqëri zëvendës presidentit Mike Pence, në samitin e kotë të Amerikave.

*(Corriere della Sera)*

Koha për Sport

Koha, e hënë 16 prill, 2018

## Rikardo triumfon në Shangai




Daniel Rikiardo triumfon në Çminin e Madh të Kinës në Formula 1. Piloti Australian i Red Bullit edhe pse e nisi nga pozicioni i katërt u shfaq fantasti në pistën e Shangait, duke e kaluar i pari vijën e finishit. Rezultoi efikase strategjia e Red Bullit me "pit stopet" e Rikiardos dhe Verstappen në rolin e "safety car". Valtery Bottas, pasi parakaloi Fettelin, duke marrë pozicionin e parë, iu desh trë kënaqej në fund me vendin e dytë. Kimi Raikkonen e mbylli garën në vendin e tretë. Në xhiron e 44-t, Verstappen preku në Fettelin në tentativë për ta parakaluar, duke e dëmtuar "kokëkuqen" e gjermanit, që në fund e mbylli garën në vendin e tetë.



## Useini mban Flamurtarin në garën për Evropë

Shkup, 15 dhjetor - Muhamed Useini me golin e tij në minutat e fundit ishte ai që vulosi fitoren e Flamurtarit në transfertën ndaj Lushnjës. Një sukses ky që ka rikthyer optimizmin te skuadra vlonjate që sipas mesfushorit tetovar vazhdon të synojë Evropën edhe nëpërmjet kampionatit. "Tre pikët janë njësoj me çdo ekip, Lushnja po bën lojën e saj. Ishte e vështirë, e dinim këtë gjë. Me impenjim maksimal, arritëm të merrnim tre pikët. por besoj se do jetë gati në vazhdimësi.

Objektivi ynë që në fillim ka qenë Evropa. Nuk kemi qenë ndonjëherë afër mbijetesës. Tani kemi Kupën, dhe do provojmë aty", u shpreh ish-mesfushori i Shkëndijës. Useini u ndal të fliste edhe për krizën që ka përfshirë Flamurtarin gjatë gjithë kësaj periudhe. "Kriza është normale tek të gjitha ekipet, zgjati pak si shumë tek ne. Patëm mungesa, kartonë e dëmtime, në disa ndeshje na ktheu edhe fati shpinën.

Kur mblidhen të gjitha bashkë, erdhi dhe kjo periudhë e errët për ne", përfundoi Useini. Pas kësaj fitore, Flamurtari gjendet në pozitën e gjashtë me 40 pikë të grumbulluara, pesë më pak se Partizani në pozitën e tretë.

LIGA E DYTË – PERËNDIM

# GOSTIVARI LËSHON KREUN, VËLLAZËRIMI MUND ZAJAZIN

Autor i golit të fitores për Vëllazërimin ishte Albulen Imeri, gol ky i cili mundëson skuadrës kërçovare të shpreson në plasman në Ligën e parë futbollistike të Maqedonisë. Në anën tjetër, Gostivari me humbjen nga Teteksi, humbi edhe pozitën e parë



*Shkup, 15 prill* - Skuadra e Teteksit në terren nikoqir ka fituar tre pikë të mëdha pasi në derbin super interesante ka mundur me 2-0 skuadrën e Gostivarit, i cili deri para kësaj ndeshje ishte lider i tabelës së klasifikimit. Të udhëhequr nga trajneri Jakovleviq dhe Knezheviq, futbollistët e Teteksit po marshojnë drejt mbijetesës, me çka arritën fitore të re, kësaj radhe ndaj skuadrës së Gostivarit e cila para ndeshjes ishte favorite. Golin e parë dhe paralajmërimin e fitores e shënoi Mentor Salii, derisa fituesin e vulosi Jovanovski. Derisa, pas kësaj humbje, lider i ri në Ligën e dytë – Perëndim është skuadra e Makedonija Gj.P. Skuadra shkupjane shfrytëzoi humbjen e gostivarasve dhe me fitoren 3-0 ndaj Lokomotivës, tani janë në krye të tabelës. Ndryshe, në këtë xhiro fitore kanë arritur dy skuadrat tjera shqiptare, Struga Trim Lum, Vëllazërimi dhe Labunishta. Me rezultatin 1-0 struganët mundën Novacin me 1-0, ku autor i golit ishte Antonio Kollanoski, Vëllazërimi gjithashtu me 0-1 mundi skuadrën e Zajazit në derbin shqiptar, derisa Labunishta me 3-1 Euromilkun. Autor i golit të fitores për Vëllazërimin ishte Albulen Imeri, gol ky i cili mundëson skuadrës kërçovare të shpreson në plasman në Ligën e parë futbollistike të Maqedonisë. Derisa, opinionin e tij pas përfundimit të ndeshjes e ka dhënë edhe trajneri i Vëllazërimit, Xhengis Rexhepi. "Fillimisht dua të falënderoj KF Zajazin për mikpritjen dhe ndeshjen fer dhe korrekte. Sa i përket ndeshjes, e filluam shumë mirë, ishim të organizuar dhe koncentruar me vetëm një qëllimi që të fitojmë tre pikët. Gjatë pjesës së parë dhe të dytë përpos golit të shënuar humbëm shumë raste, nuk mund ta veçoja asnjërin se gati çdo pozicion i humbur ishte qind për qind dhe rezultati mund ishte shumë më i thellë. Mirëpo, pakujdesia, reagimi i shpejtë dhe i gabueshëm i futbollistëve të mijë, shkaktoi nervozë dhe frikë para golit në çdo pozicion në aspektin sulmues. Gjatë kampionatit ndodhin gjëra të tilla, prandaj duhet të jemi më të kujdesur për ndeshjet e ardhshme", deklaroi Rexhepi.

| REZULTATET: | |
|---|---|
| LABUNISHTA – EUROMILKU | 3-1 |
| TETEKSI – GOSTIVARI | 2-0 |
| LOKOMOTIVA – MKD.GJ.P. | 0-3 |
| ZAJAZI – VËLLAZËRIMI | 0-1 |
| NOVACI - STRUGA TL | 0-1 |

TJETËR MIQËSORE PËR PANUÇIN

## Shqipëria do të sfidohet nga Jordania

Kombëtarja e Shqipërisë do të luajë një tjetër ndeshje miqësore dhe këtë herë kundërshtari i kuqezinjve mund të jetë Jordania. Deri tani, e konfirmuar është miqësorja përballë Uellsit që do të luhet më 20 nëntor në "Elbasan Arena", ndërkohë që "Sky Sport" raporton se me 10 tetor do të luhet ndeshja Shqipëri-Jordani. Në kalendarin e bërë publik nga media italiane, ndeshja ndaj Jordanisë do të luhet në orën 20:45, por nuk është përcaktuar ende vendi se ku do të zhvillohet.

Ky lajm nuk është konfirmuar zyrtarisht nga FSHF-ja, ndërkohë që testi ndaj Jordanisë do t'i shërbente teknikut Panuçi për të parë formën e skuadrës para ndeshjes së dytë përballë Izraelit. Shqipëria do të luajë edhe 2 miqësore të tjera në muajin maj, ku njëri nga kundërshtarët pritet të jetë Ukraina, ndërkohë që kundërshtari tjetër nuk është mësuar ende.

MUNDJE, KAMPIONATI PËR JUNIOR NË PRILEP

## "Liria" bindshëm e para

Shkup, 15 prill - Në kampionatin zgjedhor për junior, organizuar të shtunën në Prilep, Klubi i Mundjes "Liria" fitoi gjashtë medalje duke u shpallur kështu si klubi më i suksesshëm në Maqedoni. Kampion të Maqedonisë në moshën deri 20 vjeç arritën të shpallen: Halit Osmani (57 kg), Elmedin Sejfullau (61 kg), Riad Rexhepi (65 kg), Shaip Brava (70 kg), Omer Sejfullau (74 kg) si dhe Stole Eftimov (79 kg), katër vendet e dyta i fituan Minir Rexhepi (57 kg), Fati Vejseli (61 kg), Astrit Ismaili (74 kg) dhe Uvejs Fejzullau (86 kg), derisa në pozitën e tretë u ndalën Ruzhdi Elezi (65 kg) dhe Orhan Xhaferi (70 kg). Ndërkohë, në plasmanin ekipor dominoi KM "Liria" me 50 pikë të fituara, para "Tefejuzit" të vendit të dytë me 11 dhe "Ballkanec" në vendin e tretë me 10 pikë të grumbulluara.



PASI FITON TITULLIN KAMPION NË PREMIER LIGË

# MBAPPE "DHURATA" E SITIT PËR TRAJNERIN GUARDIOLA




Pasi pagoi 222 milionë euro për të marrë Nejmarin nga Barcelona dhe 180 milionë euro për të marrë Kylian Mbappe nga Monako, skuadra e Paris Sen Zhermen është e detyruar të shesë dhe Mbappen duket i sakrifikuari. Për këtë arsye, skuadra e Mançester Siti është gati të hidhet në sulm për të marrë talentin 20-vjeçar, ku do të formonte një sulm ëndrrash me Sergjo Aguero dhe Gabriel Jesus

Sulmuesi francez Kylian Mbappe do të jetë "dhurata" që drejtuesit e Mançester Siti do t'i bëjnë trajnerit Pep Guardiola me rastin e fitimit të Premier Ligës. Edhe pse ky titull nuk ka ardhur ende matematikisht, gjithçka thuajse është e mbyllur. Skuadra franceze e Paris Sen Zhermen ka nevojë për arkëtime për të respektuar rregullat e "fair play financiar", ndaj dikush nga yjet do të largohet. Pasi pagoi 222 milionë euro për të marrë Nejmarin nga Barcelona dhe 180 milionë euro për të marrë Kylian Mbappe nga Monako, skuadra e Paris Sen Zhermen është e detyruar të shesë dhe Mbappen duket i sakrifikuari. Për këtë arsye, skuadra e Mançester Siti është gati të hidhet në sulm për të marrë talentin 20-vjeçar, ku do të formonte një sulm ëndrrash me Sergjo Aguero dhe Gabriel Jesus. Kjo shitje e Paris Sen Zhermenit është e detyruar për të evituar dënime nga ana e UEFA-s në lidhje me bilancet. Edhe Pep Guardiola duket se është i kënaqur nga "dhurata" që do t'i bëjnë drejtuesit, duke qenë se i pëlqen të punojë me lojtarët e rinj, madje trajneri spanjoll e kërkoi që vjet talentin francez, por nuk arriti t'ia rrëmbejë skuadrës së Monako. Ndaj Mançester Siti është gati të nisë një sulm ndaj lojtarit francez, për ta sjellë në Premier Ligë sezonin e ardhshëm.

## Bajerni nis bisedimet me Realin për Maskarellin

Omar Maskarell është në listën e dëshirave të Bajern Munch. Mesfushori është një lojtar kyç nën drejtimin e Niko Kovaç te Aintraht Frankfurt dhe trajneri kërkon ta marrë me vete te Bajerni sezonin e ardhshëm. Por, Bajerni duhet të negociojë me Real Madridin, që pritet të paguajë klauzolën e blerjes së Maskarell për 4 milionë euro këtë verë. Vendimi i transferimit do të merret nga kushdo që do të jetë trajneri i Real Madridit për sezonin tjetër. Shumë prej mesfushorëve si Kasemiro, Modriç, Kroos dhe Kovaçiç do të kthehen vonë pas Kupës së Botës dhe Omar pritet të jetë pjesë e skuadrës në turin e verës. Në miqësoret që Madrid do të luajë në korrik, ai do të ketë mundësinë të tregojë sesa vlen. Bajerni po përgatit një shumë të denjë për Maskarell, të cilin Kovaç e mendon si përforcimin e duhur për sezonin tjetër. Gjithsesi Madridi nuk do ta lërë aq kollaj talentin duke forcuar një rival direk në Çampions Ligë.



## Zbulohet e vërteta për Grizmannin

Antoine Grizmann ka qenë vazhdimisht i lidhur me një lëvizje në Barcelonë për sezonin e ardhshëm, por zëdhënësi i Atletico Madrid, Klemente Villaverde këmbëngul, se asnjë klub nuk ka kërkuar informacion për sulmuesin e Francës. Barça thuhet se do të nënshkruajë me një sulmues tjetër të klasit botëror në fund të sezonit 2017-2018, pasi ata duan të forcojnë skuadrën e tyre pas largimit të Nejmar në Paris SZH gushtin e kaluar për shifrën rekord 222 milionë euro. Kutinjo dhe Dembele janë afruar në "Camp Nou" për të forcuar katalanasit dhe në të njëjtën kohë për të zëvendësuar yllin brazilian, ndonëse asnjëri prej tyre ende nuk ka pasur një ndikim të madh. Madje Dembele deri tani konsiderohet si dështim, pasi për asnjë moment nuk ka treguar asgjë nga repertori i tij. Raportet tregojnë se drejtuesit e Barcelonës dhe Grizmann kanë nisur kontaktet për një transferim në verë, pasi Atletiko po përgatitet të shtrëngojë dhëmbët për klauzolën e lirimit të lojtarit duke rënë nga 200 milionë euro në 100 milionë euro më 1 korrik. Megjithatë, drejtuesit e Atletiko janë të bindur se nuk kanë pasur diskutime me asnjë klub për yllin francez, që ka pranuar, se do t'i pëlqente të luante për një klub të madh. Villaverde i tha "Mundo Deportivo": "Për momentin mund të them se ai është një lojtar i Atletiko Madrid dhe unë vetëm mund të flas për fakte dhe realitetin, jo për të ardhmen. Ai ka një kontratë me ne. Askush nuk e ka kërkuar atë. Grizmann është një lojtar i Atletiko dhe unë nuk di asgjë për Barçën". Grizmann ka grumbulluar 27 ndeshje për Atletiko Madrid këtë sezon në La Liga duke shënuar 18 gola. Pasi e nisi keq sezonin, duket se francezi është rikthyer në formën e tij më të mirë duke qenë përcaktues për klubin në momentin më vendimtar të sezonit.




## Interi dhe Juventusi sfidohen për talentin Kristante

Pas Roberto Gagliardinit dhe Andrea Konti, një tjetër lojtar i Atalantas së mrekullive të Gasperinit duket se do të largohet nga Bergamo për të provuar fatin diku tjetër. Edhe pse sezoni nuk është mbyllur akoma, puna për merkaton e verës duket se ka filluar dhe janë të shumta klubet që kanë filluar të hedhin hapat e parë për të siguruar elementët më të çmuar. Mes këtyre është edhe Bryan Kristante. Për largimin e tij të mundshëm ka folur vetë presidenti i Atalantas, Antonio Precassi. "Kristante është përmirësuar, meriton një ekip të madh. Nuk është vetëm Interi që interesohet për të, por edhe skuadra të tjera. Të shohim se çfarë do të ndodhë në fund të kampionatit", tha Precassi. I vlerësuar rreth 30 milionë euro nga Atalanta, Kristante ndiqet nga afër edhe nga Juventusi. Në planet e dyshes së merkatos të Juventusit, Marotta dhe Paratici, përveç Barella dhe Pelegrini, është edhe lojtari i rritur te Milani dhe që ka shpërthyer tek Atalanta. Por, misioni i bardhezinjve nuk do të jetë i lehtë për t'u realizuar sepse Interi nuk ka ndërmend të tërhiqet.



## E kam vendosur të ardhmen

Andres Iniesta ka thënë se ai e ka marrë vendimin për të ardhmen e tij, por në fillim do të flasë me drejtuesit e Barcelonës. Kontrata e 33-vjeçarit përfundon në fund të këtij kampionati dhe ai ka marrë oferta të majme nga klube të Super Ligës në Kinë. "E kam vendosur se çfarë do të bëj", – tha Iniesta. "Gjithmonë kam pasur ngrohtësinë e tifozëve dhe i falënderoj ata për atë që më kanë dhënë në më shumë se 20 vite. Sot jam i lumtur për fitoren ndaj Valencias, sepse fitimi i titullit është gjithnjë e më parë dhe kjo nuk është e lehtë. Për të ardhmen do të flas me drejtuesit në fund të La Liga", u shpreh Iniesta. Gjithashtu, Iniesta ka mohuar zërat se ka pasur një sherr mes futbollistëve të Roma dhe trajnerit Ernesto Valverde, pas humbjes 3-0 në Itali. "Debatet me trajnerit kanë qenë zero. Futbollistët janë ata që zbresin në fushë dhe praktikisht ende nuk e kemi kuptuar se çfarë ndodhi në Romë. Janë gjëra që i përkasin futbollit, ashtu si përmbysja jonë ndaj PSZH një vit më parë", përfundoi Iniesta.



BUFFON THYEN HESHTJEN

# NUK KAM PSE KËRKOJ FALJE

"Nuk kam pse kërkoj falje pasi jam një qenie njerëzore me shumë pasion dhe ndjenja. Ky jam unë, ndonjëherë mund të duket e tepërt, por ky jam unë, Gjiigji Buffon. Thashë atë që kisha në mendje dhe pikë. Në atë moment, nuk mund t'i kërkosh një njeriu që jeton me sportin të jetë i balancuar pasi megjithëse mund të kenë qenë të ekzagjeruar, kanë qenë mendime logjike. Do t'i thosha prapë të gjitha", pohon Buffon




Kapiteni i Juventusit Gjigji Buffon mbron komentet e tij për arbitrin Majkëll Oliver. Portieri është larguar me karton të kuq në ndeshjen ndaj Real Madridit për protestat pas akordimit të penalltisë në sekondat e fundit. Buffon është kritikuar për komentet e tij por tani ka thyer heshtjen. "Nuk kam pse kërkoj falje pasi jam një qenie njerëzore me shumë pasion dhe ndjenja. Ky jam unë, ndonjëherë mund të duket e tepërt, por ky jam unë, Gjiigji Buffon. Thashë atë që kisha në mendje dhe pikë. Në atë moment, nuk mund t'i kërkosh një njeriu që jeton me sportin të jetë i balancuar pasi megjithëse mund të kenë qenë të ekzagjeruar, kanë qenë mendime logjike. Do t'i thosha prapë të gjitha", pohon Buffon. Ai thotë se arbitri Oliver nuk është dashur të akordon penalltinë. "Mbase me një gjuhë tjetër, një më të civilizuar, le të themi. Një arbitër me eksperiencë nuk do të kishte vërshëllyer por do të kishte lënë dy ekipet të luftonin deri në fund. Jam i sigurt se Oliver do të bëhet një arbitër i madh në të ardhmen. Por në atë moment ai ishte shumë i ri për t'u përballur me atë situatë komplekse. Gjithsesi nuk kam hatërmbetje ndaj tij. nuk jam i inatosur me të. Gjithçka përfundoi aty. Nuk ishte një situatë që mund të thuhet se ishte 100 për qind penallti. Unë nuk po them se nuk ishte, por them se ishte një situatë e dyshimtë, për mendimin tim një arbitër me eksperiencë do të kishte vepruar ndryshe", përfundoi Buffon.

## DEL PIERO KUNDËR TIFOZËVE

Deklaratat e thëna nga Alessandro Del Piero pas ndeshjes mes Real Madridit dhe Juventusit kanë bërë shumë përshtypje. Ish-kapiteni i bardhezinjve, në fakt, ka kritikuar qëndrimin e Buffon. Del Piero tha se nuk ishte dakord me fjalët e ashpra të përdorura nga ish-shoku i tij i skuadrës. Këto fjalë kanë shkaktuar reagime shumë të ashpra nga tifozët bardhezinj, të cilët nuk i kanë kursyer sulmet edhe ndaj një legjende si ish-numri 10 i "Zonjës së Vjetër". Por deklaratat e Aleksx nuk duhen interpretuar si një sulm kundër portierit. Këtë e ka shpjeguar vetëm Del Piero me një mesazh në "Twitter". "Respektoj të gjitha opinionet që kam dëgjuar dhe lexuar këto ditë. Por ata që kanë nënkuptuar se unë jam kundër Gjigj-t janë të pabesë dhe keqdashës, ose të gëzuar për eliminimin e Juventusit. Më vjen keq".

Publicitet

Komisioni për mbledhjen e ofertave për realizimin e ekskursionit të nxënësve të SHMK Gjimnazi ,,Dr. Ibrahim Temo,, -Strugë publikon këtë :

**SH P A LL J E**
**Për mbledhjen e ofertave për realizimin e ekskursionit të nxënësve të viteve të treta**

në pajtim me programin e shkollës (Romë-Firence-Venecie për nxënësit me mësim në gjuhën maqedone dhe turke kurse për nxënësit me mësim në gjuhën shqipe ( Venecie-Veronë)

Kriteret minimale që duhet t'i plotësojë ofertuesi janë këto:
- Të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në RM për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse
- Të ketë realizuar me sukses së paku 3 ekskursione në botën e jashtme;
- T'i plotësojë kushtet për transport të grupeve me fëmijë në pajtim me Ligjin për sigurim në komunikacion dhe rrugë dhe me Rregulloren për kërkesa të veçanta teknike për automjetet me të cilat bëhet transporti i grupeve të fëmijëve

**Oferta duhet të përmbajë të dhëna për :**
- Çmimi për shërbim (për vendosje,transport dhe ushqim,sigurim gjatë udhëtimit dhe sigurim shëndetësor, udhëheqës-ciceron, shpenzimet për vizita në muze dhe në monumente të tjera)
- Kushtet për vendosje
- Mënyra e pagesës(mundësia e pagesës në tri këste me kartela kreditore)
- Udhëheqës, numri i arsimtarëve dhe mjek (1 arsimtar në 20 fëmijë)
- Kushte të volitshme për nxënësit të cilët vijnë nga familje me kushte të vështira sociale (në ]do 25 nxënës 1 gratis).

Kriteret për zgjedhjen e ofertës më të volitshme**-Çmimi më i ulët**

- Oferta është e ndarë
- Ekskursioni do të realizohet me aq nxënës sa do të paraqiten
- Oferta të mos përmbajë ofertë alternative,gjegjësisht e njëjta të jetë saktë e përcaktuar pa mundësi ndryshimi.
- Ofertuesi i zgjedhur duhet të dorëzojë garanci bankare për realizim me sukses të kontratës me lartësi 5 % nga vlera e kontratës.

Programet në bazë të të cilës janë përpiluar ofertat mund të merren në shkollë ]do ditë pune prej orës 09-14:00.
Ofertat duhet të jenë në zarf të mbyllur ndërsa në këndin e sipërm majta të shkruhet ,,Mos e hap,,
Ofertat me dokumentacionin e nevojshëm i dorëzohen Komisionit, në arkivin e shkollës ose me postë. }do ofertues është i obligueshëm të dorëzojë ofertë, ta marrë prej Komisionit të shkollës programin për ekskursionin shkencor-arsimor.
Ofertuesi të theksojnë në ofertë për nxënës me mësim në gjuhën shqipe maqedone ose për ë gjithë nxënësit.
Shpallja është e hapur 5 (pesë) ditë me ditën e publikimit.
Hapja e ofertave do të bëhet pa prezencën e ofertuesve.

SHMK Gjimnazi ,,Dr. Ibrahim Temo,, - Strugë
Rr. ,,Brigadat proletare,, nr. 49, Strugë

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 18 të Rregullores për mënyrën për realizimin e ekskursioneve për nxënës dhe aktiviteteve tjera të lira për nxënësit e shkollës fillore dhe Programeve për realizim të ekskursioneve, SHFK "Kiril i Metodi" f. Oraovicë komuna e Radovishit publikon

**SHPALLJE**

Me grumbullimin e ofertave për organizim të ekskursioneve për nxënës për vitin shkollor 2017/2018 edhe atë:
- Për nxënësit e klasës së **III** ekskursion njëditor në relacion **Oraovicë-Shkup-Oraovicë**
- Për nxënësit e klasës së **VI** ekskursion dyditor në relacionin **Oraovicë – Radovush – Negotinë** (TEC Negotinë) – **Kavadar** (HEC) Tikvesh) - **Prilep** (vizitë të Manastirit "Sveto Preobrazhie" në Zrze, Manastiri "Shën Nikolla", f. Manastir – Mariovë, Manastiri "Shën Arhangel Mihail" – Varosh) – **Krushevë** – (akomodim, shtëpia përkujtimore Todor Proeski, përmendorja "Makedonium", përmendorja "Meçkin Kamen", - **Manastir** (Heraklea, Parku nacional "Pelister") **Radovishi – Oraovicë**
- Për nxënësit e klasës së IX (përfundimtare), ekskursion treditor në relacionin **Oraovicë – Tetovë** (shëtitje të shkurtë në qendër dhe vizitë të Xhamisë së Larme dhe Kalasë së Tetovës, vizitë në Vrutok, vizitë të Kanjonit Radika, vizitë të manastirit Sv. Jovan Bigorski dhe Shën Gjorgi – Rajçica dhe Banjave të Kosovrastit) – vizitë dhe shëtitje në **Vevçani - Ohër** (vizitë të Sv. Naum Ohridski, shëtitje dhe vizitë të Lumit Drini i Zi, Urës së poezisë dhe muzeun natyror-shkencor, shëtitje nëpër Qytetin e vjetër-teatri antik, Pllaoshnik, Fortesën e Samoilit dhe Shën Sofijën, Kaneo) – **Manastir** (vizitë dhe shëtitje) - **Prilep** (shëtitje të shkurtë në qendër të qytetit) – **Radovish - Oraovicë**;

Ekskursionet organizohen dhe realizohen në pajtim me nenin 14 të Rregullores për mënyrën për realizim të ekskursioneve për nxënës.
Kriteret për ndarje të marrëveshjes për realizim të ekskursioneve është çmimi më i ulët.
Shkolla për ofertuesin më të volitshëm do të zgjedhë ofertuesin i cili plotëson edhe kushtet minimale në vijim:
- Të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive të RM për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike dhe me transport të licencuar personal.
- Të ketë të realizuar së paku tre ekskursione për nxënës në tre vitet e fundit.
- Të plotësojë kushtet për transport të grupeve të nxënësve, në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesa të posaçme teknike të makinave me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor.
Ofertat me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen deri tek komisioni për grumbullimin e ofertave me shenjë "mos hap".

Telefoni për kontakt
032 641 005

SHFK "Kiril i Metodi" f. Oraovicë
Komisioni për grumbullim të ofertave
Kryetar

DEONTAJ VILDER KA GATI OFERTËN

# KËRKON 40 PËR QIND TË FITIMIT PËR DUELIN NDAJ XHOSHUAS

"Nëse Xhoshua pretendon të fitojë 100 milionë dollarë nga ky duel, nuk mund të më ofrojë mua 12,5 për qind të fitimit. Unë jam gati të dueloj në vendlindjen e tij dhe përqindja ime shkon afër 40 për qind të fitimit", u shpreh boksieri amerikan




Pasi ka mësuar ofertën që i ka bërë rivali britanik Entoni Xhoshua, boksieri amerikan ka vendosur që të bëjë një kundër-ofertë, ku do të ngrejë pretendimet e tij financiare krahasuar me atë që pretendon britaniku. Xhoshua, pak ditë më parë, deklaroi se do t'i ofronte 13,5 milionë dollarë Vilder për një duel mes tyre në Londër, që do të unifikonte titujt kampionë bote në peshat e rënda. Por, amerikani e konsideron këtë shifër shumë të ulët, madje tallëse dhe ka deklaruar se do të kërkojë 40 për qind të fitimit. Xhoshua mban titujt kampionë botë në peshat e rënda në kategoritë "IBF", "WBA" dhe "WBO", ndërsa Vilder mban titullin e kategorisë "WBC". "Nëse Xhoshua pretendon të fitojë 100 milionë dollarë nga ky duel, nuk mund të më ofrojë mua 12,5 për qind të fitimit. Unë jam gati të dueloj në vendlindjen e tij dhe përqindja ime shkon afër 40 për qind të fitimit", u shpreh boksieri amerikan Deontaj Vilder, që pritet të bëjë zyrtare ofertën e tij brenda ditës së diel. "Nëse Xhoshua do që ky duel të ndodhë, atëherë le të pranojë ofertën time. Le të bisedojmë për të rënë dakord për këtë sfidë, pasi në fund do të i kemi një kampion të padiskutueshëm të peshave të rënda", deklaroi Vilder, që pret që palët së shpejti të ulen në bisedime dhe të diskutojnë për këtë përballje të madhe.



## Khan nervoz para duelit me Lo Greco

Boksieri britanik Amir Khan do të rikthehet në ring pas gati dy vitesh mungesë dhe më 21 prill do të duelojë në Liverpul ndaj kanadezit Fil Lo Greco. Një duel që Khan, ish-kampion bote, mezi e pret, por nga ana tjetër pranon se ndihet nervoz pas dy vitesh. Britaniku ndodhet aktualisht në vendlindjen e tij, në Bolton, ku po përmbyll fazën përgatitore dhe sot (e hënë) do të udhëtojë për në Liverpul. "Ka qenë fantastike dhe emocionuese të stërvitesha në shtëpi dhe ndihem mirë që do të dueloj pas 5 vitesh në Angli, para fansave të mi. Përballjet e fundit i kam zhvilluar në Amerikë, ndaj për mua ky rikthim në Britani është një motivim, për t'u rikthyer të fitorja në ring", u shpreh pwr mediat angleze Khan. "Ndihem pak nervoz para kësaj sfide edhe pse e di që jam në formë fantastike, sidomos fizikisht. Jam 31 vjeç, por ndihem shumë më mirë se sa kur isha 28. Jam në kulmin e karrierës time edhe pse e di që koha më ka lënë pak pas dy vitet e fundit. Dua të rikthehem kampion bote dhe kjo është ajo që unë synoj", deklaroi Amir Khan.

## Nadal është Messi i tenisit



Rafael Nadal është krahasuar me Lionel Messi nga trajneri i tij, ish-tenisti Karlos Moja. Spanjolli është riaftësuar nga një dëmtim në shpinë, në kohë për të mbrojtur vendin e parë në renditjen e përgjithshme ATP për meshkuj. Në ditën e rikthimit, Nadal ndihmoi Spanjën të fitonte ndaj Gjermani në çerekfinalen e Kupës Dejvis pasi mposhti numrin 4 të planetit, Aleksander Zverev. Moja mendon se avantazhi që i jep Nadal kombit të tij në tenis, është si ai që Messi i jep Barcelonës, në La Liga, ku katalanasit janë një hap larg titullit. "Si pasojë e motivimit dhe shpirtit të ekipit, prania e Rafa ndikon te e gjithë kombëtarja spanjolle e tenisit", – tha Moja. "Ata e kanë të sigurt se ai do t'i fitojë të dy ndeshjet e tij, kësisoj ata luajnë lirshëm në ndeshjet e tyre. Do ta krahasoja me atë që bën Leo Messi te Barcelona. Edhe ata luajnë lirshëm sepse e dinë se herët e vonë Messi do të vendosë fatet e ndeshje", deklaroi Moja.

## Kompania "CVC" dhe Ekleston kërkojnë të blejnë Moto GP

Nga garat me 4 rrota në ato me 2 rrota. Është kjo ideja e çmendur që kompania "CVC", në të cilën bën pjesë edhe Berni Ekleston, kërkon të bëjë në të ardhmen, duke blerë aksionet e botërorit të Moto GP. Lajmin e ka konfirmuar "Financial Times", që shprehet se kompania "CVC" kërkon të blejë kuotat e Dorna, shoqërisë spanjolle që drejtohet nga Karmelo Ezpeleta, që ka të drejtat e Moto GP, Moto 2, Moto 3 dhe Superbike. Një marrëveshje që ka kohë që ka nisur dhe që do t'i kushtojë Eklestone 1 miliardë euro. Por "CVC" nuk është e vetme në këtë marrëveshje, pasi do të mbështetet edhe nga shoqëria franceze "Eurazeo" dhe ajo belge e "Groupe Lambert". Por kjo nuk është hera e parë që "CVC" bën pjesë në garat e Moto GP, pasi edhe në të shkuarën ajo ka qenë partnere e Dorna, por në vitin 2006 shiti aksionet e saj. "CVC", kompania që ka si president Bernie Eklesonte, ishte pronare e Formula 1 deri një vit më parë, por ai i shiti kuotat te kompania "Liberty media" në kuotën e 8 miliardë eurove 18 muaj më parë. Dorna dominon kuotat e Moto GP që prej vitit 1999, por Ezpeleta mund të shesë një pjesë të kuotave dhe të qëndrojë si president i kësaj kompanie.



# GARË POLITIKE PËR DOMINIM

Imer Mushkolaj, analist i çështjeve politike, thotë për Radion Evropa e Lirë se pushtetin faktik ekzekutiv në Kosovë e ka Qeveria e saj, përkatësisht kryeministri i vendit, e që në mandatin e tanishëm është Ramush Haradinaj. Por, sipas tij, kjo nuk po ndodhë dhe aktualiteti i tanishëm shpërfaqë situatën në të cilën presidenti i vendit, Hashim Thaçi, po synon t'i marrë përgjegjësitë dhe kompetencat që i kanë institucionet tjera, kryesisht ato që i ka kryeministri. "Deri më tash unë kam parë që presidenti Thaçi vazhdimisht kërkon t'i marrë kompetencat, përgjegjësitë e kryeministrit, tash kur në krye të vendit është Haradinaj, por edhe në të kaluarën kur ishte (Isa) Mustafa, në mënyrë që ai të tregojë se është kryesori në këtë vend".

"Kjo është jashtëzakonisht e dëmshme, për shkak se bëhet fjalë për shkelje të Kushtetutës në aspektin praktik. Por, në anën tjetër, më e rëndësishme se sa kjo, bëhet fjalë për përzierje të kompetencave dhe imponim të fuqisë politike të dikujt, që në këtë rast është Thaçi, për ta përkthyer pastaj këtë në fuqi ekzekutive", tha Mushkolaj. Ngjashëm e përshkruan situatën edhe analisti tjetër, Artan Muhaxhiri. Duke folur për Radion Evropa e Lirë, ai shpreh mendimin se ndërhyrja e pushteteve në kompetencat e njëra-tjetrës, janë pasojë e rivaliteteve politike që synojnë shpërfaqjen e fuqisë së pushtetit.

"Tentimi që nga një nivel autonom i pushtetit të ndërhyhet në një nivel tjetër autonom të pushtetit, është dëshmi për nivelin jo të kënaqshëm të kulturës politike në Kosovës dhe të mentalitetit politik të liderëve tanë institucionalë. Kjo është një garë politike për dominim në pushtet edhe atëherë kur një gjë e tillë nuk bazohet në rregullat e një politike normale dhe standarde. Kjo bëhet për tu imponuar si faktor i pushtetshëm në opinion, në spektrin politik, mirëpo edhe në raportin e shtetit të Kosovës me ndërkombëtarët", u shpreh Muhaxhiri. Ndërkaq, analisti Mushkolaj thotë se shembujt praktik të ushtrimit të rivalitetit politik përmes përzierjes së kompetencave ose ndërhyrjes së njërit nivel të pushtetit në kompetencat e nivelit tjetër të pushtetit, ka pasur edhe kohët e fundit.



> Kosova është Republikë parlamentare dhe pushtetet janë të ndara sipas Kushtetutës së vendit, por përzierja e kompetencave ekzekutive dhe rivaliteti i pushteteve tashmë janë bërë dukuri në vend dhe ato po deformojnë strukturën e sistemit politik, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike në vend

"Pavarësisht që nuk është pranuar një gjë e tillë, se ka qenë iniciativë e presidentit Thaçi, ta zëmë, intervenimi i para pak ditësh në veri dhe arrestimi i zyrtarit të lartë serb, Marko Gjuriq, në njëfarë forme u bë nën skenarin dhe nën organizimin e Thaçit. Kjo nuk do të duhej të ishte kështu, për shkak se ka qenë një aksion që do të duhej të ndërmerrej nga Policia me bekimin e institucionit përkatës, respektivisht të Ministrisë së Brendshme. Por, ka pasur edhe raste të tjera, në kuptimin edhe të shfaqjes publike, kur Thaçi ka provuar t'i marrë kompetencat e kryeministrit, pavarësisht që Kushtetuta nuk ja lejon një gjë të tillë dhe nuk do të duhej të ndodhte kështu", tha Mushkolaj. Analisti Muhaxhir thotë se ndërhyrje në kompetenca të njërit nivel në nivelin tjetër të pushtetit, ka pasur edhe me rastin e arrestimit dhe dëbimit të gjashtë shtetasve turq nga Kosova për në Turqi, me 29 mars. Siç thekson ai, në vend se kreu i Qeverisë, Haradinaj të ishte i njoftuar me operacioni dhe më pas ai ta njoftonte opinionin lidhur me detajet, këtë e bëri presidenti Thaçi.

"Kjo nuk do të duhej të ndodhte, mirëpo është një shembull, ku në këtë rast presidenti ishte më i fuqishëm se sa Qeveria, në një domen dhe për një çështje, në të cilën do të duhej të ishte ashtu. Ndërhyrja nga një nivel në tjetrin ndodhë për dy arsye. Për shkak të ambicieve politike të njërës palë që të dominojë ndaj palës tjetër, por edhe për shkak se liderët e caktuar institucionalë e lejojnë këtë dhe nuk ndërmarrin masa që ndarjen e pushteteve ta bëjnë në mënyrë të prerë, ashtu siç edhe duhet të jetë", theksoi Muhaxhiri. Sipas njohësve të zhvillimeve politike, ndërhyrja e njërit nivel të pushtetit në kompetencat e nivelit tjetër, ndikon negativisht jo vetëm në çështjet aktuale politike në vend, por krijon precedent që edhe në të ardhmen të ketë ndërhyrje dhe përzierje të kompetencave, të cilat e dëmtojnë rëndë sistemin politik të vendit.

*(REL)*

# Si e ruajti fuqinë Gjukanoviqi?

Millo Gjukanoviq, i cili ka udhëhequr Malin e Zi me dekada, qoftë nga zyra e presidentit, qoftë nga ajo e kryeministrit, ka qenë mjeshtër i ndryshimit. Ai e ka transformuar veten nga një komunist në një liberal, nga një aleat i presidentit të dikurshëm serb, Sllobodan Milloshevíq, në njeriun që ka udhëhequr vendin e tij drejt ndarjes nga Serbia dhe anëtarësimit në NATO. Si një nga dy evropianët që kanë dominuar politikat e vendeve të tyre më gjatë se Vladimir Putini i Rusisë, Gjukanoviqi ka qenë kryeministër i Malit të Zi gjashtë herë dhe president një herë. Ai ka mbajtur pushtetin me ndërprerje të shkurtra qysh në vitin 1991. Tani, duke përdorur recetën e tij të populizmit dhe patronazhit, ai pritet t'i fitojë zgjedhjet presidenciale më 15 prill.

"Gjukanoviq ka qenë më shumë i aftë dhe më pak ideologjik se shumica e politikanëve të tjerë në rajon, çfarë i ka lejuar të riformësojë agjendën e tij dhe politikat sipas ndikimit mbizotërues", thotë Florian Bieber, ekspert për Ballkanin në Universitetin e Gracit. Gjukanoviqi është bërë fytyra e një brezi të ri si pjesë e një grupi të komunistëve të rinj, që ka tërhequr vëmendjen e malazezëve të lodhur nga një gjeneratë e vjetër e politikanëve, që kanë dalë pas vdekjes së liderit jugosllav, Josip Broz Tito, më 1980. Ai është bërë kryeministri më i ri në Evropë më 1991, kur ka qenë vetëm 29 vjeç. Atë vit, ai ka mbështetur aksionin e ushtrisë jugosllave kundër Kroacisë, duke u lejuar forcave malazeze të marrin pjesë në rrethimin dhe bombardimin e Dubrovnikut dhe në shkatërrime të tjera në ish-republikën jugosllave. Më vonë, përkatësisht më 1998, kur e ka parë se kah çojnë politikat e Milloshevíqit, Gjukanoviqi u është kthyer reformave pro-evropiane, edhe pse vendi i tij ka mbetur në një shtet me Serbinë. Largimi nga aleatët lindorë i Malit të Zi ka kulmuar vitin e kaluar, kur ky vend është bërë anëtar i NATO-s, me gjithë protestat e opozitës dhe të Rusisë. Zyrtarët malazezë thonë se në prag të pranimit në NATO, nacionalistët serbë dhe rusë kanë bërë komplot për të pushtuar Parlamentin në Podgoricë gjatë zgjedhjeve parlamentare të 2016-s, për të vrarë kryeministrin e atëhershëm, Gjukanoviq, dhe për të instaluar një lidership pro-rus.



> Si një nga dy evropianët që kanë dominuar politikat e vendeve të tyre më gjatë se Vladimir Putini i Rusisë, Gjukanoviqi ka qenë kryeministër i Malit të Zi gjashtë herë dhe president një herë. Ai ka mbajtur pushtetin me ndërprerje të shkurtra qysh në vitin 1991. Tani, duke përdorur recetën e tij të populizmit dhe patronazhit, ai pritet t'i fitojë zgjedhjet presidenciale më 15 prill

"Gjukanoviqi e ka kuptuar rëndësinë e legjitimitetit të jashtëm, e të qenët bashkëbisedues i besueshëm i partnerëve të huaj, sidomos Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara. Duke ndjekur një politikë të marrëdhënieve të mira me fqinjët, ai ka marrë vlerësime nga jashtë dhe është parë si burimi i stabilitetit", thotë analisti Bieber për Radion Evropa e Lirë. Derisa Kremlini i ka mohuar pretendimet se "organet shtetërore ruse" kanë qenë të përfshira në komplotin e dyshuar, 14 të dyshuar në këtë rast janë aktualisht në gjyq në Podgoricë. Vëmendja e Gjukanoviqit nuk është fokusuar vetëm jashtë vendit. Ai ka bërë politika të shkathëta edhe brenda Malit të Zi, duke ndarë opozitën reformiste dhe nacionaliste serbe. "Gjukanoviq, thjesht, ka qenë në gjendje ta shesë veten më mirë se opozita, e cila kërkon lidhje më të mira me Rusinë, është kundër NATO-s, është euro-skeptike", thotë Vera Stojarova, profesoreshë në departamentin e shkencave politike në Universitetin Masaryk të Çekisë.

Edhe pse mbetet i popullarizuar, Gjukanoviqi ka edhe armiq që thonë se ai nuk ka pasur kurrë ideologji të qëndrueshme. Gjukanoviqi, po ashtu, është përballur me akuza të përsëritura për parregullsi, siç janë frikësimi i votuesve dhe blerja e votave.

## Një sulm i ekzekutuar në mënyrë të përsosur

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), Donald Trump, në mesazhin e tij në lidhje me operacionin e forcave të armatosura amerikane së bashku me Britaninë e Madhe dhe Francën kundrejt regjimit të Bashar al-Asadit në Siri, tha se "Sulm i kryer në mënyrë të përsosur. Misioni u përmbush". "Një sulm i ekzekutuar në mënyrë të përsosur. Falënderoj Francën dhe Britaninë e Madhe për diturinë e tyre dhe fuqinë e mirë të ushtrive të tyre. Nuk mund të kishte pasur një rezultat më të mirë. Misioni u përmbush", tha Trump në mesazhin e tij nëpërmjet Twitter-it. Në kuadër të sulmit të SHBA-ve, Britanisë së Madhe dhe Francës ndaj regjimit të Sirisë, ishte goditur një qendër hulumtimi për armë kimike, një depo të armëve kimike në perëndim të Homsit si dhe një qendër komandimi në lidhje me armët kimike.



## Së paku 20 të varë në bazën iraniane në Alepo

Së paku 20 persona kanë humbur jetën gjatë një shpërthimi në Alepo, në veri të Sirisë, lajmëron Si-En-En. Shpërthimi ka ndodhur të dielën në bazën iraniane në pjesën jugore të Alepos. Në zonën e shpërthimit janë regjistruar edhe aeroplanë. Nuk ka raporte për shkakun e shpërthimit.

## Gjendja e jashtëzakonshme në Egjipt vazhdohet edhe për tre muaj



Presidenti i Egjiptit, Abdel Fattah el-Sissi, ka vazhduar gjendjen e jashtëzakonshme të vendit edhe për tre muaj të tjerë. Kjo është hera e katërt që vazhdohet gjendja e jashtëzakonshme në këtë vend. "Duke marrë parasysh situatën serioze të sigurisë në vend, gjendja e jashtëzakonshme është vazhduar edhe për tre muaj dhe hyn në fuqi në ora një pas mesnate", thuhet në vendimin e presidentit të Egjiptit.
Gjendja e jashtëzakonshme në vend zgjat tashmë 9 muaj dhe ajo u shpall pas sulmeve me bombë të kryera në prill në Aleksandri dhe Tanta në të cilat jetën humbën 45 persona dhe 125 u plagosën. Përgjegjësinë për sulmet i mori organizata terroriste DEASH. Ky vendim u votua gjithashtu edhe nga parlamenti i Egjiptit.

# SI ERDHI NË PUSHTET ASSADI?



"Më dhemb kur qesh! Por kur mendoj që Assadi ka frikë nga një laps, atëherë nuk mundem të ndalem duke qeshur!", shkruhej në karikaturën e Farzatit, e cila bëri bujë nëpër botë. TIMES, e emëroi Farzatin si një nga 100 njerëzit më me ndikim në botë. Farzat, është karikaturist anti-qeveritar, që synim i ka kryesisht figurat e qeverisë, veçanërisht atë të Assadit

Presidenti i Sirisë Bashar al-Assad, lindi në Damask, është biri i ish-presidentit Hafez al-Assad. Bashar al-Assad, mori gjithë trashëgiminë e babait të tij. Babai i tij vdiq në vitin 2000, e deri atëherë, ai e kishte përgatitur të birin për marrjen e pushtetit. Me të marrë pushtetin, Bashar al-Assadi edhe ndryshoi Kushtetutën e Sirisë, transmeton Koha.net. Kërkesa minimale e moshës për president ishte 40 vjeç, ndërsa ai e uli në 34, që ishte atëkohë mosha e Assadit.

Bashar al-Assad mori presidencën më 10 korrik të vitit 2000 me mbështetje të 99.7 për qind të mbështetësve të tij. Ai, gjithashtu u emërua komandant i Forcave të Armatosura siriane. Protestat masive në Siri filluan më 26 janar të vitit 2011. Protestuesit qysh atëherë kërkonin rivendosjen e të drejtave civile. Por, protestat u kthyen në dhuna masive nga qeveria siriane kundrejt qytetarëve të pafajshëm.

Atë kohë, SHBA-ja vendosi sanksione të kufizuara kundër qeverisë së Assadit. Edhe BE-ja, ra dakord të mbahej një takim në Bruksel po për këtë çështje kundrejt Assadit.

Sekretarja e SHBA-së, atë kohë, Hillary Clinton, tha se Assadit i kishte humbur legjitimiteti si President. Presidenti i atëhershëm Barack Obama, i kishte kërkua me një deklaratë me shkrim Assadit të hiqte dorë nga sulmet. Por, kjo nuk e ndali asnjëherë Assadin.

**ALI FARZAT, KRITIKU SIRIAN I QEVERISË SË ASSADIT**

Një kritik i madh i qeverisë së Assadit ishte karikaturisti Ali Farzat. Mediat e Assadit, paralajmëronin se Farzat do ta pësonte nëse nuk ndalej. Pak ditë më vonë, Farzati u sulmua derisa iu thyen dy duart dhe mori trauma të forta në kokë. Ai u shtrua në spital pothuajse pranë vdekjes. Por, me të marrë vetën, ai menjëherë e kishte punuar një karikaturë, i shtrirë në spital.

"Më dhemb kur qesh! Por kur mendoj që Assadi ka frikë nga një laps, atëherë nuk mundem të ndalem duke qeshur!", shkruhej në karikaturën e Farzatit, e cila bëri bujë nëpër botë. TIMES, e emëroi Farzatin si një nga 100 njerëzit më me ndikim në botë. Farzat, është karikaturist anti-qeveritar, që synim i ka kryesisht figurat e qeverisë, veçanërisht atë të Assadit.

Gjatë Luftës Civile, deri më 10 janar të vitit 2012, Qeveria siriane kishte vrarë mbi 5 mijë civilë dhe protestues, ndërsa 1100 njerëz të pafajshëm ishin vrarë nga forcat e armatosura terroriste. Karikaturat e Farzatit tregojnë figurën dominonte të



**Mediat e Assadit, paralajmëronin se Farzat do ta pësonte nëse nuk ndalej. Pak ditë më vonë, Farzati u sulmua derisa iu thyen dy duart dhe mori trauma të forta në kokë. Ai u shtrua në spital pothuajse pranë vdekjes. Por, me të marrë vetën, ai menjëherë e kishte punuar një karikaturë, i shtrirë në spital**

Assadit, muskulore dhe diktatoriale. Karikaturat e tij tregojnë burokracinë, korrupsionin dhe hipokrizinë brenda qeverisë dhe elitës së pasur. Karikaturat, zakonisht janë pa titra. Me këto karikatura, ai fitoi respektin e qytetarëve në Siri e nëpër botë. Në vitin 2015, ishte presidenti rus Vladimir Putin, që po ashtu nisi t'i ofronte ndihmë Assadit. Raportohej se po i ofronte trajnime ushtarëve dhe po i furnizonte me armë.

Në dhjetor të 2016-ës, forcat e Assadit kishin rimarrë gjysmën e Aleppos. Por, ai paralajmëronte se ishin në prag të rikthimit të Luftës Civile.

**SHBA-JA, BRITANIA E MADHE DHE FRANCA SULMOJNË SIRINË**

Por, pas kritikave të shumta që Assadi mori edhe nga fuqitë perëndimore, më 14 prill 2018, SHBA-ja në bashkëpunim me Britaninë e Madhe dhe Francën sulmuan disa caqe të regjimit sirian. Kanada, Gjermania, Turqia, NATO e disa shtete perëndimore përshëndetën këtë sulm. Përderisa, Rusia ishte kundërshtarja më e madhe. Pas sulmit, ambasadori rus, Anatoly Antonov, kishte paralajmëruar pasoja për SHBA-në. Kundërshtare ishte edhe Kina.

Sipas zyrtarëve të Pentagonit u goditën tri objektiva, një laborator kërkimor në Damask, i lidhur me prodhimin e armëve kimike dhe biologjike, një magazinë ku mbaheshin armë kimike në qytetin Holms dhe një magazinë tjetër ku mbaheshin pajisje për prodhim armësh dhe shërbente si qendër e rëndësishme komande, gjithashtu në afërsi të Holmsit. Pas kësaj, u mblodh edhe Këshilli i Sigurimit të OKB-së dhe NATO, për të diskutuar rreth sulmit mbi Siri.

Këshilli i Sigurimit të OKB-së ka dështuar të miratojë një rezolutë të hartuar nga Rusia të shtunën që do të dënonte "agresionin kundër Republikës Arabe të Sirisë nga SHBA-ja dhe aleatët e saj në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar dhe Kartën e OKB-së". Vetëm Rusia, Kina dhe Bolivia votuan pro këtij drafti. Tetë vende votuan kundër draftit ndërsa pesë abstenuan. Rezoluta, për t'u miratuar, duhet t'i ketë nëntë vota pro dhe asnjë veto nga Rusia, Kina, Franca, Britania apo SHBA-ja.

Ish boksieri, që spikaste për sadizmin e torturave. Një zezak gjigand me instikt vrasësi dhe natyrë gaztori. 100 kilogramë dhe dy metra gjatësi, që shkaktonin terror por që në të njëjtën kohë kishin dicka qesharake e ngathtësie. "Një vrasës dhe një klloun", shkruante e përjavshmja amerikane Time në 1977 kur vendoste fytyrën e tij në kopertinë, me titullin "I egri i Afrikës". Është portreti i Idi Amin Dada, tiran i marrë dhe i përgjakur që në periudhën 1971-1979 udhëhoqi shtetin afrikano qendror të Ugandës, duke merituar nofka të tmerrshme si "kasap" dhe "diktatori kanibal"

# DIKTATORI KANIBAL



I lindur mes 1924 dhe 1928 (burimet janë të ndryshëm dhe ai kishte qejf të thoshte: "Vetëm Zoti e di moshën time"). Idi Amin ishte ndoshta me origjinë nga zona e Kobokos, në veriperëndim të vendit", shpjegon hsitoriani Domenico Vecchioni, biograf i diktatorit.

"Dihet që i ati kishte përqafuar islamizmin, që e ëma ishte një shëruese dhe që ai e frekuentoi shumë pak, ose aspak shkollën, duke mbetur gjysmë analfabet. Më vonë, pas një adoleshence të shënjuar nga braktisja e babait dhe varfëria, arriti të hyjë në ushtrinë koloniale britanike (Uganda ishte që nga viti 1894 një protektorat anglez). Nën armë, Amin mori llagapin "Dada", për shkak të faktit që gjendej shpesh herë në krahë të vajzave që zakonisht i quante dada, një term i përkthyeshëm si "motra e madhe".

Ndërsa për asonancë, anglezët nisën ta quajnë Big Daddy, "Babai i madh". I dërguar në Kenia (nën kontrollin anglez) në vitin 1947, Dada shkëlqeu shumë shpejt për mizorinë me të cilën iu kundërvu për llogari të Madhërisë së Saj lëvizjeve guerilase antikoloniale. Kështu, në vitin 1954, u thirr në Ugandë me detyrën që të ndalte bastisjet e disa grupeve tribalë që merreshin me grabitje bagëtish.

"Ushtaraku i ri ideoi atëherë një teknikë brutale të marrjes në pyetje", thotë Vecchioni. "I mblidhte hajdutët e dyshuar duke ua vendosur atyre penisin mbi një gur, dhe atyre që refuzonin të jepnin informacione ua priste me një hanxhar". Një brutalitet i tillë gjeti shfryrje edhe në drejtime të tjerë: në periudhën mes viteve 1951 dhe 1960 forca kafshërore e Amin i dha atij titullin kombëtar të kampionit të peshave të rënda në boks. Triumfet në ring dhe ata ushtarakë shkaktuan një simpati të madhe për të mes britanikëve dhe, kur në vitin 1962 Ugandës iu dha pavarësia duke e bërë atë republikë presidenciale, emri i tij u sponsorizua tek kryeministri i saposhpallur Milton Obote, i cili e çmoi për meritat e diskutueshme duke e ngritur në zëvendëskomandant.

**GRUSHT I DYFISHTË**

Alergjik ndaj demokracisë, në vitin 1966 ai organizoi një grusht shteti duke dëbuar presidentin e republikës Mutesa II (i cili u strehua në Angli) dhe në goditjen e fundit e ngjiti Amin në postin e komandantit suprem të ushtrisë, duke i dhënë detyrën që të eliminonte të gjithë armiqtë e mundshëm të regjimit të sapolindur. Gjë që Dada e kreu duke i rezervuar paralelisht vetes zhvillimin e një biznesi personal përmes trafiqeve me rebelët e Zairesë fqinjë: armë në këmbim të fildishit dhe



floririt. Ky biznes i solli pasuri të madhe, që e shfaqte duke bredhur me xhepat e mbushur me kartëmonedha. Në fund, në 25 janar 1971, ai organizoi vetë një grusht ushtarak shteti duke marrë vetë të gjithë pushtetet dhe duke detyruar Oboten (i shndërruar në filokomunist) që të shkonte në Tanzani. Kjo gjë, që u përshëndet nga shumë udhëheqës perëndimorë në frymën antisovjetike, u prit me entuziasëm edhe nga populli ugandez. Amin u premtoi të gjithëve reforma dhe liri, që megjithatë askush nuk i pa ndonjëherë.

**HOTEL HORRORI**

I bindur që Uganda vazhdonte të gëlonte nga njerëzit e Obotes, Dada iu përkushtua me entuziasëm organizimit të një shërbimi të skuadroneve të vdekjes që ishin të ngarkuar të likuidonin çdo të dyshuar. "Pa asnjë logjikë investiguese arrestoheshin turma ugandezësh (civilë dhe ushtarakë), shumë prej të cilëve përfunduan në Nile Mansion Hotel, një hotel elegant kolonial në Kampala - kryeqyteti i vendit - i përshtatur në një qendër torturash dhe asgjësimi", rrëfen Vecchioni.

Ishte vetë Amin që personalisht ideoi një prej procedurave më sadiste që u zbatuan brenda mureve të Nile Mansion. Ja se si funksiononte procedura: ai i shkreti që kishte radhën dërgohej në një lloj thertoreje të nëndheshme ndërkohë që njëkohësisht i premtohej liria një viktime të dytë, nëse do të pranonte që të godiste dhe të vriste me një levë hekuri fatkeqin që ishte futur para tij. "Shumë pak patën kurajën për t'u tërhequr para një misioni të tillë, duke preferuar të vdisnin. Por edhe kush pranonte vdiste nga ana e tij prej dorës së të burgosurve të tjerë".

**DELIR**

Ndoshta i dehur prej dhunës, në gusht të vitit 1972 Amin shpalli nëpërmjet radios: "Allahu mu shfaq në ëndërr dhe më urdhëroi që të dëbojmë nga toka jonë të gjithë aziatikët". Në Ugandë ndodheshin 50 mijë, nënshtetas me origjinë indiane dhe pakistaneze. Të gjithë i urdhëroi që të largoheshin nga vendi, duke komentuar: "Shumë prej tyre e lyejnë fytyrën me bitum për t'u dukur si afrikanë, por i siguroj që më kot e kanë, nuk shërben për asgjë".

Kjo masë shkaktoi një rënie të shpejtë të të gjithë ekonomisë, duke qenë se aziatikët kishin në pronësi apo menaxhonin shumë sipërmarrje prodhuese (mallrat e të cilave pas sekuestrimit përfunduan direkt në xhepat e Amin). Spastrimi vazhdoi me shfarosjen e Acholi (popullsi me origjinë nga Sudani) si dhe minorancave të tjera që konsideroheshin pro Obote. "Armiqtë e mi? I bëj copë dhe pastaj trupin e tyre ua hedh krokodilëve", i deklaronte shtypit ish boksieri kur fliste për ta. Edhe me fraza të tilla ai ushqeu zëra të çdo lloji për shpirtin e tij brutal. Duke përfshirë edhe hipotezën që ai ishte një praktikues i kanibalizmit. "Në fakt ekzistonin në Ugandë praktika të lashta rituale që konsistonin në ngrënien e pjesëve të trupave të armiqve të mposhtur në betejë", përgjigjet Vecchioni. "Nuk do të ishte habi nëse një tip si Amin do të praktikonte gjëra të këtij lloji". E sigurt është që pas largimit të tij në pallatin presidencial u gjetën dhoma frigoriferike të mbushura me gjymtyrë njerëzish, bebe sysh, buzë, hundë dhe testikuj.





"Marrëzitë e Amin, sipas disa studiuesve, ishin frut i një neurosifilizi, një sëmundje që konsumon trurin dhe që Dada e kish marrë nga një prej të dashurave të tij", komenton eksperti. "Edhe pse kjo nuk i zbut aspak përgjegjësitë e tij". Ishte mësuar të vishte gjithmonë një uniformë ushtarake të mbushur me medalje dhe dekorata të shpikura nga ai vetë. Dhe marrëzia e tij e çoi të vetëshpërblehet me tituj groteskë si "Zot i të gjithë bishave të tokës dhe peshqve të detit dhe pushtues i Perandorisë Britanike", apo "Mbret i Skocisë" (një cilësim që u bë më pas i famshëm prej filmit Mbreti i fundit i Skocisë, prodhim i vitit 2006 me regjisor Kevin Macdonald).

**FANS I HITLERIT**

I paaftë për të krijuar një qeveri të denjë për këtë emër, Amin mbajti marrëdhënie farsë edhe me vendet e huaj. Pasi prishi marrëdhëniet me Izraelin për shkak se i thurte elozhe Adolf Hitlerit, gjatë viteve shtatëdhjetë intensifikoi marrëdhëniet me udhëheqësin libian Muammar Gheddafi dhe me BRSS, duke marrë në këmbim furnizime armësh lufte dhe duke përkeqësuar edhe marrëdhëniet me Britaninë e Madhe dhe SHBA. Kundrejt britanikëve ushqente në realitet një marrëdhënie dashuri-urrejtje: një ditë ofroi në mënyrë provokuese tre tonë perime "për të shpëtuar nga uria fëmijët anglezë").

Edhe më të çuditshme (por shumë më të rrezikshme) ishin iniciativat e tij në skakierën afrikane. Shpiku idenë që disa territore të Kenias dhe të Sudanit një herë e një kohë i kishin përkitur Ugandës së tij, duke kanosur me pushtime. Më pas u deklarua i gatshëm që të sulmonte Afrikën e Jugut raciste. Në vitin 1976 u lëshua me një retorikë të ashpër në debatin izraelito-palestinez: kur në qershor të atij viti disa terroristë palestinezë rrëmbyen një avion të Air France me dhjetëra izraelitë në bord, Amin i ftoi rrëmbyesit që të uleshin në aeroportin e Entebbe, pranë Kampalas. Kjo krizë u zgjidh në natën e 3 korrikut me një blic të forcave speciale izraelite, suksesi i të cilave diskreditoi një herë e përgjithmonë emrin e Dadas. I cili nuk lëvizi megjithatë nga pozicionet e tij megallomanë duke lënë me testament marrëzinë e radhës.

"Në vitin 1978, për tu çliruar nga njolla e Entebbes, Amin provoi të rizgjojë ndjenjat nacionaliste duke sajuar një luftë kundër Tanzanisë. Në programet e tij ajo do të zgjaste vetëm "25 minuta": por përfundoi në një katastrofë", rrëfen Vecchioni. "Ushtria armike u hodh në kundërsulm dhe në 11 prill të vitit 1979 detyroi Dadan që të arratisej nga Kampala".

**FUNDI I NJË MAKTHI**

Ish boksieri dhe ish diktatori u vendos në Libi, më pas në Irak, ku u prit prej "vëllezërve myslimanë" Ghedaffi dhe Saddam Hussein. Në fund u mikëprit në Arabinë Saudite. Në këtë mërgim të artë ish "i pamposhturi" (një tjetër emër që vetë ia vuri vetvetes) ndërroi jetë në 20 korrik 2003 për shkak të një sëmundjeje në veshka, pasi i ishte refuzuar kthimi në Ugandë.

Kështu do të përfundonte parabola ultra e përgjakshme e një gjigandi kllounesk, i cili nga një palacollëk në tjetrin, u ngjye me gjakun e afro 300 mijë personave. Shumë prej të cilëve njerëz që një herë e një kohë kishin parë pikërisht tek vrasësi i tyre, njeriun që do të ndryshonte një herë e mirë fatin e tyre si njerëz të shtypur prej shekujsh.

# SEKRETI i Izraelit dhe bomba atomike në Luftën e Gjashtë ditëve















Plani parashikonte që bomba të hidhej në majë të një mali në Sinai, 12 milje larg nga baza ushtarake e Abu Ageila, në një pikë kyçe, ku, më 5 qershor 1967, Ariel Sharon urdhëroi trupat izraelite në një betejë kundër egjiptianëve. "Si mund të ndalet një armik? Duke e trembur", i tha Yaakov Cohenit. Ai shtoi: "Ishim vërtetë shumë pranë"

Izraeli mendonte të përdorte bombën atomike gjatë Luftës së Gjashtë Ditëve, në qershor të vitit 1967. Do ta kishte hedhur në gadishullin e Sinait, si një paralajmërim kundër Egjiptit dhe forcave arabe, armike të shtetit hebre. Zbulimi vjen tani, pesëdhjetë vjet pas këtyre ngjarjeve, në një artikull të botuar në Nju Jork Tajms. Por kjo nuk është hera e parë që hidhet një argument i tillë. Plani u zbulua për gazetën amerikane nga studiuesi Avner Cohen, i cili ka kryer kërkime të gjera mbi këtë temë, duke intervistuar ushtarakë në pension. Si për shembull Itzhak Yaakov, i cili vdiq në vitin 2013 në moshën 87 vjeç, dhe që, mes viteve 1999 dhe 2000, la dëshminë e tij të regjistruar në kasetë, bashkë me detajet për operacionin sekret, me emrin e koduar "Sansone", emri i heroit biblik me forcë shumë të madhe.

Plani parashikonte që bomba të hidhej në majë të një mali në Sinai, 12 milje larg nga baza ushtarake e Abu Ageila, në një pikë kyçe, ku, më 5 qershor 1967, Ariel Sharon urdhëroi trupat izraelite në një betejë kundër egjiptianëve. "Si mund të ndalet një armik? Duke e trembur", i tha Yaakov Cohenit. Ai shtoi: "Ishim vërtetë shumë pranë".

Nëse "opsioni Samson", që, sipas Yaakov, quhej kështu në zhargonin ushtarak, do të ishte përdorur, ai do të kishte sjellë shpërthimin e parë bërthamor të përdorur për qëllime ushtarake, pas sulmeve amerikane në Hiroshima dhe Nagasaki, njëzet e dy vjet më herët. Por plani nuk u vu asnjëherë në zbatim, sepse fitorja e shpejtë e Izraelit dhe shkatërrimi i të gjithë forcave ajrore të Egjiptit të Nasserit, e bënë të padobishme këtë gjë. "Është sekreti i fundit i luftës së vitit 1967", tha Cohen për Nju Jork Tajms.

Izraeli nuk e ka konfirmuar dhe as e ka mohuar të ketë patur armë bërthamore. Një zëdhënës i ambasadës izraelite në Uashington tha se qeveria izraelite nuk do të komentojë mbi rolin e Yaakovit. Fakti është se, në vitin 2001, Yaakov u arrestua me akuzën e zbulimit të informacioneve, për një gazetar izraelit me qëllim që të dëmtonte sigurinë e shtetit. Ai u shfajësua nga akuza kryesore, por për pjesën tjetër të jetës vazhdoi me miqtë e tij, si dhe oficerë ushtarakë në pension, për të mbështetur tezën e tij. Studiuesi Cohen pretendon të ketë nxjerrë më në fund në dritë të vërtetën...

МАКЕДОНСКИ ШУМИ
во партнерство со природата
www.mkdsumi.com.mk
Ул. "Перо Наков" Бр.128; 1000 Скопје; Р. Македонија
Тел. ++389 (0)2 2581080 Факс. ++389 (0)2 2581824

Në bazë të nenit 37 – i të Ligjit për ndërmarrje publike (Gazeta Zyrtare e RM nr. 38/96, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14 и 138/14, 25/2015, 61/2015 dhe 39/2016) dhe nenit 20-g të Ligjit të të punësuarve në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/2014, 199/2014 dhe 27/2016), NP "Pyjet e Maqedonisë" – Shkup, publikon

**SHPALLJE PUBLKE nr. 02/2018**
**Për themelim të marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar**

**Për vendet e punës në vijim:**

1. Referent për pyje private – me shkallë VIB të mbaruar ose së paku 180 kredi sipas SETK Fakulteti i pylltarisë, me tre vjet përvojë pune dhe neto pagesë fillestare në shumë prej 24.480,oo denarë.
   - Filiali SHS "Ravna Reka" – Pehçevë – 1 (një) realizues;

2. Referent i pavarur për shfrytëzim, mbrojtje dhe mirëmbajtje të pyjeve - me shkallë VIB të mbaruar ose së paku 180 kredi sipas SETK Fakulteti i pylltarisë, me tre vjet përvojë pune dhe neto pagesë fillestare në shumë prej 25.530,oo denarë;
   - Filiali SHS "Osogovë" – Kriva Pallankë– 4 (katër) realizues;
   - Filiali SHS "Kratovë" – Kratovë – 1 ( një) realizues;
   - Filiali SHS "Pllaçkovicë" – Radovish - 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Bellasicë" – Strumicë – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Kajmakçallan" – Manastir – 4 (katër) realizues;
   - Filiali SHS "Prespadrvo" – Resnjë – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Galiçicë" – Ohër – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Jabllanicë" – Strugë – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Kumanovë – Kumanovë – 3 (tre) realizues;
   - Filiali SHS "Gollak" – Dellçevë – 1 (një) realizues;

3. Referent për shfrytëzim të pyjeve dhe furnizim - me shkallë VIB të mbaruar ose së paku 180 kredi sipas SETK Fakulteti i pylltarisë, me tre vjet përvojë pune dhe neto pagesë fillestare në shumë prej 24.480,oo denarë;
   - Filiali SHS "Malishevë" – Berovë – 3 (tre) realizues;
   - Filiali SHS "Ravna Reka" – Pehçevë – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Osogovë" - Koçan – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Pllaçkovicë" – Vinicë – 3 (tre) realizues;
   - Filiali SHS "Sallanxhak" – Vallandovë – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Kozhuf" – Gjevgjeli – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Demir Kapi" – Demir Kapi – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Bor" – Kavadar – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Crn Bor" – Prilep - 3 (tre) realizues;
   - Filiali SHS "Babuna" – Veles – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Biglla" – Demir Hisar– 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Prespadrvo" – Resnjë – 3 (tre) realizues;
   - Filiali SHS "Llopushnik" – Kërçovë - 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Sandanski" – Mak. Brod – 5 (pesë) realizues;
   - Filiali SHS "Sharr" – Gostivar – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Leshnica" – Tetovë – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Karaxhica" – Shkup – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Gollak" – Dellçevë – 2 (dy) realizues;

4. Referent i pavarur për prodhim fidanishte, prodhim të farës dhe përpunim të prodhmeve tjera të pyjeve - me shkallë VIB të mbaruar ose së paku 180 kredi sipas SETK Fakulteti i pylltarisë, me tre vjet përvojë pune dhe neto pagesë fillestare në shumë prej 24.480,oo denarë;
   - Filiali SHS "Shumarstvo" – Sv.Nikole – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Gollak" – Dellçevë – 1 (një) realizues;

5. Shef për mbrojtjen e pyjeve dhe ekologjisë - me shkallë VIB të mbaruar ose së paku 180 kredi sipas SETK Fakulteti i pylltarisë, me tre vjet përvojë pune dhe neto pagesë fillestare në shumë prej 25.530,oo denarë;
   - Filiali SHS "Shumarstvo" – Sv.Nikole – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Lipa" – Krushevë – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Jabllanicë" – Strugë – 1 (një) realizues;

6. Referent për prerje dhe furnizim – së paku të arritur nivelin e IV të kualifikimeve, arsim të mesëm katërvjeçar – Teknik i pylltarisë, me dy vjet përvojë pune dhe neto pagesë fillestare në shumë prej 20.540,oo denarë;
   - Filiali SHS "Malishevë" – Berovë – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Pllaçkovicë" – Vinicë – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Bor" – Kavadar – 5 (pesë) realizues;
   - Filiali SHS "Kajmakçallan" – Manastir – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Biglla" – Demir Hisar– 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Galiçicë" – Ohër – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Stogovë" – Dibër - 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Llopushnik" – Kërçovë - 3 (tre) realizues;

7. Kontrollor të rampës – së paku të arritur nivelin IV të kualifikimeve, arsim të mesëm katërvjeçar, me dy vjet përvojë pune dhe neto pagesë fillestare në shumë prej 16.220,oo denarë;
   - Filiali SHS "Ravna Reka" – Pehçevë – 1 (një) realizues;

8. Referent për transport – së paku të arritur nivelin IV të kualifikimeve, arsim të mesëm katërvjeçar, me dy vjet përvojë pune – Teknik i pylltarisë dhe neto pagesë fillestare në shumë prej 19.100,oo denarë;
   - Filiali SHS "Malishevë" – Berovë – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Равна Рака" – Pehçevë – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Kratovë" – Kratovë – 1 ( një) realizues;
   - Filiali SHS "Pllaçkovicë" – Radovish - 1 ( një) realizues;
   - Filiali SHS "Pllaçkovicë" – Vinicë – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Sallanxhak" – Vallandovë – 3 (tre) realizues;
   - Filiali SHS "Demir Kapi" – Demir Kapi – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Babuna" – Veles – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Kajmakçallan" – Manastir – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Biglla" – Demir Hisar– 3 (tre) realizues;
   - Filiali SHS "Lipa" – Krushevë – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Galiçicë" – Ohër – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Gollak" – Dellçevë – 1 (një) realizues;

9. Rojtar i pyjeve – licencë – së paku të arritur nivelin IV të kualifikimeve, arsim të mesëm katërvjeçar, me dy vjet përvojë pune – Teknik i pylltarisë drejtimi Pylltari dhe neto pagesë fillestare në shumë prej 17.660,oo denarë;
   - Filiali SHS "Malishevë" – Berovë – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Serta" – Shtip - 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Pllaçkovicë" – Radovish - 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Kozhuf" – Gjevgjeli – 3 (tre) realizues;
   - Filiali SHS "Crn Bor" – Prilep - 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Kajmakçallan" – Manastir – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Lipa" – Krushevë – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Galiçicë" – Ohër – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Stogovë" – Dibër - 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Sharr" – Gostivar – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Leshnica" – Tetovë – 1 (një) realizues;

10. Punëtor i pyjeve (rregullues, ngarkues) – së paku të arritur nivelin IV të kualifikimeve, arsim të mesëm katërvjeçar, me ose pa përvojë pune dhe neto pagesë fillestare në shumë prej 14.880,oo denarë;
   - Filiali SHS "Osogovë" – Kriva Pallankë– 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Kratovë" – Kratovë – 1 ( një) realizues;
   - Filiali SHS "Pllaçkovicë" – Radovish - 1 ( një) realizues;
   - Filiali SHS "Pllaçkovicë" – Vinicë – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Bellasicë" – Strumicë – 3 (tre) realizues;
   - Filiali SHS "Crn Bor" – Prilep - 3 (tre) realizues;
   - Filiali SHS "Babuna" – Veles – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Shumarstvo" – Sv.Nikole – 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Kajmakçallan" – Manastir – 3 (tre) realizues;
   - Filiali SHS "Biglla" – Demir Hisar– 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Galiçicë" – Ohër – 3 (tre) realizues;
   - Filiali SHS "Jabllanicë" – Strugë – 3 (tre) realizues;
   - Filiali SHS "Stogovë" – Dibër - 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Llopushnik" – Kërçovë - 3 (tre) realizues;
   - Filiali SHS "Gollak" – Dellçevë – 2 (dy) realizues;
   -

11. Furnizues me mekanizëm – së paku të arritur nivelin IV të kualifikimeve, arsim të mesëm katërvjeçar, me dy vjet përvojë pune dhe neto pagesë fillestare në shumë prej 17.660,oo denarë;
   - Filiali SHS "Ravna Reka" – Pehçevë – 1 (një) realizues;

12. Drejtues të makinës ndërtimore - së paku të arritur nivelin IV të kualifikimeve, arsim të mesëm katërvjeçar, me dy vjet përvojë pune dhe neto pagesë fillestare në shumë prej 19.100,oo denarë;
   - Filiali SHS "Malishevë" – Berovë – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Ravna Reka" – Pehçevë – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Osogovë" - Koçan – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Pllaçkovicë" – Radovish - 2 (dy) realizues;
   - Filiali SHS "Pllaçkovicë" – Vinicë – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Bellasicë" – Strumicë – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Demir Kapi" – Demir Kapi – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Bor" – Kavadar – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS „Crn Bor" – Prilep - 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Shumarstvo" – Sv.Nikole – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Stogovë" – Dibër - 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Karaxhica" – Shkup – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Gollak" – Dellçevë – 1 (një) realizues;

13. Mirëmbajtës të rrugës – së paku të arritur nivelin IV të kualifikimeve, arsim të mesëm katërvjeçar, me ose pa përvojë pune dhe neto pagesë fillestare në shumë prej 14.400,oo denarë;
   - Filiali SHS "Serta" – Shtip - 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Bellasicë" – Strumicë – 1 (një) realizues;
   - Filiali SHS "Lipa" – Krushevë – 2 (dy) realizues;

Orari javor i punës për këto vende të punës është 40 orë, të shpërndarë në 5 (pesë) ditë të punës prej ditës së hënë deri ditën e premte, prej ora 07 - 15.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrojnë edhe dokumentet në vijim:
- Certifikatë të shtetësisë
- Dëshmi për arsim të mbaruar
- Dëshmi për përvojë të punës
- Certifikatë për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin përkatës të punës
- Vërtetim se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk do të shitohet dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të parashtrohen deri në NP "Pyjet e Maqedonisë" – Shkup në rr. "Pero Nakov" nr. 128 – 1000 Shkup.

Shpallja zgjatë 15 ditë duke konsideruar nga dita e publikimit, gjegjësisht më së voni deri më 30.04.2018, ndërsa zgjedhja do të realizohet në pajtim me afatet e përcaktuara me ligj.
Dokumentacioni i pakompletuar dhe dokumentacioni i parashtruar pas kalimit të afatit për aplikim nuk do të shqyrtohet.

**NP "Pyjet e Maqedonisë" – Shkup**

Сектор за правни, заеднички, општи работи и човечки ресурси
Тел. ++389 (0)2 2581080 лок.126

Këshilli për ndarje të çmimit shtetëror 'Nëna Terezë' publikon:

## KONKURS
**për ndarje të shpërblimit shtetëror “Nëna Terezë' në vitin 2018.**

Me shpërblimin shtetëror "Nëna Terezë" jepet mirënjohje për të arriturat në fushën e humanizmit dhe solidaritetit njerëzor dhe për nxitje, përparim të mirëkuptimit të ndërsjellë dhe zhvillim të bashkëpunimit si përmes popujve, ashtu edhe përmes pjesëtarëve të bashkësive, kulturave dhe religjioneve të ndryshme.

Shpërblimi shtetëror u ndahet individëve, grup krijuesish, ekipeve, institucioneve, shoqatave dhe shoqërive tregtare të qytetarëve nga vendi.

Shpërblimi shtetëror sipas kushteve të përcaktuara në konkurs mund t'u ndahet edhe shtetasve të huaj, grup krijuesish, ekipe dhe institucione nga jashtë

Individit të shpërblyer i ndahet: diplomë dhe shumë të hollash.

Secilit anëtar të grupit ose ekipit të shpërblyer të krijuesve u ndahen diploma dhe pjesë të barabarta të shumës së parave.

Institucionit, shoqatës tregtare ose shoqërisë të qytetarëve të shpërblyera u ndahen diplomë dhe pllaketë.

Shuma e të hollave të shpërblimit shtetëror 'Nëna Terezë' arrin *pesë (5) rroga mujore mesatare* në Republikën e Maqedonisë të paguara tre muajt e fundit të vitit aktual.

Shpërblimi shtetëror 'Nëna Terezë' sipas rregullit, ndahet çdo vit.

Në një vit mund të ndahen më së shumti deri në *dy shpërblime*.

Iniciativë për ndarjen e shpërblimit shtetëror 'Nëna Terezë' mund të parashtrojnë: institucionet, shoqatat tregtare, shoqëritë qytetare dhe qytetarët.

Parashtruesit e iniciativës për ndarjen e shpërblimit shtetëror duhet në detaje të arsyetojnë iniciativën. Në tekst duhet të jenë të përmbajtura edhe: *të dhëna të sakta biografike, adresë të saktë banimi (adresa-rruga, numri, vendi, qyteti, shteti), të dhëna për rezultatet e arritura në fushën në të cilën është arritur e realizuara dhe të dhëna të tjera të cilat llogariten se do të kontribuojnë në vlerësim*, *si dhe dokumentacion përkatës me të cilën do të vërtetohen të njëjtat.*

*Parashtruesi i iniciativës duhet të vendosë emrin dhe mbiemrin e plotë, titullin, firmën, adresën dhe numrin e telefonit.*

Teksti i iniciativës (i kompletuar) të dorëzohet në 15 kopje, ndërsa punimet (librat, publikimet etj) trajtohen si shtojca dhe duhet të dorëzohen në një (1) kopje.

Iniciativat duhet të dorëzohen në adresën në vijim:

Ministria e kulturës e Republikës së Maqedonisë – Këshilli për ndarje të shpërblimit shtetëror “Nëna Terezë”, rr. 'Gjuro Gjakoviq' nr. 61 – Shkup, Republika e Maqedonisë.

***Konkursi zgjatë prej 16 prill deri më 16 maj 2018.***

Iniciativat e pakompletuara dhe iniciativat dhe propozimet (punimet, librat, publikimet etj) të dorëzuara pas afatit të përcaktuar për pranim në konkurs nuk do të merren parasysh.

**Këshilli për ndarje të shpërblimit shtetëror**
**“Nëna Terezë”**

---

***IPSH QENDRA PËR SHËNDET PUBLIK – SHKUP***

**rr. III Makedonska Brigada nr. 18 Shkup, tel. 02/3298 667, faks 02/3298 251**www.cph..mk

Në bazë të nenit 156, nenit 157 paragrafi 1 alineja 1, nenit 158 dhe nenit 159 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/2012, 145/2012, 87/2013, 164/2013, 39/2014, 43/2014, 132/2014, 188/2014, 10/2015, 61/2015, 154/2015, 192/2015, 17/2016 dhe 37/2016), pëlqimit nr. 18-2785/2 të Ministrisë së financave të Republikës së Maqedonisë, nenit 37 paragrafi 1 alineja 7 të Statutit të IPSH Qendra për shëndet publik – Shkup, Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës, si dhe Vendimit për punësim të punëtorit për kohë të pacaktuar të punës nr. 04-501/5 të datës 03.04.2018, IPSH Qendra për shëndet publik – Shkup publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**
**Për punësim të punëtorëve për kohë të pacaktuar**

IPSH Qendra për shëndet publik – Shkup publikon shpallje për punësim të punëtorëve shëndetësor për kohë të pacaktuar për vendet e punës në vijim:

1. Doktor të medicinës - 9 (nëntë) realizues;
2. Doktor të medicinës, specialistë të epidemiologjisë - 1 (një) realizues.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
- Të mos i shqiptohet ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

Kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Të kenë të mbaruar shkallën e VII/1 të arsimit, Fakulteti i mjekësisë;
- Të posedojnë licencë për punë;
- Për vendin e punës me numër rendor 2: të kenë të mbaruar specializim të epidemiologjisë;
- Periudhë më të gjatë të punës vullnetare në institucionin publik shëndetësor, si dhe përvojë në punë në institucion shëndetësor që kryen veprime nga sfera e shëndetit publik do të merren si përparësi;

Dokumentet e nevojshme, të cilat kandidatët duhet t'i parashtrojnë, duhet të jenë në pajtim me kushtet të cilat kërkohen për vendet e theksuara të punës, edhe atë:
- Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt (emri dhe mbiemri, adresa e banimit ose qëndrimit, telefoni dhe e-mail adresa);
- Biografi e shkurtë (CV);
- Certifikatë të shtetësisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;
- Certifikatë të mjekut, jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;
- Certifikatë (diplomë) për arsim të mbaruar në pajtim me nevojat që kërkohen për vendin e lartpërmendur të punës, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;
- Licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;
- Vërtetim për punë të bërë vullnetare ose vërtetim për përvojë pune në institucion shëndetësor që kryen veprimtari nga sfera e shëndetit publik (si opsion).

Orari i punës është 40 orë në javë, orar 8 orësh të punës në ditë, prej ora 07:30 deri në ora 15:30.

Neto pagesa fillestare për vendin e punës me numër rendor 1 – doktor i medicinës është 32.158,00 denarë

Neto pagesa fillestare për vendin e punës me numër rendor 2 - doktor i medicinës – specialist i epidemiologjisë është 39.490,00 denarë.

Afati për paraqitje është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter), parashtrohen në IPSH Qendra për shëndet publik – Shkup, rr. III Makedonska Brigada nr. 18 Shkup.

Gjatë realizimit të procedurës për punësim dhe zgjedhjes së kandidatit d të respektohet plani aktual për përfaqësim të drejtë dhe përkatës të pjesëtarëve të komuniteteve.

Zgjedhja e kandidatit do të realizohet në pajtim me nenin 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/2012, 145/2012, 87/2013, 164/2013, 39/2014, 43/2014, 132/2014, 188/2014, 10/2015, 61/2015, 154/2015, 192/2015, 17/2016 dhe 37/2016).

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacion të pakompletuar, si dhe ato të cilat do të parashtrohen jo në kohë, nuk do të jenë lëndë shqyrtimi.

**IPSH QENDRA PËR**
**SHËNDET PUBLIK – SHKUP**

---

Republika e Maqedonisë
**Komuna e Sopishtes**

Tel. ++389 2 27 85 100
Faks. ++389 2 27 85 109
Rr. 2, nr. 2, f. Sopishte, 1054
Shkup, Republika e Maqedonisë
www.opstinasopiste.gov.mk
gradonacalnik@opstinasopiste.gov.mk

Nr. i procedurës: **14711**
nr. **28-20/18** e datës **13.04.2018**

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës publike dhe prezantimit publik në lidhje me **Dokumentacionin lokal planor urbanistik me qëllim B5 – kompleks hotelerik për formim të parcelës ndërtimore të PK 2274 dhe PK 2275 KK Sopishte ndr, Komuna e Sopishtes.**
Realizohet prezantim publik dhe anketë publike për **Dokumentacionin lokal planor urbanistik me qëllim B5 – kompleks hotelerik për formim të parcelës ndërtimore të PK 2274 dhe PK 2275 KK Sopishte ndr, Komuna e Sopishtes.**
Përfshirja planore e dokumentit **Dokumentacioni lokal planor urbanistik me qëllim B5 – kompleks hotelerik për formim të parcelës ndërtimore të PK 2274 dhe PK 2275 KK Sopishte ndr, Komuna e Sopishtes** është me sipërfaqe prej **18 565 m2.**

1. Prezantimi publik dhe anketa publike do të realizohet me prezantimin e planit në lokalet e Komunës Sopishte më datë **20.04.2018** në ora **11.00.**
2. Anketa publike do të zgjasë deri më **27.04.2018**, në bazë të nenit 46 paragrafi 9 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16).
3. Informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni përkatës të përfshirë në plan në afatin e lartpërmendur të parashtrojnë vërejtje, propozime dhe mendime në listat anketuese në administratën komunale.
4. Informacione në tel. 2 785 102

Kryetari i Komunës së Sopishtes
**Stefçe Trpkovski**

---

Në bazë nenit 17,19 dhe 22 të rregullores për realizimin e ekskursioneve të nxënësve dhe aktiviteteve tjera në shkolla fillore nr. 07-9992/2 nga data 05.06.2014,Shkolla fillore komunale ,,Naim Frashëri, Kumanovë **shpall**

***SHPALLJE PUBLIKE***
***Për grumbullimin e ofertave për realizimin e ekskursioneve dhe aktivitete të lira të nxënësve për vitin shkollor 2017/2018***

1. Ekskursion njëditor (piknik në natyrë) për të gjithë nxënësit prej klasës I - IX .
2. Ekskursion dyditor për nxënësit e klasave IX në relacionin: Kumanovë-Shkup-Tetovë-Strugë-Ohër dhe anasjelltas,
3. Mësim në natyrë për nxënësit e klasave të pesta
4. Ekskursion dyditor për nxënësit e klasave të gjashta.

*- Kriteret për zgjedhjen e ofertuesit më të mirë janë këto:*
*- Të jetë i regjistruar në pajtim me normat pozitive të Republikës së Maqedonisë për kryerjen e veprimtarisë përkatëse nga turizmi;*
*- Të ketë realizuar me sukses së paku tri ekskursione të nxënësve dhe aktivitete tjera të lira në tri vitet e fundit,*
*-Ti plotësoj kushtet për transportim të fëmijëve në grupe në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacionin rrugor dhe Rregulloren për kërkesa të veçanta të automjetit me të cilin barten fëmijët në grupe ;*
*Oferta duhet të përmbaj-parasheh këto kushte:*
*® Çmimin për person dhe të përgjithshëm të shërbimeve( transporti,ushqimi dhe vendosja)*
*® Mënyra e pagesës;*
*® Numrin e arsimtarëve, udhëheqësve dhe mjekun*
*® Sigurimin e nxënësve*
*® Benificionet për nxënësit që janë nga familjet me gjendje të rëndë sociale*
*Shpallja mbetet e hapur 5 ( pesë ) ditë pune nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.*
*Kriteri për zgjedhjen e ofertës më të volitshme është çmimi më i ulët i shërbimeve të ofruara.*
*Oferta e ofertuesit e cila nuk I plotëson kushtet minimale për shërbimet e ofruara dhe e cila nuk është e kompletuar sipas dokumentacionit të tenderit do të hidhet poshtë nga Komisioni për furnizime publike si e pa pranueshme.*
*Dokumentacionin tenderues ofertuesit mund ta marrin çdo ditë pune nga ora 8-16.00.*
*Oferta e kompletuar mund të dërgohen drejtpërdrejt ose në adresën e shkollës:Sh F K ,, Naim Frashëri,, Kumanovë, rr. Vuk Karaxhiq p.n. Kumanovë,në kuvertë të mbyllur me vërejtje ,,MOS E HAP,,-për,,Komisionin për grumbullimin e ofertave për realizimin e ekskursionit,,.*
*Dokumentacioni e ofertës duhet të jetë në origjinal ose kopje e vërtetuar nga ofertuesi!*
*Kontakt: 031/427-423 ose 439-423 e-mail: naimfrasheri_ku@hotmail.com*

*SHF K ,,Naim Frashëri,,Kumanovë*

---

**I nr. 1958/2016**

**SHPALLJE PUBLIKE**

Sipas nenit 46-b të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për përmbarim Gazeta Zyrtare e RM nr. 8 të datës 17.01.2008 ndërsa në lidhje me nenin 265 të LP Gazeta Zyrtare e RM nr. 72/2016 të datës 12.04.2016

Përmbaruesi Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në bazë të kërkesës për realizim të përmbarimit nga kreditori Hallk Bank SHA Shkup nga Shkupi me seli në rr. “Sv. Kiril i Metodi” nr. 54, bazuar në dokumentin për përmbarim Aktit noterial ODU nr. 121/2015 të datës 20.02.2015 të Noterit Përparim Rexhepi, Gostivar, kundër borxhliut Ardijan Ramadani nga Gostivari me seli në f. Bellovishtë dhe debitorit të pengut Qemal Ramadani nga Gostivari me seli në f. Bellovishtë, për realizim të përmbarimit në vlerë prej 1.216.747,00 denarë për lëndën përmbaruese të regjistruar nën I nr. 1958/2016 të datës 05.04.2018:

**FTON**

1. Borxhliun Ardijan Ramadani dhe debitorin e pengut Qemal Ramadani të dy nga Gostivari me seli në f. Bellovishte, për shkak të dorëzimit të:
- Procesverbalit për shitje të patundshmërisë me ankand publik me gojë në batë të nenit 175 paragrafi 4 të LP I nr. 1958/2016 të datës 14.03.2018,
- Konkluzionit për shitje të patundshmërisë me ankand publik me gojë në batë të nenit 175 paragrafi 4 të LP I nr. 1958/2016 të datës 14.03.2018,
- Konkluzionit për shitjen e realizuar të patundshmërisë në bazë të nenit 175 paragrafi 7 të LP I nr. 1958/2016 të datës 15.03.2018
- Konkluzion për dorëzim të patundshmërisë në pronësi në bazë të nenit 178 paragrafi 1 të LP I nr. 1958/2016 të datës 15.03.2018
- Konkluzion për përcaktim të kohës për ndarje në bazë të nenit 192 paragrafi 1 të LP I nr. 1958/2016 të datës 19.03.2018
- Procesverbal për ndarje të shumës të arritur me shitjen e patundshmërisë në bazë të nenit 192 të LP I nr. 1958/2016 të datës 26.03.2018
- Konkluzion për përcaktim të kohës për ndarje në bazë të nenit 192 paragrafi 1 të LP I nr. 1958/2016 të datës 26.03.2018 të gjitha të Përmbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari.

Në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në shtypin ditor.
PARALAJMËROHEN borxhliu **Ardijan Ramadani**, **debitori i pengut Qemal Ramadani** se mënyra e këtillë e dorëzimit konsiderohet si e rregullt dhe se pasojat negative që mund të dalin do t'i bartë vetë pala.
**Kjo shpallje paraqet SHPALLJEN E PESTË**.

**Përmbarues**
**Aleksandar Kuzmanovski**

---

**URGJENTISHT**

**Shes truall të urbanizuar Po+Pr+2 menjëherë në fillim të Industrisë së lehtë “Momin Potok” – Shkup, me sipërfaqe të përgjithshme prej 890 m2 së bashku me objektet ekzistuese prej 180 m2. Çmimi 178.000 euro. Numri i telefonit: 078 – 201 – 960**

---

Në bazë të nenit 22 dhe 23 prej Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare nr. 52/2012) dhe Pëlqimit për punësim nr. 12-10957/8 të datës 25.01.2018 nga MASH dhe Vendimit për publikm të shpalljes publike nr. 04-217/1 të datës 20.03.2018 SHFK."Dimitar Miladinov" Qendër, Shkup, shpall:

**SHPALLJE**
**Për vendet e lira të punës për kohë të pacaktuar**

1. Punëtor për mirëmbajtje të higjienës me orar të plotë të punës për kohë të pacaktuar – 2 (dy realizues);

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet në vijim:
- të kenë të mbaruar arsimin fillor
- të jenë shtetas të RM
- të jenë të moshës së rritur

Orari i punës së punëtorëve për mirëmbajtje të higjienës është 40 orë në javë, me dy ndërrime gjatë orarit ditor të punës edhe atë ndërrimi i parë prej ora 6,30 deri ora 14,00 dhe ndërrimi i dytë prej ora 12,30 deri në ora 19.00.
Shuma në të holla e neto pagesës – 12.000,00 denarë.
Kandidatët duhet të parashtrojnë:
-Fletëparaqitje/Lutje
-Dëshmi për arsim të mbaruar
-Certifikatë të shtetësisë
Dokumentet duhet të jenë në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

Afati për aplikim është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes.
Zgjedhja e kandidatëve në lidhje me shpalljen e publikuar do të realizohet në afat prej 45 (dyzetepesë) ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.
Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme dorëzohen në SHFK "Dimitar Miladinov", bul. Koço Racin nr. 17 Komuna e Qendrës, Shkup
Dokumentet jo të kompletuara nuk do të merren parasysh

**SHFK "Dimitar Miladinov" Qendër Shkup**

# TIRANA, E RE, E LIRË DHE E EGËR

**Me fasadat e pikturuara sipas motiveve gjeometrike tipike ballkanike, një mbulesë moderne prej xhami dhe çeliku, hapësira të gjera për kalimtarët, kafene që janë të hapura gjithë ditën, stenda të mbushura plot produkte të freskëta**



Gjithnjë e më shumë Shqipëria dhe veçanërisht transformimi që po pëson Tirana, po zë hapësira në revistat më të njohura të botës. Revista prestigjioze italiane, "Vanity Fair", i ka kushtuar një artikull ndryshimit të kryeqytetit të shqiptarëve ku evidenton pikat turistike. "Tirana nuk po ndalon për një çast. Kjo është ndjenja për të gjithë ju që keni ecur nëpër rrugët kaotike të kryeqytetit shqiptar. Kantiere ndërtimi, vinça, skela, arkitektë në punë, të gjithë të angazhuar për të rizhvilluar një qytet dhe që sot mban kreun e kryeqytetet në "modë" për Europën. Për të kapur atmosferën e Tiranës, ku arkitektët më të rëndësishëm nga e gjithë Evropa po investojnë idetë dhe projektet, shkojmë në sheshin Skënderbej, dedikuar heroin shqiptar që çliroi Shqipërinë pas 400 vite pushtim nga Perandoria Osmane", shkruan revista prestigjioze.

"Sheshi i ri, inauguruar në qershor 2017, ka qenë objekt i një plani rizhvillimi realizuar nga 51N4E belge, që e ktheu këtë zonë në pedonale me pllaka, mermer, gur nga të gjitha territoret shqiptare brenda apo jashtë kufijve kombëtarë (si Kosova). Gazetarja Francesca Masotti fton turistët që të mos e humbin mundësinë për të vizituar këtë qytet interesant, ndërsa evidenton sheshin "Skënderbej", transformimin e "Pazarit të Ri" dhe "Bunk'art".



**PUSHIMET NË DET NË SHQIPËRI**

Është një tjetër, por projekti që po zhvillohet tani: me distancë prej gati 80 vitesh nga plani i parë rregullues i kryeqytetit (në 1939, pas pushtimit italian të Shqipërisë, arkitektit Gherardo Bosio ka projektuar qendrën aktuale Tiranës), fati i arkitekturës së qytetit i është besuar sërish një italiani. Faza e fundit për zhvillimit urbanistik është në fakt, Tirana 2030-TR030 nga studioja e arkitektit Stefano Boerit, promovuar nga qeveria qendrore në bashkëpunim me administratën lokale. Qëllimi i projektit është që të rigjallërojë hapësirën publike, të zhvillojë një sistem të pyllit orbital rreth e qark metropolit (duke përfshirë edhe parqet natyrore dhe duke ruajtur biodiversitetin egzistues), të krijojë korridore të reja ekologjikë përgjatë lumenjve, të ngrejë qytete të vogla dhe të shfrytëzojnë hapësira të lira të tokës. Një projekt ambicioz por i realizueshëm sepse këtu më shumë se diku tjetër, ndjehet dëshira për ripërtëritje.

**ARTI BRENDA NË BUNKER**

Qendra e Tiranës po zhvillohet e gjitha përreth Sheshit Skënderbej. Një katërkëndësh i mbushur me kopshte, kisha, xhami dhe muze, si Muzeu Historik Kombëtar, brenda të cilit tregohet historia e Shqipërisë nga paleolitiku deri tek komunizmi, "Bunk'Artz" që i dedikohet viktimave të regjimit komunist që është ndërtuar në dhomat e një bunkeri të vjetër (përllogaritet se në të gjithë Shqipërinë ndodhen më shumë se 700 000 bunkerë, të ndërtuar nga diktatori Enver Hoxha që i druhej një sulmi të jashtëm, që nuk ndodhi asnjëherë) apo Shtëpia e Gjetheve, në dhomat e të cilave janë ekspozuar arkivat e Sigurimit, policia sekrete shqiptare që operonte në vitet e diktaturës. Ia vlen të largohesh nga qendrën por për të vajtur në "Bunk'Art" (origjinali), bunkeri gjigant kundëratomik i Hoxhës që ndodhet buzë malit të Dajtit, sapo del nga Tirana. Brenda ilustrohet në mënyrë të detajuar historia moderne e vendit, që nga pushtimi italian deri në vitet e komunizmit, me një vëmendje të veçantë në jetën e përditshme të shqiptarëve gjatë viteve të regjimit.



**KUZHINA E RE SHQIPTARE**

Restorante bashkëkohore të arreduara me pjesë arkitekturore, lokale në pararojë dhe të vëmendshëm ndaj inovacionit dhe cilësisë së produkteve. Ky është "Mullixhiu" ku kuzhinieri Bledar Kola, një prej pionerëve të "slow food" shqiptar, që mban mbi supe eksperienca prestigjioze ndërkombëtare (mbi të gjitha tek "Noma" në Kopenhagen), rikrijon me mjeshtëri gatime tipike të traditës popullore duke përdorur ekskluzivisht përbërësit që vijnë nga "Mrizi i Zanave", një restorant-fermë-agroturistike që ndodhet vetëm një orë me makinë nga kryeqyteti. E gjithë kjo në një pozicion të shkëlqyer, përballë liqenit artificial të Tiranës.

Në zemër të qytetit, dy hapa larg Ambasadës Italiane, ndodhet "Padam", që është një pikë referimi për klientelën ndërkombëtare. Këtu, në ambientet e një vile elegante italiane të viteve '30, kuzhinieri Fundim Gjepali, që është edhe në krye të restorantit "Antico Arco di Roma", realizon gatime "nouvelle cuisine" (kuzhina e re) që nuk ka të krahasuar dhe propozon një menu të pasur me verëra të zgjedhura me kujdes. Të gjitha këto mund të përmblidhen me kërkimin e origjinalitetit, dëshirën për të eksperimentuar dhe qëllimin për të transformuar Tiranën në një laborator të madh kulinarie.

**AROMË TRADICIONALE**

Në mars të vitit të kaluar u inaugurua Pazari i Ri, falë një vepre rikonstruktimi që ka transformuar një zonë të tërë të harruar dhe të braktisur të kryeqytetit, në një prej adresave më të pëlqyera nga turistët dhe nga vetë banorët. Kështu, edhe Tirana është pajisur me një treg europian, që të kujton të famshmen "Boqueria" në Barcelonë.

Me fasadat e pikturuara sipas motiveve gjeometrike tipike ballkanike, një mbulesë moderne prej xhami dhe çeliku, hapësira të gjera për kalimtarët, kafene që janë të hapura gjithë ditën, stenda të mbushura plot produkte të freskëta. Pazari i ri është vendi ideal për t'u çlodhur dhe të bësh blerje interesante (me patjetër duhen blerë djathërat e zonës, si gjiza, që përdoret për të gatuar byrekun, një gatim tipik i përhapur në të gjithë zonën e Ballkanit që realizohet me petë, erëza dhe pak artizanat). Pasi bën pak "shopping" të shëndetshëm, ia vlen të ndalosh për një ngrënie të shpejtë tek Oda, i vetmi restorant në Tiranë ku mund të shijohet kuzhina tipike tradicionale

**TIRANA NUK FLE KURRË**

Për këdo që është në kërkimi të argëtimit, Blloku është vendi: lagja e dikurshme e ndaluar, e cila është e disponueshme vetëm për komunistët, është sot zona më cool në Tiranë, e cila frekuentohet nga të rinjtë shqiptarë në çdo kohë të ditës (dhe natën). Vende të shumta, si Radio Bar, Nouvelle Vague, Colonial Cocktails Academy, ku mund të ndaloni të shijoni një kafe me aromë të fortë ose një koktej të bërë me fruta të freskëta. Sidoqoftë, e gjithë zona meriton një vizitë, në sajë të aktivitetit të gjallë kulturor që e dallon. Në të vërtetë, ka shumë qendra të artit bashkëkohor dhe artit të rrugës. Për të shijuar rakinë aromatike të rrushit tipike të Ballkanit, është e domosdoshme të arrihet te "Komiteti", një kafene-muze me furnizime të epokës komuniste që ofron mbi njëzet variacione të likerit lokal. Kafeneja është e fshehur prapa Piramidës së Tiranës, e ndërtuar në nder të Hoxhës nga vajza dhe dhëndri i saj, pak pas vdekjes së tij. Thuhet se ekziston një projekt për ta kthyer atë në një qendër kulturore, por për momentin ky skelet betoni është atje, i palëvizshëm, në mes të qytetit. Ndërsa gjithçka rreth Tiranës lëviz dhe nuk ndalet për një moment.

## DASHI — 21. mars - 20. prill

Dite përgjithësisht e qete kjo e sotmja për te dashuruarit. Duhet thënë se do i jepni me shume rëndësi komunikimit dhe do i zgjidhni disa zënka te vogla qe keni pasur. Beqaret nuk do kenë fat dhe do iu rendoje shume vetmia. Financat duhet menaxhuar me shume kujdes dhe maturi. Merkuri do iu gjendet pranë ne çdo moment dhe nuk do iu lere te shpenzoni pa u menduar.

## DEMI — 21. prill - 21. maj

Sektori i dashurisë ne çift do shkoje me se miri gjate kësaj dite. Përgatitni një darke romantike me qirinj dhe muzikën tuaj te preferuar nëse doni qe t'iu duket vetja si ne ëndërr. Marrëdhënia e beqareve me personat e seksit tjetër nuk do jete e mire. Edhe sot do qëndroni vetëm. Ne planin financiar do kryeni investime dhe situata do jete e qëndrueshme.

## BINJAKET — 22. maj - 21. qershor

Dita e sotme nuk do jete e favorshme për jetën sentimentale te çifteve. Ka rrezik qe disa edhe ta tradhtojnë atë qe kane ne krah dhe me pas t'i japin fund lidhjes qe kane krijuar. Kujdes, mos u ndikoni nga emocionet e momentit. Beqaret edhe pse do kërkojnë shume nuk do e gjejnë personin qe iu përshtatet me shume. Financat nuk do jene te këqija. Përfitoni!

## GAFORRJA — 22. qershor - 22. korrik

Neptuni do ndikoje me se shumti sot ne jetën tuaj ne çift dhe do kaloni një dite mjaft delikate. Mos kërkoni te impononi mendimin tuaj për gjithçka sepse do përballeni me probleme te mëdha. Nëse jeni ende vetëm, edhe sot do e keni te vështira ta gjeni atë qe kërkoni. Ne planin financiar do bëni çmos ta mbroni sa me shume buxhetin. Do ia dilni mbanë.

## LUANI — 23. korrik - 22. gusht

Jo vetëm qe dita e sotme do jete shume e bukur për te dashuruarit, por edhe pasioni do jete i zjarrte. Pas një periudhe te qete, do riperjetoni emocione pa mbarim. Beqaret do kalojnë një dite te zakonshme dhe nuk serish nuk do e gjejnë personin e ëndrrave. Nëse iu dalin probleme ne planin financiar nuk duhet te alarmoheni, por duhet te zgjidhni gjithçka me kujdes.

## VIRGJERESHA — 23. gusht - 23. shtator

Diskutoni hapur me partnerin tuaj sot për te gjitha problemet qe keni pasur ne çift. Me qetësi dhe maturi do zgjidhni gjithçka dhe do jeni me optimiste për te ardhmen. Beqaret do kenë disa takime, por fale tyre mund te linin vetëm dashuria kalimtare. Planetët do jene ne anën tuaj ne planin financiar dhe do iu ndihmojnë ta stabilizoni situatën. Shfrytëzojeni këtë mundësi!

## PESHORJA — 24. shtator - 23. tetor

Kur behet fjale për ta mbrojtur dashurinë tuaj dhe atë qe keni ne krah, ju jeni mjaft luftarake dhe nuk toleroni aspak. Sot do e tregoni këtë gjë. Beqaret do ndikohen mjaft nga Hëna dhe nuk do kenë aspak dëshirë për te bere njohje te reja. Ne planin financiar ka rrezik te përballeni me probleme serioze. Merrni masa sa me shpejt dhe mos i besoni askujt.

## AKREPI — 24. tetor - 22. nëntor

Ata qe kane pasur zënka me partnerin kohet e fundit do pajtohen gjate kësaj dite dhe ne mbrëmje do kalojnë momente me te bukura. Yjet do jene gjate gjithë kohës ne anën tuaj. Beqaret nuk duhet t'iu besojnë te gjitha atyre qe do i ngacmojnë sot sepse do lëndohen. Ne pune nuk ka ardhur ende koha te merrni vendime te rëndësishme apo te nënshkruani kontrata.

## SHIGJETARI — 23. nëntor - 21. dhjetor

Te shumte do jene yjet qe do krijojnë turbullira ne jetën ne çift gjate kësaj dite. Lidhjes suaj do i mungoje qëndrueshmëria dhe do keni probleme te mëdha. Beqaret do kenë pak mundësi te takojnë personat e duhur, megjithatë nuk duhet ta humbin shpresën deri ne minutën e fundit. Ne planin financiar ka ardhur koha te ndiqni një strategji strikte.

## BRICJAPI — 22. dhjetor - 20. janar

Fale influencës shume te madhe te Plutonit, jeta ne çift as për ju nuk do jete e qete. Do keni ide te ndryshme me partnerin dhe disa mund te shkojnë deri atje sa ta tradhtojnë atë qe kane ne krah. Kujdes! Beqaret duhet ti marrin gjerat si t'iu vijnë, pa kërkuar asgjë me ngulm. Ka mundësi qe buxheti juaj tre filloje te përmirësohet qe sot. Përfitoni për te hequr disa lek mënjanë.

## UJORI — 21. janar - 19. shkurt

Sektori i dashurisë do vazhdoje te jete i mbrojtur nga yjet gjate kësaj dite. Do flisni hapur për gjithçka me partnerin dhe nuk do keni asnjë kontradikte. Për beqaret do ketë takime premtuese te cilat nuk duhen humbur ne asnjë mënyrë. Ne planin financiar do keni disa tronditje te vogla, por probleme te mëdha nuk do ketë. Shpenzimet duhet t'i pakësoni.

## PESHQIT — 20. shkurt - 20. mars

Nëse kohet e fundit jeni përballur me një situate te vështirë ne çift, sot do i shikoni gjerat më me qartësi. Situata do filloje te stabilizohet pak nga pak. Beqaret do flirtojnë pa pushim, por do kenë mundësi vetëm për aventura kalimtare. Shfrytëzojini nëse iu pëlqejnë ose prisni ende për një lidhje serioze.

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| AKTORI ANGLEZ NË FOTO | PJESË E MOLEKULËS | BARAZIM (NË SHAH) | FILM I AKORIT NË FOTO / SERIAL AMERIKAN | C | REVOLUCIONARI KILIAN, GEVARA | JEPMA, DORËZOMA | ËMBËLSIRË ITALIANE | LITRI | MBLEDHËS TATIMESH | ZANORE QË NDODHET NË FILLIM TË FJALËS A TË RROKJES |
| Ç | | | | | | | | | | |
| E VËRTETA SHKENCORE QË DUHET VËRTETUAR | | | | | | | | NIKELI / ME ERË TË MIRË | | |
| QYTET NË RUSI / QË NUK I KA MBUSHUR 18 VJET | | | | | SHTOJCË / REOMIRI | | | | | |
| I | | | | | | TOKAT E PUNUARA | | | | |
|  | | | | | | DËFTORJA E PËREMRIT "KJO" | | | | |
| | | | | | | AKTORI EGJIPTAS, SHARIF | | | | |
| | | | | | | AUTORI KROAT, UJEVIQ | | | | FILM I AKORIT NË FOTO |
| | | | | | | VEPRIMTARI ARTISTIKE (SH. PASHQ.) | | | | |
| | | | | | | KOHA | Ë / ANIJA E PARË KOZMIKE QË SHKOI NË HËNË | | TH / LLOJ BUREKU (SHQ.) | |
| | | | | | | AUSTRIA | | AKTORJA AMERIKANE, UEST / XHUXHI I MITOL. SKANDINAVE | | |
| | | | | | | VJERSHËTOR / FILM I AKORIT NË FOTO, "... MODERNE" | | | | |
| Mensur Mamuti | FUTBOLLISTI HOLANDEZ, ROBEN / LUNDËR E MADHE DHE E GJATË | A | ATENTATORI I ESAD PASHË OPTANIT | BËRA MATJE | BREZ LLASTIKU PËR GRA / PA NUMËR | | | | | |
| FILM I AKORIT NË FOTO | | | | | | | | | | |
| NOVELË E VALTER SKOTIT | | | | | | | | IRIDIUMI / ASTATI | | |
| LLOJ CIGARESH AMERIKANE | | | | | ZANORJA E TRETË / KALIUMI | | VEPËR / FLUORI | | | |
| KOMPJUTERI I PARË | | | | | | LLOJ PEME | | | | |



**ZGJIDHJET:** Ç, ÇARLI ÇAPLIN, TEOREMA, NI, OMSK, ANEKS, I MITUR, ARAT, KËSO, OMAR, TIN, ARTE, Ë, TH, A, ME, POET, A, KORSE, TRAMPOLINA, AJVANHO, IR, KENT, Ë, AKT, ENIAK, FTUA.

# Sudoku

### shumë i lehtë

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 4 | | | 7 | | |
| | 5 | | 2 | 9 | | | 8 | 6 |
| | | | | | 1 | | | 2 |
| | | 8 | | 4 | | | 2 | 3 |
| | 6 | | | | | | 4 | |
| 4 | 2 | | | 8 | | 1 | | |
| 2 | | | 3 | | | | | |
| | 8 | | | 5 | 2 | | 1 | |
| | 3 | 4 | | | 9 | | | |

### mesatar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 6 | 5 | | 2 | | | |
| | 7 | | | | | 4 | | 2 |
| | 9 | 8 | | | | | | |
| | | 9 | 6 | | 7 | | 4 | 5 |
| | | | | | | | | |
| 5 | 3 | | 8 | | 9 | 7 | | |
| | | | | | | 5 | | 9 |
| 9 | | 7 | | | | 3 | 6 | |
| | | | 4 | | 6 | | | |

**Shumë i lehtë:** 692438751, 351297486, 847561932, 978145623, 165723849, 423986175, 216374598, 789652314, 534819267. **Mesatar:** 416582937, 375961482, 298743651, 829637145, 761254893, 534819726, 642378519, 987125364, 153496278.

# Parandalimi i kancerit, lajme të mira...



Parandalimi i kancerit mund të jetë ende një prej mundësive më të mira për ta mposhtur atë. Sipas Agjencisë Ndërkombëtare të kërkimeve mbi Kancerin, të paktën gjysma e kancerëve në botë janë të parandalueshëm dhe është e mundur që deri në 90 % të tyre të shkaktohen prej stilit të jetesës. Një studim sugjeronte që, nëse njerëzit thjesht vepronin sipas këshillave për duhanpirjen, dietën, alkoolin dhe faktorë të tjerë të njohur të riskut, më shumë se 40% e kancerëve mund të parandalohen. Studiuesit vazhdojnë të kërkojnë dhe gjejnë shkaktarë. Një studim i fundit i OBSH thoshte se të pish kafe apo çaj shumë të nxehtë mund të jetë e lidhur me kancerin në fyt. Kjo pasoi një tjetër studim global, sipas të cilit mishi i përpunuar shkakton kancer. Disa lloje kaviesh që nuk ngordhin kurrë prej kancerit po bëhen një aleat i mirë i shkencëtarëve që kërkojnë mënyra për parandalimin. Ata sekretojnë një substancë të ëmbël të formuar nga acidi hialuronik, që e bën lëkurën e tyre të butë dhe formon një kafaz mbrojtës përreth qelizave, gjë që pengon ato të tumorit që të shumohen. Shkencëtarët po shohin nëse një gjë e tillë mund të implementohet tek gjitarët.

## Filmon gratë në dhomën e zhveshjes, arrestohet punonjësi i klinikës private



Një punonjës i një klinike private në Turqi është arrestuar pasi kishte vendosur kamera të fshehtë në dhomën e zhveshjes së grave duke i filmuar nudo. Sipas agjencisë turke të lajmeve "DHA", ngjarja ka ndodhur në një klinikë private dialize në provincën Edirne të Turqisë. Media raporton se punonjësi, i identifikuar vetëm si S.Y., kishte vendosur telefonin e tij celular në disa vende në dhomën e zhveshjes dhe kishte filmuar gratë teksa ndërroheshin. Celulari u dallua nga disa punonjës të tjerë të klinikës të cilët panë pamjet e papërshtatshme të grave. Pasi telefoni rezultoi se ishte i S.Y., punonjësit e paditën në polici. Në dëshminë e tij në polici, i dyshuari tha se ishte në depresion dhe se ishte penduar për një veprim të tillë. Hetuesit gjetën pamjet nudo të grave në celularin e S.Y., për të cilin gjykata vendosi arrest me burg.



## Refuzoi të priste flokët e vajzës së vogël, berberit i hapen telashe



Një berber është thirrur nga Komisioni i të Drejtave të Njeriut, pasi ka refuzuar të presë flokët e një vajze të vogël. Sam Rahim, i cili drejton Hunters Hill Barber Shop në North Shore të Sidneyt, Australi tha për 9 News se ai ndihej i shkatërruar nga thirrjet në gjyq. Ai tha se në Dhjetor në vitit të kaluar një grua hyri në dyqanin e tij dhe e pyeti nëse mund të priste flokët e vajzës së saj të vogël, por ai e refuzoi me mirësjellje. Rahim nuk është i trajnuar për të prerë flokët e vajzave dhe nuk ka eksperiencë në këtë gjë.

"Por ajo vazhdoi të ushtronte presion, duke thënë se duhej ta bëja. I thashë se ka sallone bukurie femrash ku mund të realizohet kjo gjë, por ajo u nevrikos dhe doli jashtë", tha ai. Sipas Daily Mail Rahim tani po akuzohet për shkelje të ligjeve kundër diskriminimit dhe iu tha se kishte "turpëruar" vajzën. Çështja do të paraqitet para Komisionit të të Drejtave të Njeriut në javët e ardhshme dhe Rahim është i shqetësuar për impaktin që kjo do të ketë në punën e tij.

## Sa kushton targa më e shtrenjtë në botë...



Targa "F1" është në shitje dhe për këdo që dëshiron të jetë pronar i saj, ajo kushton 14.4 milionë paund. Ky padyshim do të jetë regjistrimi më i shtrenjtë në botë dhe pronari i saj Afzal Khan do të përfitojë një shifër të majme nga investimi i tij prej 375 mijë paund. Themeluesi i Khan Design e bleu atë në vitin 2008 nga Këshilli i Essex. Targa kishte qenë në pronësi të këshillit për 104 vite, derisa pranoi ofertën e Khan. Dizajni F1, që i referohet garave të Formula 1, ka rezultuar mjaft popullor. Sipas asaj që shkruan e përditshmja britanike "Metro", 4 vite më parë, Khan kishte refuzuar një ofertë prej 6 milionë paund. Por tanimë ai e ka vendosur targën në ankand, me një çmim fillestar prej 12 milionë paund. Khan, i cili ka si biznes makina luksi, tregon herë pas here sendet me vlerë në pronësi të tij, në Instagram. Rekordin aktual për targën më të shtrenjtë në Britaninë e Madhe e mban "25 0", e shitur për një vlerë prej 518,480.

## KALENDARI HISTORIK 16 PRILL

1178 BC - Eklipsi i diellit mund të ketë shënuar kthimin e Odiseut, Mbretit legjendar të Itakës, në mbretërinë e tij pas Luftës së Trojës.

73 - Masada, një fortesë hebreje, bie në duart e Romakëve pas rrethimit disa mujor, fundi i Revoltës hebreje.

1346 - Mbreti Stefani IX i Serbisë shpall veten Car të Greqisë

1346 - Perandoria serbe shpallet në Shkup nga Dushan i Fuqishmi, duke okupuar një pjesë të madhe të Ballkanit.

1789 - Inaugurimi i parë i kryetarit Xhorxh Uashington

1866 - Karakozov tenton të vras Car Aleksandrin II të Rusisë

1869 - Ebenezer Basset, Diplomati i parë zezak i SHBA fillon shërbimin e tij në Haiti

1917 - Lenini kthehet në Rusi për të filluar Revolucionin Bolshevik

2007 - Masakra në Virxhinia: Vrasja më masive në historinë moderne amerikane. Vrasësi Seung-Hui Ço, vret 32 persona dhe plagosë 23 të tjerë.

2008 - Papa Benedikti XVI fillon udhëtimin e tij në Shtetet e Bashkuara.

## A E DINI SE...

Dritë Agolli vazhdon të cilësohet si novator i poezisë shqiptare në gërshetimin që i ka bërë folklorit me poezinë moderne, duke sjellë perla lirike të gjithës shqipe. Ndërkohë risi jo pak të rëndësishme, Agolli solli dhe në metrikën e vargut. Poezitë më të njohura të Dritëro Agollit janë, "Kur të jesh mërzitur shumë", "Kur një mëngjes", "Ëndërr e prerë", të cilat dihen përmendësh nga shumë vetë.



Ndërsa poemat më të vlerësuar janë "Poemë për babanë dhe për vete" dhe "Devoll-Devoll". Në poezitë e tij është ndikuar dhe nga poetët rusë si Lermontov, Esenini, Pushkini etj. Kjo pas studimeve që bëri në Shën Petërburg, ku mori dhe bazat e letërsisë bashkëkohore.

## BARSOLETA

**NDIKIMI**

- A e di që djali im i madh është kopja ime?
- Po kjo ndodh për shkak të ndikimit të gjeneve.
- Vërtet? E pse djali im i vogël ngjan me fqinjin?
- Ajo ndodh për shkak të ndikimit të rrethit.

## THËNIA E DITËS



Fjalët janë armë të fuqishme për të gjithë kauzat, të mira e të këqija.

**(MANLY HALL)**